



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Numër | 11
Korrik | 2017

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 11

BOTUES	© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës Departamenti i Analizave Ekonomike dhe i Stabilitetit Financiar 33 Garibaldi, Prishtinë 10000 Tel: ++381 38 222 055 Fax: ++381 38 243 763
Faqja e internetit	www.bqk-kos.org
Adresa elektronike	economic.analysis@bqk-kos.org
KRYEREDAKTOR	Zana GJOCAJ
REDAKTOR	Krenare MALOKU BAKIJA
AUTORË	Arta HASHIMI Arta NUSHI Bejtush KIÇMARI Valon HASANAJ
REDAKTOR TEKNIK	Butrint BOJAJ

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CIS	Commonwealth of Independent States
DST	Të Drejtat Speciale të Tirazhit
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KJP	Kreditë joperformuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KNK	Kthimi në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MEF	Ministria e Financave
MNI	Margjina Neto e Interesit
OJSHEF	Organizatat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (<i>angl.: Rule of Law Index</i>)
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje: Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2017),
Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 11, Prishtinë: BQK.
Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në verzionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	13
2. Përmbledhje -----	14
Vlerësimi i përgjithshëm i rreziqeve ndaj stabilitetit financiar -----	18
Harta e stabilitetit financiar -----	18
3. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	20
4. Ekonomia e Kosovës -----	29
4.1 Tregu i Letrave me Vlerë -----	32
5. Sistemi Financiar i Kosovës -----	35
5.1. Karakteristikat e Përgjithshme -----	35
5.2 Ekspozimi ndaj sektorit të jashtëm -----	36
6. Sektori Bankar i Kosovës -----	39
6.1 Struktura e Sektorit Bankar -----	39
6.2. Aktiviteti i Sektorit Bankar -----	39
6.3. Performanca e Sektorit Bankar -----	52
6.4 Rreziqet e Sektorit Bankar -----	55
6.5. Analiza Stres-Test -----	68
6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë -----	73
7. Sektori Pensional -----	76
8. Sektori i Sigurimeve -----	78
8.1. Aktiviteti i sektorit të sigurimeve -----	78
8.2. Performanca financiare e sektorit të sigurimeve -----	79
9. Sektori mikrofinanciar dhe Ndihmësit Financiar -----	81
9.1. Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar -----	81
9.2. Performanca e sektorit mikrofinanciar -----	84
9.3 Ndihmësit Financiar -----	85
10. Politika Makroprudenciale -----	86
10.1 Identifikimi dhe Vlerësimi i Rrezikut Sistemik -----	86
10.2 Përmbledhje e zhvillimeve në tregues të zgjedhur të makroprudencës -----	87
10.3 Vendimet dhe masat makroprudenciale të BQK-së -----	88
10. Shtojca statistikore -----	89
11. Referencat -----	109

LISTA E FIGURAVE	18
Figura 1. Harta e stabilitetit financiar	18
Figura 2. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë	20
Figura 3. Shkalla e inflacionit në eurozonë	20
Figura 4. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së	21
Figura 5. Rritja vjetore e kreditimit dhe shkalla e KJP-ve në vendet kryesore të eurozonës	21
Figura 6. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar në vendet kryesore të eurozonës	22
Figura 7. Rritja vjetore e kredive dhe depozitave në vendet e rajonit	22
Figura 8. Norma e këmbimit të euros ndaj valutave kryesore	23
Figura 9. Struktura e aseteve të PCH-së	23
Figura 10. Ecuria e kredive dhe depozitave të PCH –së	24
Figura 11. Treguesit e efikasitetit të PCH –së	25
Figura 12. Struktura e aseteve të RBI-së	25
Figura 13. Ecuria e kredive dhe depozitave të RBI-së	26
Figura 14. Treguesit e efikasitetit të RBI-së	26
Figura 15. Struktura e aseteve të NLB Group	27
Figura 16. Ecuria e kredive dhe depozitave të NLB group	27
Figura 17. Treguesit e efikasitetit të NLB Group	28
Figura 18. Ndryshimi mesatar vjetor i IÇK-së	30
Figura 19. Importet eksportet dhe bilanci tregtar	31
Figura 20. Pranimet e remitencave	31
Figura 21. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve	32
Figura 22. Ecuria e tregut të letrave me vlerë	32
Figura 23. Shuma e shpallur dhe e ofertuar	33
Figura 24. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit	33
Figura 25. Normat mesatare e interesit e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës sipas maturimit	33
Figura 26. Struktura e aseteve të sistemit financiar	35
Figura 27. Ndërmjetësimi financiar sipas sektorëve	35
Figura 28. Kreditë ndaj BPV-së	35
Figura 29. Hendeku i kredisë ndaj BPV-së	35
Figura 30. AJN-të sipas sektorëve financiarë	36
Figura 31. Ekspozimi i jashtëm sipas sektorëve financiar	37
Figura 32. Struktura e aseteve në sektorin e jashtëm	37
Figura 33. Struktura e detyrimeve të jashtme	38
Figura 34. Struktura e aseteve të sektorit bankar	39
Figura 35. Shkalla e koncentrimit në sektorin bankar	39
Figura 36. Struktura e aseteve të sektorit bankar	39
Figura 37. Asetet e sektorit bankar	40
Figura 38. Struktura e letrave me vlerë	40

Figura 39. Kontributi i sektorëve në rritjen e gjithsej kredive-----	41
Figura 40. Struktura e kredive sipas sektorëve në vendet e rajonit -----	41
Figura 41. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike-----	41
Figura 42. Kreditë sipas veprimtarisë ekonomike -----	42
Figura 43. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit -----	42
Figura 44. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit për ndërmarrje dhe ekonomi familjare -	42
Figura 45. Gjithsej kreditë dhe kreditë e reja -----	43
Figura 46. Kreditë e reja -----	43
Figura 47. Kreditë e reja sipas sektorëve-----	43
Figura 48. Kreditë e reja sipas sektorëve dhe qëllimit të përdorimit -----	43
Figura 49. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të nërmarrjeve ----	44
Figura 50. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditetë ndaj ndërmarrjeve -----	45
Figura 51. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet-----	45
Figura 52. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare -----	46
Figura 53. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare -----	46
Figura 54. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare -----	47
Figura 55. Struktura e depozitave të sektorit bankar -----	48
Figura 56. Struktura e depozitave të ndërmarrjeve-----	48
Figura 57. Depozitat e jorezidentëve-----	48
Figura 58. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit-----	49
Figura 59. Struktura e depozitave të afatizuara -----	49
Figura 60. Norma mesatare e interesit -----	50
Figura 61. Normat mesatare e interesit në Kosovë dhe në vendet e rajonit -----	50
Figura 62. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare	50
Figura 63. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas qëllimit-----	50
Figura 64. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas maturimit-----	51
Figura 65. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas veprimtarisë ekonomike -----	51
Figura 66. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit-----	51
Figura 67. Norma mesatare e interesit në depozita-----	51
Figura 68. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve -----	52
Figura 69. Normat mesatare të interesit në dipozitat e ekonomive familjare -----	52
Figura 70. Performanca financiare e sektorit bankar -----	52
Figura 71. Struktura e të hyrave të sektorit bankar-----	53
Figura 72. Shpenzimet e sektorit bankar -----	53
Figura 73. Vlera e shpenzimeve e sektorit bankar -----	53
Figura 74. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar-----	54
Figura 75. Raporti shpenzime/ të hyra -----	54
Figura 76. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar-----	56

Figura 77. Raporti i gjithsej asteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra -----	56
Figura 78. Rezervat e sektorit bankar -----	57
Figura 79. Hendeku i likuiditetit -----	57
Figura 80. Raporti KJP/gjithsej kreditë -----	58
Figura 81. Gjithsej kreditë dhe KJP-të-----	58
Figura 82. Raporti KJP/gjithsej kreditë në Kosovë dhe në disa vende të Ballkanit Perëndimor	58
Figura 83. Norma e KJP-ve sipas veprimtarive -----	59
Figura 84. Struktura e kredive sipas klasifikimit-----	59
Figura 85. KJP-të dhe provizionet-----	59
Figura 86. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	60
Figura 87. Kapitalizimi i sektorit bankar -----	60
Figura 88. Kapitali rregullator dhe APR-të-----	60
Figura 89. TMK në sektorin bankar në Kosovë dhe në vendet e rajonit -----	61
Figura 90. Struktura e kapitalit rregullator -----	61
Figura 91. Struktura e kapitalit të klasit të parë -----	61
Figura 92. Struktura e kapitalit të klasit të dytë-----	62
Figura 93. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej asetëve të sektorit -----	62
Figura 94. Struktura e APR-ve sipas peshës së rrezikut -----	62
Figura 95. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë -----	64
Figura 96. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj -----	64
Figura 97. Hendeku i asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit-----	64
Figura 98. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike -----	67
Figura 99. Kriteri i madhësisë -----	67
Figura 100. Kriteri i zëvendësueshmërisë -----	67
Figura 101. Kriteri i ndërlidhjes-----	68
Figura 102. Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksiteti -----	68
Figura 103. Asetet e sektorit pensional -----	76
Figura 104. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale-----	76
Figura 105. Struktura e investimeve të sektorit pensional-----	76
Figura 106. Përformanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës-----	77
Figura 107. Përformanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve -----	77
Figura 108. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve -----	78
Figura 109. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	78
Figura 110. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara -----	78
Figura 111. Primet bruto të arkëtuara -----	79
Figura 112. Dëmet e paguara -----	79
Figura 113. Asetet e sektorit mikrofinanciar-----	81
Figura 114. Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar -----	81
Figura 115. Kreditë ndaj ekonomive familjare sipas maturitetit -----	82
Figura 116. Struktura e kredive ndaj ndërmarrjeve -----	82

Figura 117. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve-----	82
Figura 118. Kreditë ndaj ndërmarrjeve sipas maturitetit -----	82
Figura 119. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar -----	83
Figura 120. Struktura e lizingut-----	83
Figura 121. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	83
Figura 122. Norma mesatare e interesit në kredi -----	83
Figura 123. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	84
Figura 124. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	84
Figura 125. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore -----	84

LISTA E TABELAVE ----- 36

Tabela 1. Numri i institucioneve financiare -----	36
Tabela 2. Struktura e aseteve të sektorit bankar -----	40
Tabela 3. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar-----	47
Tabela 4. Tregues kyç të efikasitetit të sektorit bankar-----	54
Tabela 5. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar-----	55
Tabela 6. Indikatorët e rreziqeve të sektorit bankar-----	55
Tabela 7. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë -	65
Tabela 8. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku kreditor -----	70
Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku i likuiditetit -----	72
Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së -----	74
Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar -----	74
Tabela 12. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela -----	75
Tabela 13. Struktura e sektorit pensional-----	76

LISTA E KUTIVE ----- 23

Kutia 1. Performanca e grupeve më të mëdha bankare që operojnë në Kosovë -----	23
Kutia 2. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë -----	65

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Ekonomia globale gjatë vitit 2016 u karakterizua nga zhvillime më të favorshme, ku kontribut mjaft të rëndësishëm kishte rikuperimi i ekonomisë së eurozonës. Masat e lehtësimit sasior të ndërmarrja nga Banka Qendrore Evropiane forcuan kërkesën e brendshme, e cila paraqiti shtytësin kryesor të rritjes ekonomike. Zhvillimet në eurozonë u reflektuan pozitivisht në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, të cilat në përgjithësi raportuan për rritje të kërkesës së brendshme dhe rritje të eksporteve. Presionet e dobëta inflacioniste në eurozonë vazhduan të jenë të pranishme edhe gjatë vitit 2016, kryesisht si pasojë e çmimeve të ulëta të naftës, energjisë dhe metaleve në tregjet ndërkombëtare. Këto zhvillime u reflektua edhe në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, ku u regjistruan norma të ulëta të inflacionit.

Ekonomia e Kosovës, ngjashëm me zhvillimet në eurozonë dhe në vendet e rajonit, u karakterizua me rritje të aktivitetit gjatë vitit 2016. Rritja e konsumit dhe investimeve paraqesin faktorët me kontributin kryesorë, përderisa norma e lartë e deficitit tregtar vazhdoi të ketë ndikim negativ në rritjen e ekonomisë së vendit. Kosova vazhdoi të ketë stabilitet makroekonomik. Shkalla e inflacionit qëndroi në nivel mjaft të ulët, përderisa pozicioni fiskal mbeti i qëndrueshëm me shkallë të ulët të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik.

Kosova vazhdon të ketë një sistem financiar të shëndoshë, i cili përfaqëson një burim shumë të rëndësishëm të rritjes dhe stabilitetit të ekonomisë së vendit. Të gjithë sektorët përbërës të sistemit financiar shënuan rritje të aktivitetit, duke i ofruar kështu ekonomisë së vendit një ofertë më të pasur të produkteve financiare. Aktiviteti ndërmjetësues financiar i sektorit bankar shënoi rritje të qëndrueshme. Kushtet e financimit nga bankat vazhduan përmirësimin, ku përveç zvogëlimit të normave të interesit, qasja në kreditë bankare u shoqërua me lehtësime edhe në aspektet tjera. Përmirësimi i kushteve të kreditimit dhe zhvillimi i vazhdueshëm i produkteve të reja financiare, mbështetur gjithashtu nga shëndeti i mirë që gëzon sektori bankar i Kosovës, është reflektuar në rritjen e vazhdueshme të shkallës së ndërmjetësimit financiar në Kosovë. Treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar të Kosovës pasqyrojnë një gjendje shumë të kënaqshme, ku vlen të theksohet rënia e mëtejme e kredive joperformuese, që e veçon Kosovën kundrejt vendeve të rajonit për nga cilësia e mirë e portofolit kreditor. Gjithashtu, sektori bankar vazhdoi të ketë shkallë të lartë të likuiditetit dhe ekspozim të ulët ndaj rrezikut të tregut. Sektori pensional shënoi rritje të aseteve në saje të rritjes së kontributeve të reja pensionale dhe rritjes së konsiderueshme të kthimit nga investimet. Sektori i sigurimeve po ashtu shënoi rritje të aktivitetit, megjithëse performanca financiare e sektorit vazhdon të jetë e pafavorshme. Institucionet mikrofinanciare vazhduan të përshpejtojnë aktivitetin kredidhënës, duke e pasuruar kështu në mënyrë substanciale ofertën e produkteve kreditore në Kosovë.

Infrastruktura e sektorit bankar vazhdoi avancimin, duke rritur efikasitetin e shërbimeve financiare. Viti 2016 shënoi funksionalizimin e sistemit të ri ndër-bankar të pagesave, ATS, që kontribuon në avancim të theksueshëm në sferën e realizimit të pagesave. Gjithashtu, rritja e numrit të pajisjeve si pikat e shitjes dhe numrit të llogarive bankare që shfrytëzojnë platformat e internetit, kontribuuan në rritjen e vëllimit dhe vlerës së transaksioneve të realizuara.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) mbetet e përkushtuar në zbatimin e objektivave të saj ligjore, ku stabiliteti financiar vazhdon të jetë objektivi primar. Vlerësimi i stabilitetit financiar dhe informimi i vazhdueshëm i publikut lidhur me zhvillimet e rëndësishme për stabilitetin financiar të vendit do të vazhdojnë të jenë prioritete të rëndësishme për BQK-në.

Bedri HAMZA

Guvernator

2. Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në eurozonë është karakterizuar me rritje të qëndrueshme në vitin 2016, mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme. Norma mesatare vjetore e rritjes reale të BPV-së në eurozonë në vitin 2016 ishte 1.8 përqind, mbështetur kryesisht nga përmirësimi i kushteve të financimit në eurozonë, përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve në tregjet e punës, çmimet e ulëta të naftës dhe çmimet e ulëta të energjisë. Në të njëjtën periudhë, mbështetur kryesisht nga rritja e eksporteve dhe investimeve, vendet në Ballkanin Perëndimor janë karakterizuar me një rritje mesatare të BPV-së prej rreth 2.8 përqind.

Eurozona u karakterizua me presione të dobëta inflacioniste gjatë vitit 2016, ku shkalla mesatare e inflacionit ishte rreth 0.2 përqind. Në dhjetor 2016, BQE-ja vendosi që të vazhdojë masat e programit të lehtësimit sasior deri në fund të vitit 2017, me qëllim rikthimin e shkallës së inflacionit më afër caktuar prej 2 përqind dhe rikuperimin e aktivitetit ekonomik. Megjithatë, ndikimi i politikave ekspansioniste monetare në nivelin e çmimeve në eurozonë ka rezultuar të jetë i kufizuar gjatë vitit 2016, kryesisht si pasojë e çmimeve të ulëta të naftës dhe rënies së çmimeve të energjisë në këtë periudhë. Ngjashëm me eurozonën, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me shkallë të ulët mesatare të inflacionit prej 0.2 përqind, që kryesisht i atribuohet zhvillimeve në nivelin e çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Mbështetur kryesisht nga politika e lehtësuar monetare, aktiviteti kreditues në eurozonë u rikuperua në dy vitet e fundit, ku në vitin 2016, norma mesatare e rritjes së kreditimit ishte 2.4 përqind. Gjithashtu, indikatorët e profitabilitetit dhe indikatorët kryesor të shëndetit financiar shënuan përmirësim gjatë vitit 2016 kundrejt vitit paraprak. Vendet kryesore të eurozonës u karakterizuan me nivel të kënaqshëm të likuiditetit në sektorin bankar, si dhe me përmirësim të cilësisë së portfolios kreditore në periudhën raportuese. Ngjashëm me vendet në eurozonë, kreditimi në vendet e Ballkanit Perëndimor shënoi rritje në vitin 2016, kryesisht si rezultat i përmirësimit të kushteve të kreditimit nga bankat si dhe rritjes së kërkesës për kredi. Gjithashtu, indikatorët e profitabilitetit dhe indikatorët kryesor të shëndetit financiar shënuan përmirësim gjatë vitit 2016 kundrejt vitit paraprak.

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me rritje të aktivitetit gjatë vitit 2016 kundrejt vitit paraprak. Sipas statistikave preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për BPV-në tremujore, rezulton se ekonomia e Kosovës shënoi rritje mesatare përgjatë katër tremujorëve të vitit 2016 prej 3.4 përqind, përderisa vlera nominale e BPV-së arriti në rreth 5.98 miliardë euro. Rritja e aktivitetit ekonomik është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, gjegjësisht rritja e investimeve (10.4 përqind) dhe konsumit (2.9 përqind). Gjatë vitit 2016, rritja reale e ekonomisë së Kosovës është mbështetur nga rritja në aktivitetin e sektorit të bujqësisë, tregtisë dhe aktiviteteve financiare, përderisa rënie reale vlerësohet të kenë shënuar afarizmi me pasuri të patundshme, industria përpunuese dhe administrim publik. Për vitin 2017, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes ekonomike do të jetë rreth 3.7 përqind.

Ekonomia e Kosovës në vitin 2016 u karakterizua me ngritje të lehtë të nivelit të çmimeve kundrejt vitit paraprak, ku norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur përmes indeksit të çmimeve të konsumit, ishte 0.3 përqind. Kosova vazhdon të ketë pozicion të qëndrueshëm fiskal. Në vitin 2016, buxheti i Kosovës shënoi deficit primar buxhetor prej rreth 61.1 milionë euro, krahasuar me deficitin buxhetor prej rreth 111.4 milionë euro në vitin 2015. Borxhi publik arriti në 852.7 milionë euro, ndërsa si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 14.5 përqind në vitin 2016.

Përderisa vlera e shtuar nga sektorët prodhues në vend mbetet e ulët, rritja e kërkesës së brendshme është përkthyer në rritje të importit, duke ndikuar kështu në rritjen e deficitit të

llogarinë rrjedhëse. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale arriti vlerën prej 534.6 milionë euro (471.4 milionë euro në vitin 2015), kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së të ardhurave parësore. Në anën tjetër, bilancet pozitive të shërbimeve dhe të ardhurave dytësore shënuan rritje. Gjatë vitit 2016, sektori i jashtëm i Kosovës u karakterizua me rritje vjetore të remitencave të pranuar në vend prej 3.8 përqind, vlera e të cilave arriti në 691.0 milionë euro. Në anën tjetër, Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë shënuan vlerën prej 215.9 milionë euro në vitin 2016, që përbën një rënie kundrejt vlerës së shënuar në vitin paraprak prej 308.8 milionë euro. Në këtë periudhë, rënie e IHD-ve u evidentua pothuajse në të gjithë sektorët, megjithëse me rënie më e theksuar u karakterizuan sektori i patundshmërive dhe sektori i shërbimeve financiare.

Sektori financiar i Kosovës gjatë vitit 2016 u karakterizua me rritje të qëndrueshme të aktivitetit në të gjithë sektorët përbërës. Rrjedhimisht, shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë, e shprehur si raport i aseteve të sistemit financiar ndaj BPV-së, ka arritur në 90.0 përqind nga 84.5 përqind në vitin paraprak. Kreditë e sektorit bankar, si kontribuues kryesor në rritjen e aktivitetit të sistemit financiar, janë karakterizuar me një rritje të përshpejtuar vjetore prej 10.4 përqind (7.3 përqind në vitin 2015), duke arritur vlerën prej 2.23 miliardë euro. Rritja e kreditimit i atribuohet rritjes së kreditimit të ndërmarrjeve, që dominojnë strukturën e gjithsej kredive, si dhe ritmit të përshpejtuar të rritjes së kredive ndaj ekonomive familjare. Përmirësimi i kushteve të kreditimit nga bankat dhe rritja e kërkesës për kredi ishin faktor kryesor në rritjen e aktivitetit kreditues nga bankat. Në këtë funksion, ndikim pozitiv mund të ketë pasur edhe lansimi i Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive në vitin 2016. Raporti i kreditimit të sektorit bankar ndaj BPV-së qëndroi në 37.1 përqind në vitin 2016, një raport i ulët krahasuar me mesataren e vendeve të rajonit (rreth 56 përqind). Gjithashtu, hendeku i kredisë ndaj BPV-së, që tregon për raportin aktual të kredisë ndaj BPV-së krahas potencialit të tij afatgjatë, vazhdoi të qëndrojë në territor negativ për Kosovën duke sugjeruar hapësirë për rritje të mëtejme të ndërmjetësimit financiar në vend. Gjatë vitit 2016, me përshpejtim të rritjes vjetore të kreditimit u karakterizua sektori i tregtisë, përderisa sektori i prodhimit shënoi ngadalësim të rritjes vjetore. Sektorët që u karakterizuan me rënie vjetore të kreditimit ishin bujqësia, shërbimet financiare dhe shërbimet për patundshmëritë. Kreditë me maturitet më të gjatë kanë vazhduar të rrisin pjesëmarrjen në gjithsej kreditë, që mund të atribuohet rritjes së kërkesës për kredi me afate më të gjata të maturimit si dhe përmirësimit të ofertës kreditore nga ana e bankave përmes rritjes së maturitetit në kreditë e ofruara.

Burim kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar vazhdojnë të jenë depozitat, që në vitin 2016 arritën vlerën 2.90 miliardë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind. Në qëndrueshmërinë e rritjes së depozitave kryesisht ka kontribuar rritja e depozitave të ekonomive familjare, të cilat njëherësh konsiderohen burim më i qëndrueshëm i financimit në raport me kanalet tjera të financimit.

Norma mesatare e interesit në kredi vazhdoi trendin rënës edhe gjatë vitit 2016, ndërsa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje për të dytin vit radhazi. Norma mesatare e interesit në kredi zbriti në 7.2 përqind, përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje 1.2 përqind. Normat mesatare të interesit në kredi dhe depozita në sektorin bankar të Kosovës qëndrojnë në nivel të përafërt me mesataren e normave të interesit të vendeve të rajonit.

Sektori financiar vazhdon të karakterizohet me stabilitet të lartë, vlerësuar në bazë të nivelit të treguesve të performancës dhe shëndetit financiar. Profiti i realizuar gjatë vitit 2016 arriti në 75.5 milionë euro, që paraqet rënie krahasuar me vitin paraprak që u karakterizua me profitin më të lartë historik të sektorit. Megjithatë, treguesit e profitabilitetit si Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) qëndruan në nivel të lartë, në 2.3 dhe 19.7 përqind respektivisht, që janë dukshëm më të lartë se niveli i rajonit. Pozita e

likuiditetit të sektorit bankar vazhdon të jetë në nivel të qëndrueshëm, përkundër rritjes së përshpejtuar të kreditimit që ndikoi në rritjen e raportit të kredive ndaj depozitave në 77.0 përqind. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 41.5 përqind, që është mjaft mbi minimumin rregullator prej 25 përqind. Pozita e kapitalizimit të sektorit vazhdon të reflektoj qëndrueshmëri dhe aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar humbjet potenciale. Treguesi i kapitalizimit zbriti në 17.9 përqind si rezultat i rënies së kapitalit të klasit të dytë, por cilësia e kapitalit rregullativ vazhdoi rritjen për të tretin vit radhazi si rezultat i rritjes së kapitalit të klasit të parë të mbështetur nga profiti i akumuluar ndër vite. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin rregullativ në dhjetor 2016 arriti në 88.7 përqind nga 87.7 një vit më parë.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor ka vazhduar të bie, duke u pasqyruar me rënie të mëtejme të normës së kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në 4.9 përqind, që paraqet nivelin më të ulët që nga viti 2010. Rënia e raportit të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive u ndikua si nga rritja më e lartë e kredive ashtu edhe nga përmirësimi i theksuar kualitetit të kredive. Sa i përket sektorëve ekonomikë, norma e KJP-ve për ekonomitë familjare ishte 2.5 përqind ndërsa për sektorin e ndërmarrjeve 5.5 përqind. Krahas ngritjes së cilësisë së portofolit kreditor, është shënuar rritje e normës së mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë në 127.6 përqind, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme nga kreditë. Norma e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive vazhdon të mbetet në nivelin më të ulët krahasuar me vendet e rajonit që mesatarisht kishin një normë të KJP-ve prej 14.2 përqind në dhjetor 2016.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut vazhdon të jetë i ulët. Raporti i pozicionit të agreguar neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë ka shënuar rritje në 4.6 përqind, por që mbetet dukshëm nën nivelin maksimal të lejuar rregullator prej 30 përqind. Kreditë në valutë të huaj kanë shënuar rënie duke zvogëluar pjesëmarrjen edhe ashtu mjaft të ulët në gjithsej kreditë në 0.2 përqind. Kreditë dhe depozitat ndikohen nga lëvizjet e normave të interesit kryesisht vetëm në maturim për faktin se bartin normë fikse të interesit. Hendeku negativ për intervalin e shkurtër të maturimit 'deri në 30 ditë' është ngushtuar në krahasim me vitin paraprak, gjë që ulë ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të rritjes së mundshme të normës së interesit. Ndërsa, hendeku kumulativ deri në 1 vit është dyfishuar, duke rritur ekspozimin ndaj rrezikut të rënies së mundshme të normës së interesit.

Bankat kanë krijuar sistem, politika dhe procedura të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut operacional. Ky rrezik është menaxhuar në mënyrë adekuate edhe në vitin 2016, duke mos pasur raste të materializimit të tij, dhe duke ndarë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e këtij rreziku në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore.

Rezultatet e analizës stres-test me të dhëna të fund vitit sugjerojnë aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar tronditjet e mundshme në kualitetin e portofolit kreditor dhe në nivelin e kapitalizimit, që mund të pasojnë si rezultat i disa skenarëve hipotetik siç janë: rritja e normës së KJP-ve, zhvlerësimi i euros ndaj valutave kryesore; zvogëlimi i normave të interesit për asetet dhe rritja e normave të interesit për detyrimet; si dhe dështimi i kredimarrësve më të mëdhenj. Po ashtu, sektori bankar ka treguar aftësi për të ruajtur gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike të tërheqjeve të konsiderueshme të depozitave.

Infrastruktura bankare gjatë vitit 2016 vazhdoi të avancohet dhe të zgjerohet. Avancim i rëndësishëm është shënuar në fushën e sistemit të pagesave me implementimin e një sistemi tërësisht të ri ndërbankar të pagesave, të quajtur ATS (Automat Transfer System/Sistem i Transferit Automatik). Ky sistem mundëson transferimin e fondeve në kohë reale si dhe procesimin e pagesave në grup dhe shuma të vogla. Numri si dhe vlera e transaksioneve të përpunuara nga sistemi ATS gjatë vitit 2016 është rritur dukshëm, me 17.9 dhe 42.5 përqind

respektivisht. Numri i llogarive bankare u karakterizua me rënie të lehtë vjetore prej 0.6 përqind, ndërsa llogaritë E-banking kanë shënuar rritje prej 23.3 përqind. Me rritje u karakterizuan edhe kartelat e kreditit dhe debitit, numri i të cilave u ngrit për 17.5 përqind. Rrjeti i pajisjeve POS ka shënuar rritje në vitin 2016, ndërsa numri i bankomatëve është zvogëluar. Përkundër zvogëlimit të numrit të bankomatëve, numri dhe vlera e transaksioneve të procesuara përmes tyre është rritur. Të gjitha këto zhvillime sugjerojnë për rritje të efikasitetit të shërbimeve bankare.

Sektorët tjerë përbërës të sistemit financiar, siç janë sektori pensional, sektori i sigurimeve dhe ai i institucioneve mikrofinanciare, u karakterizuan gjithashtu me rritje të aktivitetit. Asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 15.2 përqind dhe arritën vlerën prej 1.43 miliard euro në dhjetor 2016. Performanca financiare vjetore e sektorit gjithashtu shënoi rritje, si rezultat i rritjes së çmimit të aksionit dhe pothuajse dyfishimit të kthimit në investime. Sektori i sigurimeve zgjeroi aktivitetin e tij duke rritur asetet në 161.8 milionë euro, që përkon me rritje vjetore prej 5.9 përqind. Mirëpo, performanca financiare e këtij sektori vazhdon të jetë jo e kënaqshme si rezultat i humbjes së thelluar dukshëm gjatë këtij viti. Thellimi i humbjes ishte kryesisht rezultat i rivlerësimit aktuarial të provizioneve teknike të disa kompanive të sigurimit 'jo-jetë' të cilat kishin nënvlerësuar provizionet teknike për dëmet pezull në vitet e kaluara. Kontribut të theksuar në thellim të humbjeve kishin gjithashtu shpenzimet e kompanive të sigurimit, të cilat shënuan rritje të konsiderueshme vjetore. Sektori mikrofinanciar shënoi rritjen më të madhe të aseteve në sistemin financiar gjatë këtij viti. Vlera e aseteve të këtij sektori arriti në 142.2 milion euro në dhjetor 2016, që përkon me rritje vjetore prej 23.7 përqind. Po ashtu, performanca e këtij sektori u përmirësua në krahasim me tre vitet e fundit, si rezultat i rritjes së theksuar të profitit që u pasqyrua në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit.


Në funksion të ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar, në vitin 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka përpiluar Politikën për Mbikëqyrje Makroprudenciale. Kjo politikë përcakton fushëveprimin, objektivat dhe instrumentet e nevojshme të Mbikëqyrjes Makroprudenciale, në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar, duke zvogëluar akumulimin e rrezikut sistematik dhe duke fuqizuar rezistencën e sistemit financiar. Në gjysmën e dytë të vitit 2016, zhvillimet e përgjithshme të indikatorëve makroprudent në Kosovë ishin të qëndrueshme, pa ndonjë kërcënim për stabilitetin financiar të vendit.

Vlerësimi i përgjithshëm i reziqeve ndaj stabilitetit financiar

Harta e stabilitetit financiar

Fundi i vitit 2016 është karakterizuar me rritje të lehtë të rrezikut për treguesit e brendshëm të rrezikut siç janë kapitalizimi dhe profitabiliteti, likuiditeti dhe financimi, si dhe struktura e sektorit bankar (Figura 1).¹ Rreziku ndaj stabilitetit financiar nga ambienti makroekonomik i jashtëm dhe i brendshëm është rritur gjithashtu. Ndërsa, rreziku nga agjentët ekonomik, siç janë ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare ka shënuar rënie. Sektori qeveritar mbetet me notë të ngjashme rreziku. Përfundimisht, shumica e treguesve vazhdojnë të qëndrojnë mjaft nën nivelin mesatar historik të rrezikut.

Figura 1. Harta e stabilitetit financiar



Rritja e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare si dhe rritja ekonomike më e ulët e partnerëve kryesorë tregtarë të Kosovës në tremujorin e katërt të vitit 2016² në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka ndikuar që rreziku që buron nga ambienti makroekonomik i jashtëm të shënoj rritje. Në anën tjetër, normat bazë të interesit dhe papunësia në tremujorin e fundit të vitit 2016 kanë shënuar rënie të lehtë, duke zbutur rritjen e rrezikut nga sektori i jashtëm. Përkundër faktit që rreziku nga ekonomia e jashtme ka shënuar rritje, ai vazhdon të mbetet në nivel mjaft më të ulët se mesatarja historike.

Norma më e ulët e rritjes reale ekonomike në TM4 2016 krahasuar me TM4 2015 ka ndikuar që hendeku i prodhimit për këtë periudhë të jetë negativ, duke sugjeruar që ekonomia ka performuar nën potencialin e saj të shfrytëzimit efektiv të resurseve. Andaj, hendeku negativ, krahas rritjes së mesatares tremujore të inflacionit, kanë ndikuar që rreziku për stabilitetin financiar që buron nga ambienti makroekonomik i brendshëm të shënoj rritje. Raporti i borxhit të jashtëm ndaj PBB-së është rritur, duke dhënë gjithashtu kontribut të lehtë në rritjen e rrezikut. Ndërsa, bilanci i llogarisë rrjedhëse ndaj BPV-së është ngushtuar në TM4 2016 dhe norma reale efektive e këmbimit të euros ndaj valutave të vendeve partnere tregtare ka shënuar rritje, duke kontribuar në ulje të rrezikut. Niveli i rrezikut nga ambienti i brendshëm makroekonomik vazhdon të qëndroj mbi nivelin mesatar historik, kryesisht për shkak të thellimit strukturor të deficitit të llogarisë rrjedhëse ndaj BPV-së, apo raportit më të lartë të tij në krahasim me tendencën historike.

Rreziku që buron nga agjentët ekonomik, përkatësisht ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet, ka shënuar rënie të theksuar në TM4 2016, duke iu atribuar kryesisht rritjes së kreditimit ndaj këtyre sektorëve që ka rezultuar në hendek pozitiv të kreditimit. Përmirësimi i cilësisë kreditore në të dy sektorët ka ndikuar gjithashtu në rënien e rrezikut. Kontribut të theksuar në rënien e

¹ Zhvillimet në treguesit kryesorë të reziqeve ndaj stabilitetit financiar të Kosovës janë përmbledhur në figurën Harta e Stabilitetit Financiar të Kosovës. Kjo Hartë prezanton në mënyrë grafike lëvizjen e shkallës së rrezikut në kategoritë kryesore të rrezikut ndaj stabilitetit financiar si dhe mundëson krahasimin me notën mesatare historike të rrezikut për kategoritë përkatëse. Rritja e distancës nga qendra e hartës për treguesit reflekton rritje të rrezikut dhe zvogëlim të aftësisë për përballimin e goditjeve ndaj stabilitetit financiar dhe anasjelltas. Metodologjia e plotë e modelit të Hartës së Stabilitetit Financiar për Kosovën, përfshirë revidimet e fundit, paraqitet në Materialin Studimor të BQK-së Nr. 6.

² Rritja ekonomike peshohet me peshën e eksporteve të Kosovës në vendet përkatëse. Efektin më të madh në rënien e treguesit në këtë periudhë e kishte rënia e peshës së eksporteve të Indisë, e cila ka normën më të lartë të rritjes ekonomike nga të gjitha vendet partnere tregtare.

rrezikut për ekonomitë familjare kishin remitencat, të cilat shënuan rritje vjetore në TM4 2016 për dallim nga TM4 2015 kur shënuan rënie. Ndërmarrjet shënuan rënie të rrezikut në të gjithë komponentët tjerë, si indeksi i qarkullimit industrial, vlera e shtuar në BPV nga sektori i tregtisë, bilanci neto i bizneseve të regjistruara si dhe në nëntreguesin e besueshmërinë së biznesit që reflekton pritjet e biznesit për aktivitetin biznesor. Rreziku nga sektori qeveritar ka mbetur në nivel të ngjashëm. Zhvillimet kryesore përfshijnë rritjen e deficitit fiskal në TM4 2016, që ka ndikuar në rritje të notës së rrezikut, por e cila është neutralizuar nga rënia e rrezikut si rezultat i shpenzimeve më të ulëta për borxhin publik në këtë periudhë krahasuar me vitin paraprak.

Rreziku i brendshëm për sektorin bankar, i lidhur me strukturën e sektorit bankar si dhe me nivelin e kapitalizimit dhe profitabilitetit është rritur lehtësisht. Zhvillimi kryesor që ka ndikuar në rritjen e rrezikut nga struktura e sektorit bankar është rënia më e lartë e normës së kapitalizimit të disa bankave në raport me rënien e mesatares së sektorit, që ka ndikuar në rritjen e devijimit negativ ndaj normës mesatare të kapitalizimit të sektorit bankar. Koncetrimi i aseteve të tri bankave më të mëdha gjithashtu ka shënuar rritje të lehtë duke rritur rrezikun në këtë kategori, ndërsa komponentët tjera si koncentrimi i kredimarrjes për biznese, diversifikimi i portfolios së kredisë dhe burimeve të financimit të bankave kanë shënuar përmirësim duke kontribuar kështu në rënie të rrezikut.

Rreziku i lidhur me kapitalizimin dhe profitabilitetin shënoi rritje në TM4 2016 duke reflektuar kryesisht rënien e profitit para taksave krahasuar me vitin paraprak. Norma e kapitalizimit të sektorit ka rënë në TM4 2016, si rrjedhojë e rënies së kapitalit të klasit të dytë. Të hyrat nga interesi dhe ekspozimet e mëdha gjithashtu kontribuan në rritje të rrezikut, përderisa përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore ishte i vetmi komponentë që kishte ndikim pozitiv në nivelin e rrezikut të kësaj kategorie.

Rreziku i brendshëm i lidhur me likuiditetin dhe financimin e sektorit ka shënuar rritje, duke reflektuar rritjen e raportit të kredive ndaj depozitave që është ngritur si rezultat i përsheptimit të rritjes së kreditimit. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra ka rënë dhe hendeku i mjeteve dhe detyrimeve për afatin e maturimit deri në 3 muaj është rritur, duke ndikuar në rritje të rrezikut. Ndërsa, në ulje të rrezikut kontribuoi përsheptimi i rritjes së depozitave të ekonomive familjare si dhe rënia e raportit të detyrimeve ndaj rezidentëve në gjithsej detyrimet.

Përkundër rritjes së lehtë të rrezikut të stabilitetit financiar të lidhur me treguesit e brendshëm të cilët vlerësojnë kapacitetin e sektorit për t'iu bërë ballë goditjeve nga jashtë, duhet theksuar se pozita e likuiditetit dhe kapitalizimit të sektorit mbetet e kënaqshme gjykuar në bazë të nivelit të parametrave kryesorë të likuiditetit dhe kapitalizimit të cilët janë në nivele mjaft më të favorshme se normat referente dhe niveli minimal i kërkuar me rregullore.³

³ Raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në TM4 2016 ishte 41.5 përqind krahasuar me minimumin prej 25 përqind. Raporti i kredive ndaj depozitave qëndroi në 77.0 përqind, si dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 17.9 përqind, mjaft mbi nivelin minimal prej 12 përqind.

3. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Eurozona


Eurozona është karakterizuar me rritje të qëndrueshme ekonomike gjatë vitit 2016, përkundër sfidave me të cilat është përballur si ritmi i ngadalshëm i rritjes së ekonomisë globale, tensionet e ngritura gjeopolitike dhe sulmet terroriste. Norma mesatare vjetore e rritjes reale të BPV-së në eurozonë në vitin 2016 ishte 1.8 përqind, krahasuar me normën mesatare të rritjes prej 2.0 përqind të shënuar në vitin paraprak (figura 2). Politikat ekspansioniste dhe masat jokonvencionale të ndërmarra

nga BQE në kuadër të programit të lehtësimit sasior kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të financimit në eurozonë. Për më tepër, përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve në tregjet e punës, krijimi i vendeve të reja të punës, çmimet e ulëta të naftës si dhe çmimet e ulëta të energjisë janë përkthyer në rritje të të ardhurave të disponueshme, duke ndikuar kështu në rritjen e konsumit të brendshëm privat. Gjatë vitit 2016, pozicioni i investimeve në eurozonë është rikuperuar me ritëm më të ngadalshëm krahasuar me konsumin, ku pasiguritë rreth efektit që mund të ketë dalja e Britanisë nga Eurozona, zgjedhjet elektorale në disa nga vendet e BE-së, si dhe ndikimi i mundshëm i zgjedhjeve presidenciale në ShBA mund të kenë ndikuar në besueshmërinë e bizneseve në eurozonë.

Rritja e aktivitetit ekonomik mbeti kryesisht e koncentruar në ekonomitë qendrore të eurozonës, gjegjësisht në Gjermani, Francë dhe Spanjë, përderisa vendet tjera vazhduan të karakterizohen me rritje të dobët ekonomike. Parashikimet e BQE-së sugjerojnë se rritja reale e BPV-së në vitin 2017 pritet të jetë e qëndrueshme në 1.8 përqind. Konsumi i brendshëm, si një ndër faktorët shtytës të rritjes ekonomike pritet të ketë ngadalësim vitin në vijim si efekt i rritjes së çmimeve, por që do të vazhdojë të mbështetet nga masat e programit të lehtësimit sasior dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve në tregun e punës.


Norma e inflacionit në eurozonë vazhdoi të jetë nën objektivin e BQE-së. Në vitin 2016, shkalla mesatare e inflacionit ishte 0.2 përqind. Në dhjetor 2016, BQE-ja vendosi që të vazhdojë masat e programit të lehtësimit sasior deri së paku në fund të vitit 2017, me qëllim parësor rikthimin e shkallës së inflacionit më afër caktuar prej 2 përqind. Megjithatë, ndikimi i politikave ekspansioniste monetare në nivelin e çmimeve në eurozonë ka rezultuar të jetë i kufizuar gjatë vitit 2016, kryesisht si pasojë e çmimeve të ulëta të naftës dhe rënies së çmimeve të energjisë në këtë periudhë. Megjithatë projeksionet e BQE-së për vitin 2017, sugjerojnë se shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë pritet të rritet deri në 1.7 përqind (figura 3), kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombtare, veçanërisht çmimeve të energjisë.

Figura 2. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë



Burimi: Eurostat (2017)

Figura 3. Shkalla e inflacionit në eurozonë, në përqindje



Burimi: Eurostat (2017)

Lansimi i programit të gjerë stimules që nga marsi i vitit 2016 ka ndikuar drejtpërdrejtë në rënien e mëtutjeshme të normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. BQE-ja ka vazhduar të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të rifinancimit në zero përqind (figura 4).


Eurozona në dy vitet e fundit është karakterizuar me rimëkëmbje të aktivitetit të kreditimit. Politika monetare akomoduese ka stimuluar zgjerimin e aktivitetit kreditues. Deri në fund të vitit, kreditimi në eurozonë u karakterizua me një normë mesatare të rritjes prej 2.4 përqind (2.0 përqind deri në dhjetor 2015). Rritja e kreditimit ishte më e theksuar në Gjermani (4.2 përqind) dhe Francë (2.9 përqind), përderisa në vendet si Greqia, Austria dhe Spanja, norma e rritjes së kreditimit mbeti në territor negativ (figura 5). Gjatë kësaj periudhe, edhe vlera e gjithsej depozitave shënoi rritje mesatare prej 0.5 përqind (1.0 përqind në vitin 2015), ku me rritje më të lartë u karakterizua Italia (3.8 përqind). Rritje më të ngadalëshme të depozitave shënoi Gjermania (0.9 përqind), ndërsa Franca dhe Greqia u karakterizuan me rënie prej 0.3 përqind dhe 3.0 përqind, respektivisht.

Indikatorët e profitabilitetit, siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK), në mesatare, shënuan rritje. Greqia e cila vitet paraprake është karakterizuar me situatë të brishtë të profitabilitetit, këtë vit shënoi përmirësim duke realizuar kthim pozitiv në mesataren e kapitalit dhe të asetëve (figura 5).

Rritje shënuan edhe disa nga indikatorët kryesor të shëndetit financiar. Niveli mesatar i kapitalizimit të sektorit bankar, shprehur përmes raportit të kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, u rrit në mesatarisht 19.5 përqind nga 19.2 përqind në vitin paraprak. Rritje më të lartë të nivelit të kapitalizimit realizoi Austria (18.0 përqind) dhe Greqia (16.9 përqind), si rezultat i përmirësimit të nivelit të profitabilitetit. Në këtë periudhë, niveli i kapitalizimit në Gjermani, Francë dhe Spanjë qëndroi në nivel të ngjashëm me vitin paraprak në rreth 18.3, 17.2 përqind përkatësisht 14.8 përqind. Ndërsa, niveli i shfryzimit të kapitalit në financimin e aktivitetit financiar në vendet e eurozonës, i matur përmes levës financiare, shënoi rënie të lehtë në mesatarisht 8.1 përqind nga 8.4 përqind në vitin 2015.


Cilësia e portfolios kreditore shënoi përmirësim në ekonominë kryesore të eurozonës, ku në mesatare niveli i kredive jo-performuese u zvogëluar në 7.4 përqind nga 9.0 përqind. Pothuajse të gjitha vendet u karakterizuan me rënie të kredive joperformuese. Nivelin më të ulët të kredive joperformuese, në kuadër të vendeve me kreditim mbi mesataren e eurozonës, e mban Gjermania me normë rreth 2.3 përqind dhe Holanda me normë 2.5 përqind (figura 6).

Figura 4. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së



Burimi: Euribor (2017) dhe BQE (2017)

Figura 5. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar në vendet kryesore të eurozonës në vitin 2016



* Të dhënat sipas TM3
Burimi: FMN (2017)

Vendet kryesore të eurozonës gjithashtu u karakterizuan me nivel të kënaqshëm të likuiditetit në sektorin bankar, megjithëse në mesatare, eurozona shënoi rënie të lehtë të këtij treguesi. Në dhjetor 2016, niveli mesatar i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra qëndroi në 75.0 përqind, nga 78.1 përqind sa ishte në vitin 2015. Holanda dhe Gjermania⁴ qëndrojnë në nivelet më të larta të likuiditetit, ku asetet likuide tejkalojnë detyrimet afatshkurtëra për 167.0 përqind dhe 145.6 përqind, respektivisht.

Ballkani Perëndimor


Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor vazhdoi të përforcohet. Rritja e kërkesës në eurozonë, si partner kryesor tregtar për vendet në Ballkanin Perëndimor, u përkthye në përmirësim të pozicionit të neto eksporteve të rajonit. Përmirësimi i pozicionit të neto eksporteve dhe rritja e investimeve ka rezultuar në një rritje mesatare të BPV-së në Ballkanin Perëndimor prej 2.8 përqind në vitin 2016 (3.0 përqind në vitin 2015). Me rritje të përshpejtuar ekonomike u karakterizuan Shqipëria dhe Serbia, përderisa vendet tjera të Ballkanit Perëndimor shënuan ngadalësim ekonomik kundrejt vitit paraprak. Për vitin 2017, FMN ka parashikuar një rritje mesatare të BPV-së në Ballkanin Perëndimor prej 3.3 përqind.

Ngjashëm me eurozonën, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, që kryesisht i atribuohen zhvillimeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Në vitin 2016, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me një shkallë mesatare të inflacionit prej 0.2 përqind (0.4 përqind në vitin 2015), përderisa FMN ka parashikuar një rritje të shkallës së inflacionit në 1.7 përqind në vitin 2017.

Gjatë vitit 2016, kreditimi në rajon shënoi rritje, mbështetur kryesisht nga oferta e lehtësuar kreditore nga bankat, si dhe rritjes së kërkesës për kredi. Rritjen më të shpejtë të kreditimit pas Kosovës (10.4 përqind) e shënoi Serbia (6.1 përqind), pasuar nga Shqipëria (2.5 përqind). Sektori bankar në vendet e rajonit u karakterizua gjithashtu edhe me rritje të nivelit të përgjithshëm të depozitave, ku rritja më e shpejtë vjetore u regjistrua në Serbi (11.5 përqind) dhe Mal të Zi (9.4 përqind) (figura 7).


Edhe indikatorët kyç të shëndetit financiar gjatë vitit 2016 u karakterizuan me ecuri pozitive, duke shënuar rritje të lehtë krahasuar me vitin paraprak.

Figura 6. Rritja vjetore e kreditimit dhe shkalla e KJP-ve në vendet kryesore të eurozonës në vitin 2016



Burimi: FMN (2017)

Figura 7. Rritja vjetore e kredive dhe depozitave në vendet e rajonit në vitin 2016



Burimi: Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2017)

⁴ Të dhënat e fundit në dispozicion janë sipas Shtator 2016.


Indikatorët e profitabilitetit, të shprehur si raport i Kthimit në Mesataren e Kapitalit (KMK) dhe Kthimit në Mesataren e Aseteve (KMA), shënuan rritje vjetore në shumicën e vendeve të rajonit, me përjashtim të Shqipërisë. Gjithashtu, në vitin 2016, cilësia e portfolios kreditore shënoi përmirësim, ku niveli mesatar i KJP-ve zbriti në rreth 13.5 përqind (16.0 përqind në vitin 2015). Niveli më i ulët i KJP-ve u shënuar në Kosovë (4.9 përqind) dhe Maqedoni (7.1 përqind), ndërsa niveli më i lartë prej 18.3 përqind u regjistrua në Shqipëri.

Në vitin 2016, mesatarja e raportit të kapitalit rregullator ndaj asetëve të peshuara me rrezik u rrit në 17.3 përqind (16.7 në vitin 2015). Ndërsa, leva financiare shënoi rritje të lehtë në mesatarisht 13.8 përqind nga 13.7 përqind sa ishte në vitin 2015.

Po ashtu edhe pozicioni i likuiditetit, i shprehur si raport i asetëve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra qëndroi në nivel lartë, duke u rritur në mesatarisht 45.4 përqind në vitin 2016, nga 45.0 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Vendimet e BQE-s për të mos ndryshuar më tej normat e interesit pas ndryshimeve të fundit në mars të vitit 2016 janë reflektuar në forcimin e monedhës së euros kundrejt disa valutave kryesore (figura 8). Deri në dhjetor, euro është zhvlerësuar

Figura 8. Norma e këmbimit e euros ndaj valutave kryesore



Burimi: BQK (2017)


lehtësisht kundrejt dollarit amerikan ndërsa është vlerësuar kundrejt valutave tjera të mëdha si stërlina britanike dhe franku zviceran. Gjatë kësaj periudhe, norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan është zhvlerësuar për 0.1 përqind, ndërsa ndaj frankut zviceran dhe sterlinës britanike është vlerësuar për mesatarisht 2.2 përkatësisht 12.0 përqind. Në kuadër të monedhave të rajonit, euro është vlerësuar kundrejt denarit maqedon dhe dinarit serb për 0.01 përkatësisht 2.0 përqind, përderisa është zhvlerësuar ndaj lekut shqiptar për mesatarisht 1.7 përqind.

Kutia 1. Performanca e grupeve më të mëdha bankare që operojnë në Kosovë⁵

ProCredit Holding – PCH (Gjermani)

Vlera e gjithsej asetëve të grupit bankar ProCredit Holding (PCH) arriti në 5.7 miliardë euro në vitin 2016, që përbën një rënie vjetore prej 5.7 përqind. Rënia e asetëve ishte kryesisht pasojë e shitjes së njësive në Bolivia dhe Meksikë. Sipas shtrirjes regjionale, struktura e asetëve të grupit është e përqendruar në Evropën Juglindore, që përbënë 50.0 përqind të gjithsej asetëve të grupit. Segmenti i dytë më i rëndësishëm është Gjermania me 21.5 përqind të gjithsej asetëve të grupit, pasuar nga Evropa Lindore dhe Amerika Jugore me pjesëmarrje prej 15.3 përqind përkatësisht 6.8 përqind. Pjesa e mbetur e asetëve përbëhet nga njësitë të cilat janë në proces të mbylljes (figura 9). Për PCH-në, Kosova

Figure 9. Struktura e asetëve të PCH-së, në përqindje



Burimi: ProCredit Holding (2017)

⁵ Bazuar në raportet vjetore të publikuara nga ProCredit Holding, Raiffeisen Bank International, dhe Nova Ljubljanska Banka.

është një nga vendet më të rëndësishme sepse përfaqëson rreth 14.1 përqind të gjithë asetëve të grupit. Gjatë vitit 2016, grupi ka mbyllur njësitë në Bolivi dhe Meksikë si pasojë e mosrealizimit të profitit. Mbyllja e këtyre dy njësive është reflektuar në rritjen e kapitalit të klasit të parë të grupit. PCH është në përpjekje të ndryshimit të modelit të biznesit. Një nga planet strategjike të grupit është ristrukturimi i bazës së klientëve, duke zhvendosur portfolion nga ndërmarrjet e vogla drejt ndërmarrjeve të mëdha dhe atyre që kanë potencial për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës, dhe kjo fazë tranzitore është planifikuar të përmbyllet në vitin 2017. Po ashtu, në dy vitet e fundit, PCH ka arritur që të rrisë përdorimin e bankngut elektronik, duke mundësuar kështu zvogëlimin e filialeve të bankës. PCH ka treguar progres gjatë vitit 2016 duke përmirësuar kualitetin kreditor si dhe efikasitetin, masa që kanë qenë të nevojshme për të kompenzuar vështirësitë në gjenerimin e të hyrave në kushtet kur në treg po mbizotërojnë normat e ulëta të interesit. Duke qenë të sukseshëm në strategjinë e tyre të të bërit biznes, PCH në dhjetor të 2016 listoi për herë të parë aksionet e saj në Bursën e Frankfurtit, më çmim fillestar prej 12.29 euro për aksion, ndërsa në fund të ditës së parë të tregtimit çmimi i fundit arriti në 13.01 euro.


Grupi është përqëndruar që të zgjerojë portfolion kreditor për shumat që tejkalojnë vlerën referente prej 30 mijë euro të përcaktuar nga grupi. Në fund të vitit 2016, gjithë kreditë e PCH arritën vlerën prej 3.6 miliardë euro, që nëse përjashtohen njësitë e shitura në Bolivi dhe Meksikë, përkon me rritje vjetore prej 2.4 përqind. Megjithatë rritja ishte nën pritshmëritë e menaxhmentit të grupit, si rezultat i shitjes së njësive dhe i reduktimit të portofolive nën vlerën 30 mijë euro (figura 10). Viteve të fundit PCH ka ndryshuar strategjinë e investimit, duke u fokusuar drejtë kreditimit të ndërmarrjeve kundrejt ekonomive familjare. Në dhjetor 2016, nga gjithë kreditë, 90.9 përqind përbëhet nga kreditë ndaj ndërmarrjeve përdërisa kreditë për ekonomitë familjare përbëjnë pjesën tjetër dhe atë kryesisht për qëllime të blerjes dhe renovimit të patundshmërive. Në vitin 2016, PCH ka arritur marrëveshje me Bankën Evropiane të Investimeve për skemën e garantimit të kredive për NVM-të, në regionin e Evropës Lindore dhe Juglindore.

Ngjashëm me kreditë, edhe vlera e gjithë depozitave arriti në 3.5 miliardë euro, që konsiston me një rënie vjetore prej 8.4 përqind, megjithëse nëse përjashtohen njësitë e shitura, vlera e depozitave u karakterizua me rritje prej 6.2 përqind. Depozitat e kursimit shënuan rritje më të theksuar, përdërisa depozitat e afatizuara shënuan rënie (figura 10).

Grupi realizoi një vit financiar shumë të mirë, pavarësisht kushteve ekonomike jo të favorshme. Profiti i realizuar arriti në 61.0 milionë euro, që ju afrua profitit në vitin paraprak që kapte shumën prej 61.3 milionë euro. Ky rezultat ndikoi që edhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit të jetë më i ulët se në vitin paraprak (9.6 përqind në vitin 2016 nga 10.5 përqind në vitin 2015) (figura 11). Profiti më i ulët i realizuar kryesisht i atribuohet rënies së gjithë të hyrave operacionale për 2.1 përqind. Normat e ulëta të interesit në nivel global, si dhe plani strategjik i grupit për tërheqje nga linjat kreditorë nën vlerën prej 30 mijë euro, kanë rezultuar në rënien e të hyrave nga interesi për 11.3 përqind në vitin 2016. Rrjedhimisht, edhe neto të hyrat nga interesi shënuan rënie prej 11.5 përqind (29.9 milionë euro në vitin 2016).

Megjithatë, rënia e të hyrave nga interesi është kompenzuar deri në një masë me zvogëlimin e shpenzimeve operacionale dhe shpenzimeve për provizione, si rezultat i përmirësimit të kualitetit kreditor. Përmirësimi i kualitetit kreditor bëri që shpenzimet për net provizionet për humbje të mundshme të kredive të zvogëlohet në 18.6 milionë euro, nga 42.1 milionë euro në vitin 2015. Shpenzimet operacionale shënuan rënie për 6.3 përqind, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve për personel për 10.6 përqind.

Figura 10. Ecuria e kredive dhe depozitave të PCH-së, në përqindje



*Duke përfshirë edhe njësitë e mbyllura në Bolivi dhe Meksikë
Burimi: ProCredit Holding (2017)

Rritja e kapitalit aksionar si dhe rënia e gjithsej asetëve me peshe rreziku, ndikoi që raporti i kapitalit rregullativ të grupit të arrij në 15.7 përqind në vitin 2016, nga 12.1 përqind sa ishte në vitin 2015 (figura 11). Po ashtu, niveli i lartë i likuiditetit të grupit kryesisht i atribuohet kërkesave rregullatore në vendet ku operon grupi.


Performanca e grupit influencohet nga zhvillimet makroekonomike dhe kushtet në tregjet financiare në vendet në të cilat operon, faktor që ndikojnë në sjelljen konsumatore. Regjioni i Evropës Juglindore (përfshirë Kosovën), ku PCH ka të koncentruar pjesën më të madhe të asetëve, gjatë vitit 2016 u karakterizua me rritje të aktivitetit ekonomik, kryesisht si rezultat i rritjes së kërkesës në Eurozonë. Regjioni i Evropës Lindore pritet të mbetet sfidues, ndikuar nga efektet e konfliktit potencial mes Rusisë dhe Ukrainës, megjithëse Ukraina që në vitin 2015 u përball me rënie ekonomike prej 9.9 përqind, në vitin 2016 shënoi një rritje ekonomike prej 1.5 përqind. Në kuadër të këtij rajoni, edhe Moldavia dhe Gjeorgjia shënuan rritje ekonomike prej 2.0 përqind dhe 3.4 përqind në vitin 2016, respektivisht, Tregu i Amerikës Jugore, që konsiston me njësitë në Ekuador dhe Kolumbi, pritet të ndikohet nga zhvillimet në tregun e çmimeve të naftës. Gjatë vitit 2016, këto vende u karakterizuan me rënie ekonomike prej 2.3 përqind në Ekuador (rritje 0.3 përqind në 2015) ndërsa Kolumbia shënoi ngadalësim të rritjes ekonomike prej 2.2 përqind (3.1 përqind në vitin 2015), kryesisht si pasojë e çmimeve të ulëta të naftës, si dhe dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në fillim të vitit të 2016 në Ekuador.

Në vitin 2016, ekonomia e Gjermanisë shënoi normë të rritjes prej 2 përqind, që ishte performancë më e mirë ekonomike se disa vende të tjera në Evropë. Si rezultat i politikës ekspansioniste monetare, margjina e interesit u ngushtua edhe më tej, çka do të vazhdojë të paraqes sfidë për sektorin bankar në gjenerimin e të hyrave neto nga interesi.

Raiffeisen Bank International – RBI (Austri)


Vlera e gjithsej asetëve të grupit bankar Raiffeisen Bank International (RBI) zbriti në 111.9 miliard euro në vitin 2016, që paraqet një rënie vjetore prej 2.2 përqind. Zvogëlimi i asetëve të RBI-së në masë të madhe u ndikua nga shitja e kompanisë lizing në Poloni dhe i degës bankare në Sloveni. Sipas shtrirjes regionale, Austria mbanë pozitën udhëheqëse në strukturën e asetëve, duke përfaqësuar 27.3 përqind të gjithsej asetëve të grupit, pasuar nga Evropa Qendrore si treg tjetër mjaft i rëndësishëm që përfaqëson rreth 26.4 përqind të gjithsej asetëve të grupit. Evropa Juglindore me 20.3 përqind është e treta e cila pasohet nga Evropa Lindore me përfaqësim prej 13.7 përqind të gjithsej asetëve të grupit. Pjesa tjetër përfshinë asetet e disa njësiteve në Poloni, Slloveni, Azi dhe Amerikë, njësi të cilat janë planifikuar të reduktohen apo të shiten (figura 12). Raiffeisen Bank që operon në Kosovë vazhdon të ketë pjesëmarrje mjaft të ulët prej 0.8 përqind në gjithsej asetet e RBI-së. Regjioni i Evropës Qendrore në vitin 2016 u karakterizua me rritje më të dobët ekonomike prej 2.7 përqind. Megjithëse u ndikua pozitivisht nga rritja ekonomike në Gjermani, nga rimëkëmbja ekonomike në vendet e eurozonës si dhe nga politikat monetare ekspansioniste në disa vende të Evropës Qendrore, norma e rritjes ekonomike në këtë region qëndroi nën nivelin e vitit të kaluar që ishte rreth 3.5 përqind. Në kuadër të vendeve në Evropën Juglindore ekonomia e Serbisë dhe Kroacisë ndikuan në përshpejtimin ekonomik që e karakterizoi regjionin si tërësi. Aktiviteti ekonomik në regjionin e Evropës Lindore u përmirësua,

Figura 11. Treguesit e efikasitetit të PCH-së, në përqindje



Burimi: ProCredit Holding (2017)

Figura 12. Struktura e asetëve të RBI-së, në përqindje




Burimi: Raiffeisen Bank International (2017)

mbështetur kryesisht nga Rusia, që përfitoi nga rritja e çmimeve të gazit. Ekonomia e Austrisë në vitin 2016 shënoi rritje të moderuar ekonomike, me normë prej 1.5 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme (rritja e konsumit privat që u nxit nga reforma në sistemin e taksave) si dhe investimet në ndërtim.

Portfolio kreditore e RBI shënoi rritje për 0.8 përqind në vitin 2016, duke arritur në 70.5 miliardë euro, rritje që kryesisht i atribuohet rritjes së kreditimit të ekonomive familjare. Rritja e kreditimit ishte më e theksuar në filialet në Rusi, Republikën Çeke dhe Slovaki. Ndërsa, kreditimi ndaj NVM-ve shënoi rënie, që kryesisht ishte pasojë e shitjes së njësisë lizing në Poloni. Vlera e depozitave në vitin 2016 arriti në 71.5 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 3.7 përqind. Kjo rritje ishte rezultat i rritjes së depozitave të ekonomive familjare, veçanërisht në Republikën Çeke, Rusi, Slovaki dhe Rumani. Depozitat e NVM-ve poashtu shënuan rritje përderisa depozitat e korporatave shënuan rënie, kryesisht në zyrën qendrore të RBI si dhe në Poloni dhe Sllovaki. Si rrjedhojë e rritjes më të lartë të depozitave, raporti kredi/depozita u zvogëluar në 98.6 përqind nga 101.3 përqind në vitin 2015 (figura 13).

Figura 13. Ecuria e kredive dhe depozitave të RBI-së, në përqindje




Burimi: Raiffeisen Bank International (2017)

Si pasojë e nivelit të ulët të normave të interesit, RBI u përball me rënie të të hyrave operacionale, mirëpo profiti neto u ndikua pozitivisht nga rënia e theksuar e shpenzimeve për provizione. Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave për RBI shënoi rritje në 60.7 përqind në vitin 2016, nga 59.1 përqind në vitin paraprak, si pasojë e rënies më të theksuar të të hyrave operacionale (figura 14). Rënia prej 4.8 përqind e gjithsej të hyrave operacionale u ndikua kryesisht nga rënia prej 11.8 përqind e të hyrave neto nga interesi, që pjesërisht i atribuohet luhatjeve të mëdha valutore (zhvlerësimi valutor në Evropën Lindore), si dhe normave të ulëta të interesit në shumë vende të grupit bankar dhe nivelit të lartë të likuiditetit në treg. Rënia e shpenzimeve operacionale për 2.3 përqind i atribuohet kryesisht zhvlerësimit valutator në Evropën Lindore, si dhe rënies së komisioneve për sigurimin e depozitave. Rënia e shpenzimet tjera administrative që kontribuoi në rënien e gjithsej shpenzimeve administrative ishte kryesisht rezultat i mbylljes së disa filialeve.

Gjatë vitit 2016, shpenzimet për provizione për humbje të mundshme të kredive u zvogëluar për 40.3 përqind në bazë vjetore, apo për 509.4 milionë euro. Zvogëlimi i provizioneve ishte rezultat i shitjes së kredive jo-performuese të kolateralizuara si dhe përmirësimit të vlerësimit kreditor të klientëve korporativ. Zvogëlimi i shpenzimeve për provizione ndaj humbjeve nga kreditë ishte më i theksuar në Ukrainë, Azi, zyrën qendrore si dhe Hungari. Rrjedhimisht, rënia e shpenzimeve për provizione ndikoi që RBI të përmbyll vitin me profit neto në vlerë prej 463.1 milionë euro, krahasuar me profitin prej 378.8 milionë euro të realizuar në vitin 2015.

Figura 14. Treguesit e efikasitetit të RBI-së, në përqindje



Burimi: Raiffeisen Bank International (2017)

Profiti i realizuar gjatë vitit 2016 ndikoi në përmirësimin e Kthimit Mesatar në Kapital (KMK) në 10.3 përqind, nga 8.5 përqind sa ishte për vitin 2015. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK) në vitin 2016 qëndroi në 19.2 përqind, krahasuar me 17.4 përqind sa ishte në vitin 2015, e që mbetet mjaft mbi nivelin minimal të përcaktuar me kërkesat rregullatore (figura 14). Përmirësimi i rrezikut kreditor rezultoi nga rënia e kredive jo-performuese për 1.8 miliardë euro. Rrjedhimisht, raporti i kredive joperformuese ndaj

gjithsej kredive u zvogëluar në 9.2 përqind, nga 11.9 përqind sa ishte në vitin 2015. Po ashtu, si rezultat i rënies së kredive jo-përformuese, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione arriti në 75.6 përqind nga 71.3 përqind sa ishte në vitin 2015. Në fund të vitit 2016, RBI ka aprovuar bashkimin me Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB). Ky vendim ndikoi që aksionet e RBI që listohen në bursën e Vjenës të përformojnë dukshëm më mirë. Çmimi për aksion të RBI-së në bursën e Vjenës në ditën e fundit të vitit 2016 u rrit në 17.38 euro, krahasuar me 13.61 euro sa ishte në ditën e fundit të vitit 2015.

Zhvillimet ekonomike në vendet ku vepron grupi RBI pritet të ndikojnë pozitivisht në performancën e grupit. Evropa Qendrore e cila u karakterizua me rritje të dobët ekonomike, në vitin 2017 pritet të rimëkëmbet si rezultat i politikave ekspansioniste monetare, rritjes së investimeve si dhe rritjes së konsumit nga ekonomitë familjare. Ngjashëm, ekonomitë e Evropës Juglindore pritet që gjatë vitit 2017 të kenë ritëm të përshpejtuar të rritjes ekonomike. Ekonomia e Evropës Lindore po përballlet me vështirësi të rritjes, në mungesë të faktorëve shtytës të brendshëm dhe të jashtëm. Ekonomia e Rusisë pritet të mbështetet në trendin pozitiv të çmimeve të naftës, përderisa Ukraina dhe Belarusia priten të karakterizohen me tkurrje ekonomike në vitin 2017. Ekonomia e Austrisë pritet që gjatë vitit 2017 të vazhdojë me rikuperim të aktivitetit ekonomik, mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme (konsumi privat dhe investimet kapitale), si dhe nga performanca më e mirë e eksporteve kundrejt vitit 2016.


Nova Ljubljanska Banka- NLB (Slloveni)

Grupi bankar NLB u karakterizua me rritje të aktivitetit në vitin 2016 krahasuar me vitin paraprak. Vlera e gjithsej asetëve të grupit arriti në 12.0 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.8 përqind. Sa i përket shtrirjes rajonale, Sllovenia, që është vend i origjinës të grupit bankar NLB, përfaqëson tregun kryesor me afër 69.7 përqind të gjithsej asetëve të grupit. Në Evropën Juglindore ku grupi ka prezencë të theksuar, pjesa më e madhe e asetëve të grupit është e investuar në Maqedoni dhe më pas Bosnjë, ndërsa në Evropën Perëndimore pjesëmarrja e grupit është shumë e ulët që konsiston në 0.4 përqind të gjithsej asetëve të grupit (figura 15). NLB Banka që operon në Kosovë, në dhjetor 2016, kishte pjesëmarrje prej 4.3 përqind në gjithsej asetet e grupit.

Grupi NLB vazhdoi të karakterizohet me rënie të aktivitetit kreditues edhe në vitin 2016, megjithëse me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak. Vlera e gjithsej kredive ishte 7.9 miliardë euro, një rënie vjetore prej 5.4 përqind. Ndërsa, depozitat u karakterizuan me rritje vjetore prej 4.6 përqind, vlera e të cilave në vitin 2016 arriti në 9.4 miliardë euro (figura 16). Rënia e theksuar e kredive, krahas rritjes së depozitave, ka ndikuar që raporti kredi/depozita të zvogëlohet në 83.7 përqind në vitin 2016, nga 92.5 sa ishte në vitin 2015.


Grupi NLB në vitin 2016 shënoi rënie të raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave në 60.9 përqind, nga 61.6 përqind sa ishte në vitin 2016, si rezultat i rënies më të lartë të shpenzimeve kundrejt rënies që shënuan të hyrat (figura 17).

Figura 15. Struktura e asetëve të NLB Group, në përqindje



Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2017)

Figura 16. Ecuria e kredive dhe depozitave të NLB Group, në përqindje



Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2017)

Rënia e të hyrave operacionale u diktua nga rënia prej 6.7 përqind e të hyrave neto nga interesi, që kryesisht rezultoi nga investimet e Bankës së Sllovenisë në tregjet financiare që aktualisht përballen me norma të ulëta të interesit. Si rezultat i një ambienti të tillë, grupi NLB synoi që të menaxhoj më mirë shpenzimet e interesit duke riçmimuar disa burime të financimit në përshtatshmëri me normat aktuale të kthimit nga investimet në treg. Gjithashtu, si përgjigje ndaj normës negative të depozitave të vendosur nga BQE, grupi NLB ka ndërmarrë vendim për aplikim të normës negative mbi depozitat e mëdha të korporatave në Slloveni. Nën vëmendjen e menaxhmentit, shpenzimet shënuan një rënie vjetore prej 2.8 përqind në vitin 2016, veçanërisht shpenzimet administrative që u zvogëluan për 7.3 përqind.


Përkundër normave të ulëta të interesit në tregjet financiare, nivelit të lartë të tepicës së likuiditetit dhe konkurrencës së ashpër në treg për tërheqje të projekteve investuese, grupi NLB megjithatë arriti që të realizoj profit prej 110 milionë euro apo 19.7 përqind më të lartë se në vitin 2015, si rezultat i rritjes së kredive të reja në disa njësi dhe menaxhimit më të mirë të shpenzimeve. Kontribues në rritjen e profitit ishte kryesisht banka e Sllovenisë dhe disa banka në Evropën Juglindore. Ky rezultat u reflektua edhe në normën e kthimit në mesataren e kapitalit (KMK), që u përmirësua në 7.4 përqind nga 6.6 përqind sa ishte në vitin 2015.

Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK) në vitin 2016 shënoi rritje në 17.0 përqind, nga 16.2 përqind sa ishte në vitin 2015, përkundër ndarjes së dividendave gjatë vitit (figura 17). Ecuri pozitive u shënuan edhe në cilësinë e portofolit kreditor, ku raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive u

zvogëlua konsiderueshëm në 13.8 përqind nga 19.3 përqind në vitin 2015, si rezultat i përmirësimit substancial të strukturës së portfolios kreditorë. Mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione në vitin 2016 ishte 64.6 përqind krahasuar me 62.8 përqind në vitin 2015.

Zhvillimet ekonomike në vendet ku operon grupi NLB pritet të ndikojnë pozitivisht në performancën e grupit. Sllovenia vazhdoi të ketë qëndrueshmëri të rritjes ekonomike edhe gjatë vitit 2016. Sektorët eksportues u karakterizuan me përmirësim të theksuar. Krahas performancës së mirë të aktivitetit tregtar, kërkesa e brendshme pritet të përforcohet në vitin pasues. Sektori i ndërtimit mbetet faktor mbështetës në rritjen ekonomike të vendit. Ndërsa një nga sfidat kryesore për sektorin bankar në Slloveni do të jetë gjenerimi i të hyrave, përderisa konkurrenca e ashpër në tregun bankar të Sllovenisë është reflektuar në rënie të normave të interesit në vazhdimësi.

Figura 17. Treguesit e efikasitetit të NLB Group, në përqindje



Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2017)

4. Ekonomia e Kosovës

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me rritje të aktivitetit gjatë vitit 2016 kundrejt vitit paraprak. Sipas statistikave preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për BPV-në tremujore, rezulton se ekonomia e Kosovës shënoi rritje mesatare përgjatë katër tremujorëve të vitit 2016 prej 3.4 përqind, përderisa vlera nominale e BPV-së arriti në rreth 5.98 miliardë euro.

Rritja e aktivitetit ekonomik është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, gjegjësisht rritja e investimeve (10.4 përqind) dhe konsumit (2.9 përqind). Faktorët të cilët kanë ndikuar në rritjen e kërkesës së brendshme ndër të tjera janë edhe rritja e kreditimit bankar (10.4 përqind), rritja e investimeve publike (9.8 përqind), rritja e flukseve hyrëse të transfereve nga jashtë në formë të remitencave (3.8 përqind) si dhe rritja e shpenzimeve të sektorit publik për paga dhe mëditje (3.6 përqind). Neto eksportet vlerësohet të jenë karakterizuar me thellim të konsiderueshëm të deficitit tregtar në këtë periudhë (8.0 përqind). Rritja e deficitit tregtar i atribuohet rritjes prej 5.6 përqind të importit të mallrave dhe shërbimeve, përderisa eksporti i mallrave dhe shërbimeve shënoi rritje prej vetëm 2.4 përqind.


Sa i përket strukturës, BPV-ja sipas qasjes së shpenzimeve dominohet nga konsumi, që në vitin 2016 kishte një pjesëmarrje prej 101.3 përqind në gjithsej BPV. Në anën tjetër, pjesëmarrja e investimeve në BPV mbeti në rreth 28 përqind, përderisa komponenta e neto eksporteve vazhdoi të ketë pjesëmarrje negative në BPV me normë prej 28.8 përqind. Sipas qasjes së prodhimit, struktura e BPV-së në Kosovë dominohet nga sektori i shërbimeve, që ka një pjesëmarrje prej rreth 50.3 përqind në strukturën e përgjithshme të BPV-së, pasuar nga administrimi publik (12.5 përqind), sektori i tregtisë dhe bujqësisë (12.4 përqind) (10.7 përqind në gjithsej BPV). Pjesëmarrje të konsiderueshme në BPV-në e vendit kanë edhe sektori i industrisë përpunuese (10.3 përqind) dhe afarizmi me pasuri të patundshme (8.2 përqind). Gjatë vitit 2016, rritja reale e ekonomisë së Kosovës është mbështetur kryesisht nga rritja në aktivitetin e sektorit të bujqësisë (7.6 përqind), tregtisë (4.8 përqind) dhe aktiviteteve financiare (12.4 përqind). Ndërsa, rënie reale vlerësohet të jetë shënuar tek afarizmi me pasuri të patundshme (1.5 përqind), industri përpunuese (1.1 përqind) dhe administrim publik (0.4 përqind).

Sipas parashikimeve të BQK-së, ekonomia e Kosovës në vitin 2017 pritet të shënojë rritje reale prej rreth 3.7 përqind. Bartës kryesor i rritjes në vitin 2017 pritet të jenë investimet, të cilat parashihet të shënojnë rritje reale prej 6.8 përqind, bazuar në parashikimet për rritje të konsiderueshme të investimeve publike (16.9 përqind) dhe të investimeve private (3.3 përqind). Kontribut të rëndësishëm në rritjen e investimeve pritet të ketë kreditimi bankar, që pritet të vazhdon të karakterizohet me ritëm më të shpejtë të rritjes dhe norma të ulëta të interesit. Rritjes së pozicionit të përgjithshëm të investimeve pritet t'i kontribuojë edhe rritja e IHD-ve, të cilat në vitin e kaluar shënuan rënie të konsiderueshme. Gjithashtu, ndryshimet në politikën tatimore gjatë viteve të kaluara pritet të nxisin investimet private.

Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënojë rritje reale prej 2.1 përqind, bazuar në pritjet që konsumi privat do të rritet me 2.4 përqind dhe konsumi publik me 0.6 përqind. Faktorët që pritet të ndikojnë në rritjen e konsumit privat, ndër të tjera, janë edhe rritja e remitencave dhe rritja e kredive. Deri në fund të vitit 2017, remitencat pritet të shënojnë rritje vjetore prej rreth 2.8 përqind. Gjithashtu, kreditë për ekonomitë familjare, të cilat në vitet e fundit kanë shënuar rritje të konsiderueshme (rritje mesatare vjetore prej 12 përqind në tre vitet e fundit), pritet të vazhdojnë këtë trend të rritjes edhe në vitin 2017. Eksportet neto të mallrave dhe shërbimeve pritet të kenë një kontribut më të vogël negativ në BPV krahasuar me vitin e kaluar, një supozim i mbështetur kryesisht në parashikimet për rritje të çmimeve të metaleve që priten të ndikojnë në rritjen e vlerës së gjithsej eksporteve.

Ekonomia e Kosovës në vitin 2016 u karakterizua me ngritje të lehtë të nivelit të çmimeve kundrejt vitit paraprak. Norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur përmes indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), ishte 0.3 përqind (figura 18). Çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit shënuan rritje prej 8.1 përqind, pasuar nga rritja e çmimeve të veshmbathjes për 2.7 përqind. Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar kryesisht te rryma, gazi e lëndët tjera djegëse (2.3 përqind) si dhe shërbimet e transportit (1.9 përqind). Me rënie prej 0.1 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit, që përfaqësojnë rreth 33.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar.

Figura 18. Ndryshimi mesatar vjetor i IÇK-së, në përqindje



Zhvillimet në sektorin fiskal gjatë vitit

2016 tregojnë për një rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Të hyrat buxhetore⁶ në vitin 2016 arritën vlerën neto prej 1.60 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.6 përqind, ndërsa shpenzimet buxhetore⁷ arritën vlerën prej 1.66 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.7 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës në vitin 2016 shënoi deficit primar buxhetor prej rreth 61.1 milionë euro, krahasuar me deficitin buxhetor prej rreth 111.4 milionë euro në vitin 2015.

Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arritën vlerën prej 232.1 milionë euro (17.4 përqind rritje), pasuar nga të hyrat tatimore indirekte të cilat arritën vlerën prej 1.2 miliardë euro (11.2 përqind rritje), ndërsa të hyrat jo-tatimore shënuan rënie prej 8.3 përqind dhe arritën vlerën prej 175.3 milionë euro. Sa i përket shpenzimeve, pothuajse të gjitha kategoritë u karakterizuan me rritje përveç mallrave dhe shërbimeve të cilat shënuan rënie. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan rritje prej 3.6 përqind dhe arritën vlerën prej 543.7 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu shënuan rritje për 13.5 përqind dhe arritën vlerën prej 474.7 milionë euro. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 26.8 përqind të gjithë shpenzimeve buxhetore, shënuan rritje prej 9.8 përqind dhe arritën vlerën 443.6 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rënie për 1.3 përqind dhe arritën vlerën prej 202.8 milionë euro.

Borxhi publik arriti në 852.7 milionë euro që është për 13.9 përqind më i lartë krahasuar me vitin paraprak, ndërsa si përqindje e BPV-së borxhi publik ka arritur në 14.5 përqind nga 13.0 përqind sa ishte në vitin 2015. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm prej 26.8 përqind (që arriti në 479.0 milionë euro), ndërkohë që borxhi i jashtëm publik ka shënuar një ngritje të lehtë prej 0.7 përqind duke arritur në 373.8 milionë euro. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithë borxhin e brendshëm është zvogëluar në 43.8 përqind nga 59.6 përqind sa ishte në vitin 2015.

Ekonomia e Kosovës është e karakterizuar me disekuilibër në sektorin e jashtëm, për shkak të vlerës së ulët të shtuar nga sektorët prodhues dhe rritjes së kërkesës së brendshme. Rritja e konsumit dhe investimeve në vitin 2016 ka ndikuar në rritjen e importit në vend, gjë që është

⁶ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

⁷ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.


përkthyer në rritje të deficitit në llogarinë rrjedhëse. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale arriti vlerën prej 534.6 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 471.4 milionë euro në vitin paraprak, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së të ardhurave parësore. Në anën tjetër, bilancet pozitive të shërbimeve dhe të ardhurave dytësore shënuan rritje.

Deficiti tregtar i mallrave arriti vlerën prej 2.5 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.4 përqind (figura 19). Në vitin 2016, vlera e eksportit të mallrave arriti në 309.7 milionë euro, një rënie vjetore prej 4.8 përqind. Rënia e vlerës së eksportit të mallrave gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rënies së eksporteve të metaleve bazë, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve (rreth 35.9 përqind). Rënia e vlerës së gjithsej eksporteve të metaleve bazë ishte kryesisht pasojë e rënies së prodhimit të nikelit në vend, si dhe rënies së çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare. Me rënie u karakterizuan edhe eksportet e tekstilit dhe artikujt e tekstilit, si dhe eksportet e makinerisë dhe pajisjeve elektrike. Në anën tjetër, eksportet e produkteve minerale shënuan rritje, kryesisht si rezultat i rritjes së vlerës së eksportit të energjisë elektrike. Gjithashtu, eksportet e produkteve të plastikës dhe gomës, si dhe eksportet e pijeve dhe duhanit shënuan rritje.

Vlera e gjithsej mallrave të importuara arriti në 2.8 miliardë euro, një rritje vjetore prej 5.9 përqind. Në kuadër të importit të mallrave, me rritje u karakterizua importi i mjeteve të transportit, makinerisë dhe i pajisjeve mekanike, produkteve të plastikës dhe gomës, ushqimeve të përgatitura, etj. Rënia e vlerës së eksporteve dhe rritja e vlerës së mallrave të importuara rezultoi në zvogëlim të shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksporte në 11.1 përqind (12.3 përqind në vitin 2015).


Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 565.0 milionë euro, një rritje kundrejt vitit paraprak prej 23.6 përqind. Vlera e shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 9.1 përqind, duke arritur në 1.0 miliard euro. Në anën tjetër, vlera e importit të shërbimeve shënoi rënie prej 4.3 përqind dhe arriti në 473.4 milionë euro. Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet e transportit u karakterizuan me rritje vjetore prej 12.4 përkatësisht 6.6 përqind, përderisa kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit shënoi rënie prej 11.6 përqind. Sa i përket importit të shërbimeve, dy kategoritë kryesore të shërbimeve, gjegjësisht shërbimet e transportit dhe të udhëtimit, shënuan rënie prej 15.1 përqind përkatësisht rritje prej 4.2 përqind.

Figura 19. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, në miliardë euro



Burimi: ASK (2017)

Figura 20. Pranimet e remitencave



Burimi: BQK (2017)

Llogaria e të ardhurave parësore shënoi vlerën prej 80.9 milionë euro, që paraqet një rënie prej 12.6 përqind. Bilanci i të ardhurave nga kompenzimi i punonjësve u zvogëlua për 5.6 përqind, ndërsa bilanci i të ardhurave të realizuara nga investimet u zvogëlua për 1.6 përqind. Në anën tjetër, llogaria e të ardhurave dytësore shënoi vlerën prej 1.1 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.2 përqind. Kjo rritje e të ardhurave dytësore kryesisht i atribuohet nivelit më të lartë të remitencave të pranuar në Kosovë, të cilat shënuan vlerën prej 691.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.8 përqind (figura 20).


Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 215.9 milionë euro, që paraqet nivel më të ulët krahasuar me vlerën prej 308.8 milionë euro sa ishte në vitin 2015. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me zvogëlim të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione si dhe investimet në instrumentet e borxhit. Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 85.3 përqind të gjithë IHD-ve, shënoi vlerën prej 179.0 milionë euro që është për 21.5 përqind më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu, IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 36.9 milionë euro, që janë për 54.3 përqind më të ulëta krahasuar me vitin 2015 (figura 21). Në Kosovë, IHD-të janë kryesisht të përqendruara në sektorët e ekonomisë si patundshmëria, ndërtimtaria, shërbimet financiare dhe tregëtia. Në vitin 2016, rënie e IHD-ve u evidentua pothuajse në të gjithë sektorët. Rënia më e theksuar ishte tek sektori i patundshmërive dhe sektori i shërbimeve financiare, sektorë që u karakterizuan me rënie vjetore prej 11.6 përkatësisht 70.5 përqind. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Zvicra paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në vitin 2016 (61.8 milionë euro), pasuar nga Turqia me 44.4 milionë euro, Shqipëria me 28.6 milionë euro, Gjermania me 25.7 milionë euro, etj.

Në vitin 2016, borxhi i jashtëm i Kosovës (borxhi i jashtëm privat dhe borxhi i jashtëm publik), arriti në 2.0 miliardë euro, që është për 5.9 përqind më i lartë krahasuar me vitin paraprak. Si përqindje e BPV-së, borxhi i jashtëm bruto arriti në 34.2 përqind. Borxhi i jashtëm publik kishte vlerën prej 373.8 milionë euro, një pjesëmarrje prej 18.3 përqind në gjithë borxhin e jashtëm bruto. Në strukturën e borxhit të jashtëm, Banka Botërore ka një pjesëmarrje prej 10.1 përqind, pasuar nga FMN-ja që ka një pjesëmarrje prej 9.0 përqind, si dhe kreditorët tjerë (më shumë se gjysma e borxhit ndaj kreditorëve tjerë është kreditim ndërmjet kompanive) që kanë një pjesëmarrje dominuese prej 80.9 përqind.

4.1 Tregu i Letrave me Vlerë


Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës që nga fillimi i operimit ka treguar trend pozitiv të rritjes dhe zhvillimit. Vëllimi i

Figura 21. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Figura 22. Ecuria e tregut të letrave me vlerë




Burimi: BQK (2017)

ankandeve të letrave me vlerë ka shënuar rritje gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare, rritje e mbështetur si nga oferta ashtu edhe nga kërkesa. Në vitin 2016, numri i ankandeve të realizuara u zvogëlua në 19 nga 21 sa ishin realizuar në vitin paraprak, mirëpo shuma e emetuar shënoi rritje (figura 22). Gjithsej shuma e emetuar e letrave me vlerë arriti në 420.00 milionë euro në vitin 2016, nga 398.55 milionë sa ishte në vitin paraprak. Për më tepër, fillimi i emetimit të fletëobligacioneve qeveritare që nga viti 2014 ka ndikuar në rritjen e afatit të maturimit. Në fund të vitit 2016, afati mesatar i maturimit të letrave me vlerë u rrit në 23.0 muaj, krahasuar me 19.7 muaj në vitin 2015 dhe 13.5 muaj në vitin 2014.⁸

Investimet në letra me vlerë konsiderohen si instrumente atraktive dhe të sigurta për bankat dhe institucionet tjera financiare. Kjo reflektohet përmes shumës së ofertuar nga subjektet pjesëmarrëse në ankande, që në çdo ankand ka tejkaluar shumën e shpallur nga qeveria. Raporti i shumës së ofertuar ndaj shumës së shpallur për gjatë vitit 2016 ishte 2.17 (1.55 në vitin 2015). Poashtu shuma e shpallur në ankande ishte për 3.7 përqind më e lartë krahasuar me vitin 2015, përdërisa shuma e ofertuar e subjekteve pjesëmarrësve shënoi rritje prej 44.5 përqind (figura 23). Struktura e emetimeve të letrave me vlerë dominohet nga bonot e thesarit, që kanë pjesëmarrje prej 61.9 përqind në gjithsej emetimet gjatë vitit 2016 (72.4 përqind në vitin 2015). Megjithatë, emetimet në formë të fletobligacioneve (instrumente


me afat mbi 2 vite) shënuan rritje gjatë vitit 2016, duke zënë 38.1 përqind të shumës së përgjithshme të emetuar krahasuar me pjesëmarrjen prej 30.1 përqind në vitin paraprak (figura 24). Norma e përgjithshme mesatare e interesit në letrat me vlerë zbriti në 0.79 përqind, krahasuar me 1.94 përqind në vitin paraprak, duke reflektuar raportin kërkesë-ofertë në ankande. Rënia në normën e interesit kryesisht i atribuohet rritjes së konkurrencës në treg për investime në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës, si produkt që ka ofruar kthime të favorshme në kushtet kur normat e interesit në tregjet e jashtme janë të ulëta, si dhe

Figura 23. Shuma e shpallur dhe e ofertuar, në milionë euro.




Burimi: BQK (2017)

Figura 24. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

Figura 25. Normat mesatare të interesit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës sipas maturimit



Burimi: BQK (2017)

⁸ Afati mesatar i maturimit është llogaritur si mesatare e thjeshtë e afateve të maturimit të letrave me vlerë që ende nuk kanë maturuar në fund të periudhës së cekur në analizë.

kur pozita e likuiditetit në sektorin bankar të Kosovës vlerësohet të jetë në nivel mjaft të lartë. Norma më e lartë mesatare e interesit prej 2.5 përqind u regjistrua në fletëobligacionet me afat maturimi 5 vite, ndërsa norma më e ulët mesatare prej 0.2 përqind u regjistrua në bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë (figura 25). Të gjitha kategoritë e letrave me vlerë bartin norma më të ulëta mesatare të interesit krahasuar me vitin paraprak, me ç'rast fletëobligacionet 5 vjeçare u karakterizuan me rënien më të theksuar vjetore të normës së interesit. Ky zhvillim veçanërisht u favorizua nga oferta dy herë më e lartë për investim në këtë instrument krahasuar me shumën e shpallur nga qeveria.

5. Sistemi Financiar i Kosovës

5.1. Karakteristikat e Përgjithshme

Sistemi financiar i Kosovës ka vazhduar të karakterizohet me rritje të qëndrueshme. Në vitin 2016, vlera e gjithsej asetëve të sistemit arriti në 5.38 miliardë euro, një rritje vjetore prej 9.8 përqind. Rritja ishte kryesisht rezultat i zgjerimit të aktivitetit të sektorit bankar dhe performancës pozitive të fondeve pensionale. Sektori mikrofinanciar dhe i sigurimeve gjithashtu kontribuan në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit, por në shkallë më të ulët, përderisa sektori i ndihmësve financiar vazhdon të ketë peshë të ulët në kuadër të sistemit financiar në vend.

Struktura e sistemit financiar të Kosovës mbetet e dominuar nga sektori bankar, përderisa rritja e vazhdueshme e asetëve të fondeve pensionale është reflektuar në rritjen e pjesëmarrjes së këtij sektori në gjithsej asetet e sistemit financiar (figura 26). Pjesëmarrja e sektorëve tjerë financiar ka mbetur afërsisht e pandryshuar nga vitet paraprake.

Shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë, llogaritur si raport i asetëve të sistemit financiar ndaj Bruto Produktit Vendor (BPV), është rritur gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2016, norma e ndërmjetësimit financiar në vend arriti në rreth 90.0 përqind, krahasuar me 84.5 përqind në vitin paraprak (figura 27). Ndërsa, sa i përket aktivitetit kreditues të sektorit bankar, raporti i kreditimit ndaj BPV-së qëndroi në 37.1 përqind në vitin 2016, një raport i ulët krahasuar me mesataren e vendeve të rajonit (rreth 56 përqind) (figura 28).

Figura 26. Struktura e asetëve të sistemit financiar




Figura 27. Ndërmjetësimi financiar sipas sektorëve në Kosovë




Figura 28. Kredi ndaj BPV-së





Figura 29. Hendeku i Kredisë ndaj BPV-së



Hendeku i kredisë ndaj BPV-së, që tregon për raportin aktual të kredisë ndaj BPV-së krahas potencialit të tij afatgjatë, në vitin 2016 vazhdoi të qëndrojë në territor negativ për Kosovën (figura 29).

Për rrjedhojë, raporti i kreditimit ndaj BPV-së si dhe treguesi i hendekut të kreditimit sugjerojnë hapësirë për rritje të mëtejme të ndërmjetësimit financiar në vend. Megjithatë, rritja e vazhdueshme e kreditimit në vend, dhe atë me ritëm më të përshpejtuar në vitet e fundit, ka ndikuar që Kosova të lëvizë drejt përafrimit me vendet e rajonit. Gjithashtu, ritmi i përshpejtuar i aktivitetit kreditues do të mund të ndikojë në përkeqësimin e portfolios kreditore në një periudhë afatmesme, nëse nuk shoqërohet nga një rritje e përshpejtuar e aktivitetit ekonomik në vend dhe një çasje më proaktive e bankave për të diversifikuar strukturën e kreditimit drejtë sektorëve ekonomik më pak të kredituar dhe strategjikisht të rëndësishëm për ekonominë e vendit.

Sa i përket numrit të institucioneve financiare që e përbëjnë sistemin financiar, gjendja mbetet pothuajse e njëjtë me vitin paraprak. Sektorit të ndihmësve financiarë iu shtuan 4 institucione të reja, duke rritur numrin e tyre në 48, ndërsa numri i institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare u zvogëlua në 16 si rezultat i bashkimit të dy institucioneve tjera mikrofinanciare në një. Si rrjedhojë, në vitin 2016, numri i gjithsej institucioneve financiare të licencuara për të operuar në vend arriti në 91 (tabela 1).

Tabela 1. Numri i institucioneve financiare⁹

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016
Bankat komerciale	9	10	10	10
Kompanitë e sigurimeve	13	14	15	15
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	39	42	44	48
Institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare	17	18	18	16


Burimi: BQK (2017)

5.2 Ekspozimi ndaj sektorit të jashtëm¹⁰

Vlera e aseteve të jashtme neto (AJN) të sistemit financiar të Kosovës në vitin 2016 arriti në 2.5 miliardë euro, një rritje vjetore prej 3.1 përqind. Asetet e jashtme përbënin 45.0 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar (46.6 përqind në vitin 2015) ndërsa detyrimet e jashtme përbënin 7.9 përqind të gjithsej detyrimeve të sistemit (8.2 përqind në vitin 2015).

AJN-të e fondeve pensionale përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej AJN-ve të sistemit financiar (52.0 përqind), pasuar nga AJN-të e BQK-së (34.5 përqind të gjithsej AJN-ve të sistemit

Figura 30. AJN-të sipas sektorëve financiar



Burimi: BQK (2017)

⁹ Numri i institucioneve financiare paraqet numrin e institucioneve që janë të licencuara të operojnë në tregun e Kosovës. Në kuadër të kategorisë së institucioneve mikrofinanciare janë përfshirë edhe pesë institucioneve financiare jobankare të licencuara për aktivitet kredidhënës.

¹⁰ Në këtë kontekst, sistemi financiar përfshinë edhe Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

financiar). Bilancit pozitiv të gjithsej AJN-ve i kontribuojnë edhe AJN-të e sektorit bankar me pjesëmarrje prej 17.3 përqind ndërsa, sektori mikrofinanciar ishte i vetmi që shënoi bilanc negativ prej 3.8 përqind të gjithsej AJN-ve (figura 30).

Ekspozimi i fondeve pensionale ndaj sektorit të jashtëm mbetet i lartë, ku asetet e jashtme përbëjnë 91.9 përqind të gjithsej aseteve të fondeve pensionale, që kryesisht janë në formë të aksioneve dhe ekuiteteve tjera. BQK-ja mbetet institucioni i dytë më i ekspozuar ndaj sektorit të jashtëm, ku 80.4 përqind e aseteve të BQK-së janë të investuara jashtë vendit, kryesisht në formë të depozitave në bankat jashtë vendit dhe në letra me vlerë të huaja. Ndërsa, detyrimet ndaj sektorit të jashtëm përbëjnë 18.9 përqind të gjithsej detyrimeve të BQK-së, kryesisht në formë të llogarisë me FMN. Sektori bankar vazhdoi të ketë ekspozimin më të ulët ndaj sektorit të jashtëm, ndërsa sektori i sigurimeve nuk ka pothuajse fare ekspozim ndaj sektorit të jashtëm. Në vitin 2016, raporti i aseteve të jashtme ndaj gjithsej aseteve të sektorit bankar ishte 16.9 përqind, përderisa raporti i detyrimeve të jashtme ndaj gjithsej detyrimeve të sektorit bankar ishte 4.9 përqind, gjë që reflekton shkallën e ulët të mbështetjes së sektorit bankar në financim të jashtëm.

Për dallim nga sektorët tjerë, sektori mikrofinanciar ka ndërveprim me sektorin e jashtëm vetëm në kuadër të detyrimeve, ku 64.5 përqind e aktivitetit të këtij sektori financohet nga jashtë. Kjo për arsye se sektori mikrofinanciar shfrytëzon linjat kreditore të jashtme për të financuar aktivitetin kreditues, duke pasur parasysh që IMF-të nuk kanë të drejtë ligjore të pranojnë depozita (figura 31).

Vlera e aseteve të sistemit financiar në sektorin e jashtëm arriti në 3.06 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 3.1 përqind (figura 32).¹¹ Rritja e aseteve të jashtme u mbështet kryesisht nga rritja e investimeve të sektorit të fondeve pensionale prej 20.2 përqind, kryesisht në formë të aksioneve dhe ekuiteteve tjera. Poashtu, në rritjen e aseteve të sistemit financiar, ndikoi edhe rritja prej 8.6 përqind e investimeve nga sektori bankar në sektorin e jashtëm, kryesisht në formë të letrave me vlerë dhe depozita.

Në vitin 2016, përkundër rritjes së investimeve në letra me vlerë, rënia e theksuar e depozitave në sektorin e jashtëm ndikoi që gjithsej asetet e jashtme të BQK-së të shënojnë rënie vjetore prej 13.5 përqind.

Figura 31. Ekspozimi i jashtëm sipas sektorëve financiar, dhjetor 2016





Figura 32. Struktura e aseteve në sektorin e jashtëm, në përqindje




¹¹ Në kuadër të kërkesave të sistemit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm nuk është përfshirë kategoria 'paraja e gatshme'. Në statistikën monetare dhe financiare, kategoria 'paraja e gatshme' që ndodhet në trezorët e bankave komerciale trajtohet si aset i jashtëm (kërkesa ndaj jorezidentëve) për faktin se valuta euro nuk është valutë kombëtare e Kosovës, mirëpo në këtë analizë këto mjete nuk janë trajtuar si të tilla për shkak se ato janë mjete që mbahen në bankat në Kosovë.

Kategoria kryesore e aseteve në sektorin e jashtëm janë aksionet dhe ekuitet tjerë, që i përkasin fondeve pensionale, përderisa kjo kategori në vitin 2016 shënoi rritje vjetore prej 20.3 përqind. Investimet në letra me vlerë, si kategoria e dytë në kuadër të aseteve të jashtme, shënuan rritje të theksuar vjetore prej 122.7 përqind në vitin 2016 (rritje prej 19.8 përqind në vitin 2015). Pjesa më e madhe e investimeve në letra me vlerë i përkasin BQK-së, që këtë vit kanë katërfishuar investimet në këto instrumente financiare, ndërsa pjesa e mbetur prej 32.2 përqind të investimeve në letra me vlerë i përkasin bankave komerciale në vend. Kategoria e tretë e aseteve në sektorin e jashtëm janë depozitat, kryesisht të bankave komerciale dhe BQK-së. Në vitin 2016, depozitat u karakterizuan me rënie të theksuar vjetore prej 49.0 përqind, që kryesisht mund të ketë rezultuar pas vendimit të BQE-së për të mbajtur nivelin e normës së interesit në depozita në territor negativ.

Vlera e gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm në vitin 2016 arriti në 539.2 milionë euro, një rritje vjetore prej 3.1 përqind. Në rritjen e detyrimeve të jashtme ndikoi rritja e detyrimeve të sektorit mikrofinanciar prej 52.6 përqind në formë të kredive, pasuar nga rritja e llogarisë së BQK-së në FMN. Struktura e detyrimeve të jashtme dominohet nga llogaria e BQK-së në FMN që shënoi ngadalësim të rritjes vjetore (rritje 5.9 përqind në 2016 ndërsa 19.1 përqind në vitin 2015), pasuar nga kreditë që shënuan rritje të theksuar vjetore prej 28.2 përqind (rënie prej 0.2 përqind në 2015), ndërsa kategoria e tretë e detyrimeve të jashtme janë depozitat, të cilat shënuan rënie vjetore prej 36.1 përqind (figura 33).

Figura 33. Struktura e detyrimeve të jashtme, në përqindje



6. Sektori Bankar i Kosovës

6.1 Struktura e Sektorit Bankar

Sektori bankar vazhdon të jetë i koncentruar nga bankat me pronësi të huaj, të cilat në vitin 2016 menaxhuan 88.9 përqind e aseteve dhe 91.4 përqind e kapitalit të sektorit bankar. Nga bankat me pronësi të huaj, pesë prej tyre kanë vend të origjinës Austrinë, Gjermaninë, Slloveninë, Shqipërinë dhe Serbinë, tri kanë vend të origjinës Turqinë (figura 34) përderisa vetëm dy banka operojnë me pronësi vendore.


Në vitin 2016, sektori bankar shënoi rënie të shkallës së koncentrimit bankar. Shprehur si raport i aseteve të tri bankave më të mëdha ndaj gjithsej aseteve të sektorit, shkalla e koncentrimit bankar shënoi rënie nga 64.3 përqind në vitin 2015 në 62.7 përqind në vitin 2016. Rënia e shkallës së koncentrimit të tregut vërehet edhe përmes rënies së vazhdueshme të Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH) (figura 35). Në strukturën e aseteve, kategoria e kredive shënoi rënie për 1.4 pikë përqindje të shkallës së koncentrimit, krahasuar me rënie prej 1.3 pikë përqindje të koncentrimit në depozita. Rënia e koncentrimit, si në kredi ashtu edhe në depozita, erdhi si rezultat i rritjes më të shpejtë të këtyre zërave nga ana e bankave më të vogla. Në vitin 2016, tri bankat më të mëdha shënuan rritje vjetore të kredive prej 8.3 përqind, përderisa kreditë e bankave të tjera shënuan rritje prej 14.9 përqind. Për sa i përket depozitave, tri bankat më të mëdha shënuan rritje vjetore prej 6.9 përqind, krahasuar me rritjen prej 13.2 përqind në bankat e tjera.

6.2. Aktiviteti i Sektorit Bankar

6.2.1. Asetet


Gjatë vitit 2016, asetet e sektorit bankar të Kosovës u zgjeruan për 7.4 përqind dhe arritën vlerën prej 3.64 miliardë euro (figura 36). Zgjerimi i aseteve kryesisht reflekton përshpejtimin e aktivitetit kreditues gjatë këtij viti. Në rritjen e aseteve të sektorit bankar

Figura 34. Struktura e aseteve të sektorit bankar, sipas pronësisë




Burimi: BQK (2017)

Figura 35. Shkalla e koncentrimit në sektorin bankar



Burimi: BQK (2017)

Figura 36. Struktura e aseteve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2017)

kontribuan edhe dy kategoritë e tjera, përkatësisht letrat me vlerë dhe bilancet me bankat komerciale (tabela 2).

Portfolio i kredive bruto të sektorit është rritur për 10.4 përqind (7.3 përqind në 2015), duke arritur vlerën prej 2.2 miliardë euro. Kreditë neto shënuan rritje prej 11.4 përqind, përderisa përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë ka ndikuar në rënien e stokut të rezervave për humbje të mundshme të kredive për 2.5 përqind.

Tabela 2. Struktura e aseteve të sektorit bankar


Përshkrimi	2013		2014		2015		2016	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	463.3	15.1%	447.1	14.0%	491.0	14.5%	457.3	12.6%
Bilanci me bankat komerciale	339.9	11.1%	390.8	12.3%	316.0	9.3%	342.0	9.4%
Letrat me vlerë	354.5	11.6%	383.8	12.0%	473.3	14.0%	510.3	14.0%
Kreditë bruto	1,805.8	59.0%	1,882.3	59.1%	2,019.5	59.7%	2,230.0	61.3%
Asetet fikse	55.5	1.8%	53.7	1.7%	57.0	1.7%	58.5	1.6%
Asetet tjera	40.3	1.3%	28.8	0.9%	28.5	0.8%	39.0	1.1%
Gjithsejasetet	3,059.3	100%	3,186.6	100%	3,385.3	100%	3,637.1	100%

Burimi: BQK (2017)

Shuma e investimeve të sektorit bankar në letra me vlerë gjatë vitit 2016 arriti në 510.3 milionë euro, një rritje vjetore prej 7.8 përqind (23.3 përqind në 2015) (figura 37). Rritja e investimeve në letra me vlerë i atribuohet kryesisht rritjes prej 9.7 përqind të investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja, përderisa edhe investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës regjistruan rritje vjetore prej 5.8 përqind (figura 38). Megjithatë rritja e investimeve në letra me vlerë në vitin 2016 ishte më e ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak, që mund t'i atribuohet faktorëve si në tregun e brendshëm, ashtu edhe atë të jashtëm. Rritja e konkurrencës edhe nga akterët e tjerë në tregun e brendshëm si fondet pensionale, kompanitë e sigurimeve, institucionet e tjera publike, të cilët kanë rritur shumë e investuar në letra me vlerë të Kosovës, si dhe normat relativisht të ulëta në instrumente të borxhit në tregjet e jashtme mund të kenë kontribuar në ngadalësimin e ritmit të rritjes së investimeve në letra me vlerë.


Bilanci me bankat komerciale gjatë vitit 2016 shënoi përmirësim, duke u zgjeruar për 8.2 përqind krahasuar me vitin paraprak, kur kishte shënuar rënie vjetore prej 19.1 përqind. Njëkohësisht, kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në gjatë kësaj periudhe shënoi

Figura 37. Asetet e sektorit bankar, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2017)

Figura 38. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

rënie vjetore prej 6.9 përqind. Si përgjigje ndaj normës negative të interesit të vendosur nga BQE, që nga muaji gusht 2016 BQK ka filluar aplikimin e normës negative të interesit mbi tepricën e rezervës së detyrueshme që bankat komerciale mbajnë në BQK. Ky vendim mund të ketë nxitur bankat që të zvogëlojnë nivelin e tepricës së rezervës, gjë që potencialisht ka rezultuar në rënien e kësaj kategorie.

Kreditë

Gjatë vitit 2016, portfolio i kredisë është rritur për 10.4 përqind (7.3 përqind në vitin 2015), duke arritur vlerën prej 2.23 miliardë euro (figura 39).


Lansimi i Fondit Kosovar për Garantimin e Kredisë në vitin 2016 mund të ketë ndikuar pozitivisht në rritjen e aktivitetit kreditor nga ana e bankave. Rritja e kreditimit në vitin 2016 i atribuohet rritjes së kreditimit të ndërmarrjeve, që dominojnë strukturën e gjithsej kredisë, si dhe ritmit të përshpejtuar të rritjes së kreditimit ndaj ekonomive familjare. Pjesa më e madhe e kredisë të sektorit bankar vazhdon të dominohet nga kreditë për ndërmarrje, të cilat përfaqësojnë 64.1 përqind të gjithsej kredisë, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare përfaqësojnë 35.7 përqind të gjithsej kredisë. Një strukturë të ngjashme të kreditimit kanë edhe vendet e tjera në rajon, ku ndërmarrjet kanë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej portofolin kreditor (figura 40).

Stoku i kredisë ndaj ndërmarrjeve shënoi rritje vjetore prej 8.3 përqind, përderisa kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve në vitin 2016 kanë rënë për 17.3 përqind në bazë vjetore. Kreditë për ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje prej 14.7 përqind, ritëm i përshpejtuar i rritjes krahasuar me vitin paraprak (9.3 përqind). Në rritjen e stokut të kredisë ndaj ekonomive familjare ka ndikuar rritja e lartë e kredisë të reja konsumuese, ndërsa, kreditë e reja hipotekare shënuan ngadalësim të theksuar të rritjes krahasuar me vitin paraprak.

Struktura e kredisë të ndërmarrjeve sipas veprimtarisë


Në strukturën e kredisë ndaj ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike, peshën më të madhe prej 52.7 përqind vazhdojnë ta

Figura 39. Kontributi i sektorëve në rritjen e gjithsej kredisë, në pikë përqindje




Burimi: BQK (2017)

Figura 40. Struktura e kredisë sipas sektorëve në vendet e rajonit



Burimi: Bankat Qendrore të vendeve të rajonit (2017)

Figura 41. Struktura e kredisë sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

kenë kreditë ndaj sektorit të tregtisë (figura 41). Kreditë e destinuar për sektorin e industrisë së prodhimit përfaqësojnë 12.2 përqind të gjithëj kredive ndërsa sektori i ndërtimtarisë dhe i bujqësisë zënë 7.3 përqind dhe 4.2 përqind, respektivisht. Në vitin 2016, sektori i minierave u karakterizua me rritje të theksuar të kreditimit, megjithëse vazhdon të ketë peshë të ulët në gjithëj portofolin kreditor të ndërmarrjeve. Rritja e kreditimit për minierat mund të ketë rezultuar nga rritja e aktivitetit në këtë sektor në vitin 2016 kundrejt vitit


paraprak, që deri në një masë mund ti atribuohet rifunksionalizimit të Feronikelit dhe pritjeve për rritjen e çmimeve të metaleve në tregjet ndërkombëtare (figura 42). Sektori i tregtisë u karakterizua me përshejtim të rritjes vjetore prej 8.8 përqind në vitin 2016 (1.3 përqind në vitin paraprak), përderisa sektori i prodhimit shënoi ngadalësim të rritjes vjetore në 4.5 përqind (7.3 në vitin 2015).

Vlen të theksohet se kreditë për sektorin e ndërtimtarisë u karakterizuan me ndërprerje të ciklit rënës të vitit paraprak, duke shënuar një rritje vjetore prej 3.5 përqind. Ndërsa, sektorët e vetëm që u karakterizuan me rënie vjetore të kreditimit ishin sektori i bujqësisë dhe shërbimet financiare dhe shërbimet për patundshmëritë, që shënuan rënie vjetore prej 0.3 përqind përkatësisht 39.5 përqind. Në kuadër të kreditimit të ndërmarrjeve, sektori bankar vlerësohet të ketë koncentrim të lartë ndaj disa veprimtarive ekonomike. Në këtë kontekst, sektori i tregtisë ka një pjesëmarrje prej 62.5 përqind në gjithëj kreditë e lëshuara nga tre bankat e mëdha. Gjithashtu, sektori i prodhimit dominon portofolin kreditor të tre bankave më të mëdha me rreth 72 përqind të gjithëj kredive për ndërmarrjet. Në kuadër të sektorëve ekonomik, sektori i bujqësisë ka shkallën më të lartë të koncentrimit, ku vetëm njëra bankë përfaqëson pothuajse gjysmën e portfolios së kredive bujqësore.

Struktura e kredive sipas afatit të maturimit


Struktura e kredive sipas afatit të maturimit mbeti e ngjashme me vitet paraprake, e përfaqësuar me 36.5 përqind nga kreditë afatmesme 'mbi 2 deri në 5 vite'. Megjithatë, në vitin 2016, kreditë me afat të gjatë maturimi 'mbi 5 vite' rritën pjesëmarrjen për 2.1 pikë përqindje duke zënë 36.3 përqind të portfolios kreditorë. Në këtë periudhë, me zvogëlim të pjesëmarrjes për 1.5 pikë përqindje u karakterizuan kreditë me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite' (figura 43). Kreditë ndaj ekonomive familjare dominohen kryesisht nga kreditë me afat maturimi prej 'mbi 5 vite', që zënë 54.4 përqind të kredive ndaj ekonomive familjare, ndërsa në kuadër të ndërmarrjeve, kreditë me afat

Figura 42. Kreditë sipas veprimtarisë ekonomike, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2017)

Figura 43. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2017)


maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ zënë pjesën më të madhe, më konkretisht 37.9 përqind të gjithsej kredive ndaj ndërmarrjeve (figura 44).

Kreditë me afat të shkurtër maturimi, gjegjësisht ‘deri në 1 vit’, në vitin 2016 zgjeruan pjesëmarrjen në gjithsej kreditë për 2.8 pikë përqindje, ndërsa, kreditë me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 2 vite’, zvogëluan pjesëmarrjen e tyre për 3.4 pikë përqindje.

Kreditë e reja


Kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar deri në vitin 2016 arritën vlerën 1.02 miliard euro, që përkon me rënie vjetore prej 7.0 përqind (figura 45).

Figura 44. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit për ndërmarrje dhe ekonomi familjare, dhjetor 2016




Burimi: BQK (2017)

Figura 45. Gjithsej kreditë dhe kreditë e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2017)

Figura 46. Kreditë e reja, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

Kontribut në rënien e gjithsej kredive të reja kishin kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve, të cilat shënuan rënie vjetore prej 17.3 përqind, përderisa kreditë e reja të destinuar për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 10.8 përqind (figura 46).


Në kuadër të kredive të reja ndaj ndërmarrjeve, kreditë investuese, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të këtyre kredive (55.2 përqind), shënuan rënie vjetore prej 28.2 përqind (figura 47). Ndërsa, kreditë jo-investuese, të cilat në vitin 2016 përfaqësuan 37.2 përqind të kredive të reja ndaj ndërmarrjeve, shënuan rritje vjetore prej 4.2 përqind. Pjesa tjetër e kredive të reja të lëshuara për ndërmarrjet përfaqësohet nga kreditë me kushte favorizuese.

Figura 47. Kreditë e reja sipas sektorëve, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2017)

Figura 48. Kreditë e reja sipas sektorëve dhe qëllimit të përdorimit



Burimi: BQK (2017)

Struktura e kredive të reja ndaj ekonomive familjare vazhdon të dominohet me 72.5 përqind nga kreditë konsumuese, të cilat shënuan rritje të thesuar vjetore prej 18.5 përqind (rënie prej 2.8 përqind në vitin 2015) (figura 48). Ndërsa, kreditë e reja hipotekare u rritën për 5.3 përqind në vitin 2016, ritëm më i ngadalësuar krahasuar me rritjen prej 27.6 përqind në vitin 2015.

Efekti i kredive të reja të lëshuara gjatë vitit në rritjen e gjithsej stokut të kredive është zvogëluar nga vlera e kredive të shlyera (write-offs) si dhe kredive të kthyera gjatë periudhës.

Përderisa kreditë e shlyera (write-offs) e kanë zvogëluar efektin e rritjes së kredive të reja në rritjen e gjithsej stokut të kredive për 1.3 përqind, kreditë e kthyera e zvogëluan këtë efekt për 72.4 përqind.


Anketa e Kreditimit Bankar¹²

Rezultatet e fundit të Anketës së Kreditimit Bankar¹³ pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës shtator 2016 – shkurt 2017 (referuar si P1 2017)¹⁴, si dhe pritjet për aktivitetin kreditues në periudhën mars – shtator 2017 (referuar si P2 2017).

Dinamika e aktivitetit kreditues për **ndërmarrjet** gjatë kësaj periudhe, sipas anketës së kreditimit bankar, rezulton të jetë ndikuar pozitivisht nga ana e ofertës kreditore. Bankat raportuan se kanë lehtësuar standardet e aplikuar gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi. Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, bankat deklaruan se standardet kreditore për NVM-të u lehtësuan më shumë kundrejt standardeve për ndërmarrjet e mëdha.

Për periudhën mars-shtator 2017, bankat deklaruan që presin lehtësim të standardeve kreditore për ndërmarrjet në përgjithësi, veçanërisht për kreditë për NVM-të (figura 49).

Figura 49. Standardet kreditore të aplikuar në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2017)

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat po ashtu raportuan të kenë lehtësuar kushtet dhe rregullat e kreditimit për ndërmarrjet. Për NVM-të, bankat lehtësuan kushtet e kreditimit kryesisht përmes uljes së normës mesatare të interesit, rritjes së madhësisë së kredive të aprovuara, rritjes së maturitetit dhe zvogëlimit të kërkesës për kolateral. Për kreditë e ndërmarrjeve të mëdha, bankat deklaruan të kenë ulur normën e interesit, rritur madhësinë e kredive të aprovuara, ndërsa kanë shtrënguar deri në një masë kushtet për këtë kategori përmes rritjes së kërkesës për kolateral (figura 50).

Për periudhën mars - shtator 2017, bankat presin lehtësim të kushteve të kreditimit në përgjithësi, megjithëse, shtrëngim të lehtë në disa prej kushteve të kreditimit për të dy

¹² Anketa e Kreditimit Bankar realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me bankat që operojnë në Kosovë. Anketa realizohet dy herë në vit, duke përfshirë periudhën mars – shtator dhe periudhën tetor – shkurt.


¹³ Përgjigjet e bankave individuale janë agreguar duke përdorur peshën përkatese të çdo banke në gjithsej portfolion kreditore të sektorit bankar. Vlerat pozitive e indeksit të standardeve kreditore tregojnë lehtësim dhe vlerat negative tregojnë shtrëngim. Gjithashtu, vlerat pozitive e indeksit të kërkesës për kredi tregojnë rritje të kërkesës dhe vlerat negative tregojnë rënie.

¹⁴ Periudhës shtator – shkurt të cilto vit i referohemi si 'periudha e parë' – P1, ndërsa periudhës mars – gusht të cilto vit i referohemi si 'periudha e dytë' – P2.

kategoritë e ndërmarrjeve. Më konkretisht, për NVM-të bankat deklaruan rritje të ngarkesave të tjera nga norma e interesit, ndërsa për ndërmarrjet e mëdha pritjet të ketë kërkesë më të lartë për kolateral dhe zvogëlim të maturitetit deri në një masë. Gjithsesi, norma mesatare e interesit në kredi për të dy kategoritë pritjet të vazhdojë trendin rënës.

Faktorët kryesorë që shpjegojnë politikën më të lehtësuara bankare të kreditimit gjatë periudhës raportuese, sipas bankave, ishin kryesisht faktor të brendshëm, gjegjësisht rritja e konkurrencës në sistemin financiar dhe përmirësimi i cilësisë së kredive.

Figura 50. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve




Gjatë periudhës raportuese, bankat deklaruan rënie deri në një masë të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet. Rënia e kërkesës për kredi ishte më e thellë për kreditë nga ndërmarrjet e mëdha për dallim nga kreditë për NVM-të të cilat kishin rënie të lehtë të kërkesës (figura 51).

Në kuadër të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, bankat vlerësuan se faktorët që ndikuan në kërkesën për kredi u zhvendosën nga nevoja e ndërmarrjeve për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, në nevojën për rifinancimin e borxheve dhe investimeve fikse deri në një masë.

Për periudhën mars - shtator 2017, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga të dy kategoritë e ndërmarrjeve.

Figura 51. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet




Në kuadër të kërkesës për kredi, bankat raportuan për përkeqësim të cilësisë së aplikacioneve të pranuar nga të dy kategoritë e ndërmarrjeve, veçanërisht nga ndërmarrjet e mëdha.

Aktiviteti kreditues për **ekonomitë familjare** gjatë periudhës raportuese vlerësohet të jetë ndikuar pozitivisht nga ana e ofertës kreditore. Konkretisht, standarde të lehtësuara kreditore u

aplikuan veçanërisht për kreditë për blerje të shtëpive (figura 52). Në të njëjtën periudhë, bankat raportuan për shtrëngim të lehtë të standardeve kreditore të aplikuara nga bankat gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ekonomive familjare për kreditë konsumuese.

Në gjashtë muajt e ardhshëm (mars - shtator 2017), bankat presin lehtësim të standardeve kreditore dhe përmirësim të kushteve të kreditimit për të dy kategoritë e ekonomive familjare, gjegjësisht kreditë konsumuese dhe kreditë për blerje të shtëpive.


Figura 52. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2017)

Në kuadër të ekonomive familjare, përmirësimi i kushteve të kreditimit gjatë periudhës raportuese për blerje të shtëpive u realizua kryesisht përmes uljes së normave të interesit për kreditë, rritjes së madhësisë së kredive të aprovuara dhe zvogëlimit të kërkesave për kolateral (figura 53). Kushtet për kreditë konsumuese kryesisht u përmirësuan përmes uljes së normës mesatare të interesit, zvogëlimit të ngarkesave tjera të interesit dhe zvogëlimit të kërkesës për kolateral. Megjithatë, bankat deklaruan rënie të madhësisë së shumës për kreditë konsumuese.


Figura 53. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare



*Vizat e ndërprera paraqesin vlerën e pritur respektive
Burimi: BQK (2017)

Në gjashtë muajt e ardhshëm, bankat kanë deklaruar se presin që kushtet e kreditimit përgjithësisht të lehtësohen për ekonomitë familjare, veçanërisht për kreditë për blerjen e shtëpive, përmes uljes së normës së interesit dhe rritjes së madhësisë së shumës së aprovuar. Rritja e konkurrencës në tregun kreditor dhe rënia e kredive joperformuese në vend ishin ndër faktorët kryesor që pritet të ndikojnë në lehtësimin e standardeve kreditore për ekonomitë familjare.

Figura 54. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2017)

Bankat raportuan rritje të theksuar të kërkesës për kredi për blerjen e shtëpive nga ekonomitë familjare, ndërsa rënie të lehtë të kërkesës për kreditë konsumuese (figura 54). Kërkesa e rritur nga ekonomitë familjare për blerjen e shtëpive i është atribuar zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme dhe rritjes së besueshmërisë së konsumatorëve. Gjithashtu, cilësia e aplikacioneve të pranuar, si për kredi konsumuese ashtu edhe për kredi për blerje të shtëpive, rezulton të jetë përmirësuar.

Për periudhën mars - shtator 2017, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga të dy kategoritë e ekonomive familjare, veçanërisht për kreditë për blerjen e shtëpive.

Sa i përket maturitetit, bankat kanë deklaruar për lehtësim të kushteve të kreditimit për kreditë afatgjata, si dhe rritje të kërkesës për këto kredi, gjë që është reflektuar edhe përmes rritjes së kërkesës për kredi për blerje të shtëpive. Sa i përket financimit të bankave, ato deklaruan që burimi kryesor i financimit gjatë periudhës raportuese ishin depozitat, e veçanërisht depozitat e ekonomive familjare. Ndërsa, në gjashtë muajt e ardhshëm, bankat presin rritje të financimit nga depozitat e ekonomive familjare dhe rënie të financimit nga depozitat e ndërmarrjeve.

6.2.2. Detyrimet dhe burimet vetanake

Aktiviteti i sektorit bankar të Kosovës vazhdon të financohet nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së Kosovës, të cilat përbëjnë 79.7 përqind të gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake (tabela 3). Burim tjetër mjaft i rëndësishëm i financimit të sektorit bankar janë burimet vetanake (ekuiteti), të cilat në vitin 2016 shënuan rritje, kryesisht si rezultat i rritjes së profitit të realizuar nga bankat.

Tabela 3. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar

Përshkrimi	2013		2014		2015		2016	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	16.5	0.5%	32.2	1.0%	43.4	1.3%	59.1	1.6%
Depozitat	2,449.0	80.1%	2,537.5	79.6%	2,702.9	79.8%	2,897.8	79.7%
Huatë tjera	13.4	0.4%	14.1	0.4%	17.6	0.5%	17.8	0.5%
Detyrimet tjera	246.2	8.0%	232.8	7.3%	191.8	5.7%	203.4	5.6%
Borxhi i ndërruarur	56.3	1.8%	47.3	1.5%	36.9	1.1%	38.4	1.1%
Burimet vetanake	277.8	9.1%	323.1	10.1%	392.7	11.6%	420.6	11.6%
Gjithsej detyrimet dhe burimet vetanake	3,059.3	100%	3,187.0	100%	3,385.3	100%	3,637.1	100%

Burimi: BQK (2017)

Megjithëse me pjesëmarrje shumë të ulët prej 1.6 përqind në financimin e aktivitetit të bankave që operojnë në Kosovë, kategoria e bilancit nga bankat komerciale shënoi rritjen më të lartë vjetore prej 36.2 përqind. Ndërsa, kategoria e borxhit të ndërruarur, e cila përfaqëson vetëm 1.1 përqind të gjithsej financimit, shënoi rritje vjetore prej 4.2 përqind.

Depozitat

Në vitin 2016, për të dytin vit rradhazi, depozitat u karakterizuan me ritëm të përshpejtuar të rritjes. Në fund të vitit 2016, depozitat u rritën për 7.2 përqind, duke arritur vlerën prej 2.90 miliardë euro.

Në qëndrueshmërinë e rritjes së depozitave kryesisht ka kontribuar rritja e depozitave të ekonomive familjare, të cilat njëherësh konsiderohen burim më i qëndrueshëm i financimit në raport me kanalet tjera të financimit. Depozitat e ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 73.2 përqind të gjithsej depozitave, shënuan rritje vjetore prej 8.0 përqind (6.4 përqind në vitin 2015) (figura 55). Kategoria e dytë më e rëndësishme e depozitave (23.1 përqind e gjithsej depozitave), gjegjësisht depozitat e ndërmarrjeve, shënuan një rritje të përshpejtuar vjetore prej 14.6 përqind (4.2 përqind në vitin 2015).

Në strukturën e depozitave të ndërmarrjeve, në vitin 2016 është vënë re një rritje e peshës së depozitave të korporatave tjera financiare dhe korporatave publike. Në anën tjetër, depozitat e korporatave tjera jofinanciare (ndërmarrjet private) zvogëluan pjesëmarrjen e tyre në gjithsej depozitat e ndërmarrjeve (figura 56). Depozitat e korporatave tjera financiare dhe atyre publike shënuan rritje të përshpejtuar vjetore prej 32.7 përqind përkatësisht 56.2 përqind, ndërsa depozitat e korporatave tjera jofinanciare shënuan ritëm më të ngadalësuar të rritjes prej 9.3 përqind krahasuar me rritjen prej 21.6 përqind në vitin paraprak.

Në pjesën e mbetur të gjithsej depozitave përfshihen depozitat e jorezidentëve me pjesëmarrje prej 2.4 përqind dhe depozitat tjera (qeveria dhe organizatat tjera jo-qeveritare) me pjesëmarrje prej 1.3 përqind. Depozitat e jorezidentëve shënuan rënie të theksuar vjetore prej 38.6 përqind krahasuar me rritjen për 27.6 përqind në vitin paraprak (figura 57) ndërsa, depozitat tjera u karakterizuan me rënie vjetore prej 3.1 përqind kryesisht si rezultat i rënies së depozitave të qeverisë lokale në bankat komerciale.

Figura 55. Struktura e depozitave të sektorit bankar




Figura 56. Struktura e depozitave të ndërmarrjeve





Figura 57. Depozitat e jo-rezidentëve



Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit dominohet nga depozitat e transferueshme, që në vitin 2016 rritën pjesëmarrjen, për dallim nga depozitat e afatizuara dhe atyre të kursimit të cilat zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej depozitat e sektorit (figura 58). Këto zhvillime në strukturën e depozitave mund t'i atribuohen deri në një masë nivelit të ulët të normave të interesit në depozita që ka mbizotëruar në treg.

Në vitin 2016, depozitat e transferueshme shënuan rritje vjetore prej 13.7 përqind përderisa depozitat e afatizuara shënuan rritje prej 5.2 përqind. Në anën tjetër, depozitat e kursimit u zvogëluan për 7.2 përqind në vitin 2016. Në rritjen e depozitave të afatizuara kontribuan depozitat e afatizuara të ndërmarrjeve, të cilat u rritën për 25.8 përqind, përderisa depozitat e afatizuara të ekonomive familjare shënuan rënie për 2.9 përqind.


Megjithatë, vlen të theksohet se në kuadër të strukturës së depozitave të afatizuara, në vitin 2016 është vënë re një rënie e depozitave të afatizuara me afat më të gjatë maturimi (figura 59). Krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 është regjistruar rritje e theksuar prej 79.0 përqind e depozitave me afat të shkurtër maturimi 'deri në 1 vit', si dhe rritje e ngadalësuar e depozitave me afat maturimi 'mbi 2 vite' (1.2 përqind rritje në vitin 2016 krahasuar me rritjen prej 19.8 përqind në 2015), përderisa depozitat me afat maturimi 'mbi 1 deri në 2 vite' shënuan rënie vjetore prej 45.1 përqind (29.5 përqind në vitin 2015).

6.2.3. Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kredi vazhdoi të karakterizohet me rënie edhe në vitin 2016. Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë për të dytin vit me radhë. Norma mesatare e interesit për kreditë e reja zbriti në 7.2 nga 7.7 përqind vitin paraprak, përderisa norma mesatare e interesit në depozita u ngrit për 0.1 pikë përqindje në 1.2 përqind. Rënia më e theksuar e normës së interesit në kredi u reflektua në zvogëlim të diferencës në mes të normës së interesit në kredi dhe normës së interesit në depozita në 6.0 përqind, nga 6.5 përqind sa ishte në vitin 2015 (figura 60).


Normat mesatare të interesit në kredi dhe depozita në sektorin bankar të Kosovës qëndrojnë në nivele të përafërta me mesataren e normave të interesit në vendet e rajonit (figura 61).

Figura 58. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit




Burimi: BQK (2017)

Figura 59. Struktura e depozitave të afatizuara




Burimi: BQK (2017)

Figura 60. Norma mesatare e interesit



Burimi: BQK (2017)

Figura 61. Normat e interesit në Kosovë dhe vendet e rajonit (2016)



Burimi: BQK, FMN (2017)


Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kredi vazhdoi trendin rënës si te kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu dhe te kreditë ndaj ekonomive familjare. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve zbriti në 6.8 përqind (figura 62). Të gjitha kategoritë e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve u karakterizuan me rënie të normave të interesit. Norma mesatare e interesit për kreditë investuese zbriti në 6.7 përqind, ndërsa norma e interesit për kreditë jo-investuese zbriti në 7.0 përqind (figura 63).

Normat e interesit u zvogëluan për të gjitha kategoritë e kredive ndaj ndërmarrjeve sipas afatit të maturimit, përveç të atyre me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 2 vite’. Kjo kategori, që njëherësh ka edhe normën më të lartë të interesit prej 7.8 përqind, u karakterizua me një rritje të normës së interesit për 0.4 pikë përqindje në vitin 2016. Zvogëlimi më i theksuar i normës së interesit në 6.8 përqind nga 8.0 përqind u shënuar te kreditë ndaj ndërmarrjeve me afat maturimi ‘deri në 1 vit’ (figura 64).


Me rënie të normave të interesit u karakterizuan të gjitha kategoritë e kredive sipas veprimtarive ekonomike. Rënia më e theksuar e normës së interesit ishte në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve, që në vitin 2016 zbriti në 6.8 përqind. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë shënoi rënien e dytë më të lartë duke u zvogëluar në 6.7 përqind dhe njëherit duke rënë në nivelin më të ulët në kuadër të veprimtarive ekonomike. Sektori i industrisë po ashtu u karakterizua me rënie të normës së interesit në 7.0 përqind (figura 65).

Figura 62. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2017)

Figura 63. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas qëllimit




Burimi: BQK (2017)

Figura 64. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas maturimit



Burimi: BQK (2017)

Figura 65. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas veprimtarisë ekonomike




Burimi: BQK (2017)

Sa i përket kredive ndaj ekonomive familjare, norma mesatare e interesit u zvogëluar në 7.9 përqind nga 8.4 përqind sa ishte në vitin 2015. Zvogëlimi më i theksuar i normës së interesit u regjistrua te kreditë hipotekare në 6.1 përqind. Ndërsa, në kreditë konsumuese norma e interesit u zvogëluar lehtësisht në 8.3 përqind (figura 66).

Në kuadër të kredive hipotekare, kreditë me maturim më afatgjatë kishin norma më të favorshme të interesit krahasuar me ato afatshkurtra. Norma më e ulët e interesit prej 5.8 përqind u regjistrua në kreditë hipotekare me afat maturimi ‘prej 5 deri 10 vite’, ndërsa më e larta prej 6.6 përqind u regjistrua në ato me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’.

Figura 66. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit




Burimi: BQK (2017)

Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në depozita u rrit në 1.24 përqind në vitin 2016 krahasuar me 1.15 përqind sa ishte në vitin 2015. Trendi rritës i normës së interesit në gjithsej depozitat kryesisht u diktua nga rritja e normës së interesit në depozitat e afatizuara të ndërmarrjeve (figura 67). Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve u karakterizua me rritje për dallim nga një vit më parë kur kishte rënie, duke qëndruar kështu në nivel më të lartë se sa norma e interesit në depozitat ndaj ekonomive familjare, e cila u karakterizua me rënie.


Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve u rrit në 1.6 përqind. Rritja e normës së interesit, ndër tjera, mund të jetë reagim i bankave për të stimuluar rritjen e depozitave të ndërmarrjeve. Niveli i normës së interesit në depozitat e ndërmarrjeve u diktua nga norma e interesit në depozitat e afatizuara, të cilat në vitin 2016 shënuan normën më të lartë të interesit prej 1.6 përqind në kategorinë e maturimit ‘mbi 6 muaj deri në 1 vit’. Në depozitat e kursimeve, norma e interesit u rrit në 0.2 përqind (figura 68).

Figura 67. Norma mesatare e interesit në depozita




Burimi: BQK (2017)

Figura 68. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2017)

Figura 69. Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2017)

Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare në vitin 2016 u zvogëlua në 1.0 përqind nga 1.1 përqind sa ishte në vitin 2015 (figura 67). Zvogëlimi i normës mesatare të interesit në depozita reflekton zvogëlimin e normës së interesit në depozitat e afatizuara ngase depozitat tjera bartin interes shumë të ulët (figura 69).

Në kuadër të depozitave të afatizuara të ekonomive familjare, norma më e ulët e interesit prej 0.3 përqind u regjistrua në depozitat me afat maturimi ‘mbi 3 deri në 6 muaj’, përderisa ajo më e larta prej 2.0 përqind u regjistrua në depozitat me afat maturimi ‘mbi 2 vite’, përkundër faktit që norma e interesit për këtë kategori të depozitave pati rënien më të theksuar prej 0.25 pikë përqindje.


6.3. Performanca e Sektorit Bankar

Sektori bankar vazhdoi të karakterizohet me performancë të mirë financiare duke mbajtur nivel të lartë të profitabilitetit. Profiti i sektorit në dhjetor 2016 ishte 75.5 milionë euro, që paraqet rënie në krahasim me vitin paraprak në të cilin u shënuar profiti më i lartë në historinë e funksionimit të sektorit bankar, prej 94.7 milionë euro (figura 70). Rënia vjetore e profitit prej 20.2 përqind ishte rezultat i rënies së të hyrave neto nga interesi në një rën të anë, si dhe rritjes së shpenzimeve për provizionet për humbjet nga kreditë dhe shpenzimeve për tarifa dhe komisione, në anën tjetër.

Të hyrat


Të hyrat e sektorit bankar gjatë katër viteve të fundit kanë ndjekur trend rënës. Vlera e të hyrave të akumuluar gjatë vitit 2016 ishte 231.1 milionë euro, që korrespondon me rënie vjetore prej 3.0 përqind. Ndikimin kryesor në rënien e gjithsej të hyrave e kishin të hyrat nga interesi, të cilat shënuan rënie vjetore prej 4.0 përqind. Rënia e të hyrave nga interesi u shkaktua kryesisht nga rënia e normës së interesit në kredi gjatë viteve të fundit.

Figura 70. Performanca financiare e sektorit bankar



Burimi: BQK (2017)

Figura 71. Struktura e të hyrave të sektorit bankar, në përqindje




Burimi: BQK (2017)

Me rënie u karakterizua edhe kategoria e dytë e të hyrave që janë të hyrat nga jointerеси (figura 71), vlera e të cilave ishte për 0.7 përqind më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Kjo rënie ishte rezultat i rënies së theksuar prej 25.5 përqind të të hyrave tjera operative, përderisa të hyrat nga tarifat dhe komisionet, të cilat përfaqësojnë rreth 90 përqind të të hyrave nga jointerеси, shënuan rritje prej 1.5 përqind.

Shpenzimet

Për dallim nga tri vitet paraprake që u karakterizuan me rënie të shpenzimeve, sektori bankar gjatë vitit 2016 shënoi rritje të shpenzimeve. Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit arriti në 155.6 milionë euro, duke rezultuar për 8.4 përqind më e lartë se në vitin 2015. Rritja e shpenzimeve erdhi si rezultat i rritjes së shpenzimeve të provizioneve për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, shpenzimeve të përgjithshme dhe shpenzimeve për tarifa dhe komisione.

Figura 72. Shpenzimet e sektorit bankar, në përqindje




Struktura e shpenzimeve vazhdoi të dominohet nga kategoria e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative me pjesëmarrje prej 63.9 përqind në gjithsej shpenzimet, pasuar nga shpenzimet e jointerесit me pjesëmarrje prej 21.2 përqind dhe shpenzimet e interesit me pjesëmarrje prej 11.7 përqind (figura 72).

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative deri në dhjetor 2016 shënuan rënie vjetore prej 7.5 përqind. Në rënien e kësaj kategorie kontribuan shpenzimet e tjera jo nga interesi të cilat shënuan rënie vjetore prej 55.9 përqind. Po ashtu, rënie prej 3.4 përqind shënuan shpenzimet e personelit, përderisa kategoria e shpenzimeve të përgjithshme regjistroi rritje vjetore prej 25.2 përqind.

Kategoria e dytë e shpenzimeve, që janë shpenzimet nga jo interesi, u karakterizua me rritje të theksuar vjetore në vitin 2016, duke ndikuar në rritjen e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar (figura 73). Rritja e këtyre shpenzimeve kryesisht i atribuohet rritjes së theksuar prej 25.1 milionë euro të shpenzimeve për provizionet për humbje të kredive. Kjo rritje e shpenzimeve për provizione është rezultat i rritjes së kreditimit, si dhe rritjes së kredive të shlyera gjatë kësaj periudhe. Rrjedhimisht, bankat kanë rritur shpenzimet për provizione, në mënyrë që të vazhdojnë të mbajnë në nivel të lartë raportin e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione.

Figura 73. Vlera e shpenzimeve të sektorit bankar



Rënia vjetore e shpenzimeve operacionale si dhe rritja e aseteve ndikuan që raporti ndërmjet tyre të jetë më i ulët se deri në dhjetor 2015 (tabela 4).

Shfrytëzimi i kapaciteteve të sektorit bankar, shprehur përmes indikatorit të vlerës mesatare të aseteve të menaxhuara nga një punëtor, ka shënuar përmirësim (tabela 5). Ky përmirësim u ndikua nga rritja më e lartë e aktivitetit të sektorit bankar, krahas numrit të njëjtë të punësuarve në këtë sektor në krahasim me vitin paraprak. Raporti ndërmjet gjithsej shpenzimeve të personelit dhe numrit të punëtorëve në sektorin bankar po ashtu u përmirësua si rezultat i rënies së shpenzimeve për të punësuarit përderisa numri i të punësuarve mbeti i njëjtë, çka nënkupton rënie të shpenzimeve për një punëtor (tabela 5).

Tabela 5. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016
Asetet / nr i punëtorëve (në mijëra euro)	862.0	908.6	1,003.1	1,077.6
Shpenzimet e personelit / nr i punëtorëve (në mijëra euro)	11.9	12.1	13.0	12.6

Burimi: BQK (2017)

6.4 Rreziqet e Sektorit Bankar

Indikatorët kryesorë të rreziqeve bankare qëndruan në nivele të kënaqshme gjatë vitit 2016 (tabela 6). Pozita e likuiditetit të sektorit bankar vazhdon të jetë në nivel të qëndrueshëm, përkundër rritjes së përshpejtuar të kreditimit. Rritja e përshpejtuar e kredive në njërin anë, si dhe rritja e depozitave të transferueshme të cilat ndikuan në rritjen e detyrimeve afatshkurtëra të sektorit, në anën tjetër, kanë ndikuar në rënien e treguesit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra. Megjithatë, ky tregues vazhdon të mbetet dukshëm mbi nivelin minimal prej 25 përqind të përcaktuar me kërkesat rregullatore.

Tabela 6. Indikatorët e rreziqeve të sektorit bankar

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016
Raporti krediti/depozita	73.7%	74.2%	74.7%	77.0%
Raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra	48.0%	43.6%	44.9%	41.5%
Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (TMK)	16.7%	17.8%	19.0%	17.9%
Raporti i kredive joperformuese (KJP) ndaj gjithsej kredive	8.7%	8.3%	6.2%	4.9%
Mbulueshmëria e KJP-ve me provizione	110.6%	114.4%	115.1%	127.6%
Raport i vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj kapitalit të klasit të parë	129.7%	97.1%	67.3%	71.0%
Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë	2.6%	1.9%	1.9%	4.6%

Burimi: BQK (2017)

Po ashtu, indikatorët e rrezikut të solvencës treguan nivel të lartë të kapitalizimit të sektorit bankar. Raporti i kapitalit rregullativ ka shënuar rënie të lehtë si rezultat i rënies së kapitalit të klasit të dytë, mirëpo cilësia e kapitalit rregullativ është rritur si rezultat i rritjes së kapitalit të klasit të parë të mbështetur nga profiti i akumuluar ndër vite. Niveli dhe cilësia aktuale e kapitalit sugjeron qëndrueshmëri dhe aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar humbjet potenciale. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor ka vazhduar të bie, duke u pasqyruar me normë më të ulët të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive. Po ashtu, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë është rritur, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme nga kreditë. Koncentrimi i rrezikut kreditor në vitin 2016


shënoi rritje për dallim nga dy vitet e fundit. Sektori bankar vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj rrezikut të tregut. Bilanci i gjendjes së sektorit bankar pothuajse në tërësi është i denominuar në valutë euro dhe rrjedhimisht ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Kreditë dhe depozitat e sektorit kryesisht kanë normë fikse të interesit dhe nuk ndikohen nga luhatjet e interesit deri në maturim. Sidoqoftë ekziston rreziku ndaj normës së interesit në aspektin e ricëimit të aseteve dhe detyrimeve me ndjeshmëri ndaj normave të interesit. Për intervalin e shkurtër të maturimit 'deri në 30 ditë' kemi ngushtim të hendekut negativ krahasuar me vitin paraprak, çka ulë ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të rritjes së mundshme të normës së interesit. Ndërsa hendeku kumulativ deri në 1 vit rezultoi pozitiv dhe më i zgjeruar, duke e rritur ekspozimin ndaj rrezikut të rënies së mundshme të normës së interesit. Bankat kanë krijuar sistem, politika dhe procedura të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut operacional. Menaxhimi i këtij rreziku gjatë vitit 2016 është adekuat, duke mos pasur raste të materializimit të tij dhe duke ndarë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e këtij rreziku në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore.

6.4.1 Rreziku i likuiditetit

Sektori bankar vazhdon të ketë pozitë të mirë të likuiditetit, me indikatorët kryesorë të likuiditetit që qëndrojnë mbi nivelet minimale të kërkesave rregullatore. Megjithatë, krahasuar me vitin paraprak, treguesit e likuiditetit kanë shënuar rënie. Përkundër që depozitat shënuan rritje më të lartë vjetore krahasuar me vitin paraprak, rritja më e përshpejtuar e kredive bëri që raporti i kredive ndaj depozitave të arrijë në 77.0 përqind nga 74.7 përqind sa ishte në dhjetor 2015 (figura 76).


Treguesi kyç i likuiditetit, raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra u zvogëlua në 41.5 përqind nga 44.9 përqind sa ishte në dhjetor 2015. Rënia e raportit i atribuohet normës më të lartë të rritjes së detyrimeve afatshkurtra, 6.1 përqind, si rezultat i orientimit të depozitave me afat drejt atyre të transferueshme, në krahasim me rënie prej 2.0 përqind të aseteve likuide (figura 77).

Figura 76. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Figura 77. Raporti i gjithsej aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra



Burimi: BQK (2017)

Niveli i aseteve likuide në bilancin e sektorit bankar mbetet i lartë, duke qenë se në dhjetor 2016 asetet likuide përbënin 31.7 përqind të gjithsej aseteve të sektorit. Sidoqoftë, ky raport është më i ulët se vitin e kaluar ku asetet likuide përbënin 34.9 përqind të gjithsej aseteve. Kjo për faktin se gjithsej asetet shënuan rritje ndërsa asetet likuide u zvogëluan.

Në rënien e aseteve likuide kontributin më të madh e kishin rënia e parasë së gatshme dhe e rezervave të mbajtura nga bankat në BQK, që është reaksion i aplikimit të normës negative të interesit në vlerën e mjeteve të mbajtura në BQK mbi nivelin e rezervës së detyrueshme, që nga gushti i vitit 2016. Kosto e mbajtjes së tepicës së rezervave, krahas trendit të përgjithshëm të

përshpejtimit të rritjes së kreditimit, mund të ketë ndikuar në zhvendosjen e aseteve likuide në asete me maturim më afatgjatë, kreditë, si asete më profitabile. Rezervat e sektorit bankar shënuan rënie vjetore prej 7.9 përqind, duke vazhduar të qëndrojnë në nivel më të lartë se sa kërkesat rregullatore (figura 78).


Në dhjetor 2016, niveli i kërkuar i rezervës së detyrueshme ishte 247.4 milionë euro, ndërsa vlera e gjithsej rezervave të mbajtura nga bankat tejkaloi nivelin e kërkuar të rezervës së detyrueshme për 47.8 përqind. Siç u tha më lartë, rënia e rezervave gjatë kësaj periudhe reflekton dekurajimin e bankave për të mbajtur rezerva mbi nivelin e kërkuar të rezervës së detyrueshme për shkak të aplikimit të normës negative të interesit prej muajit gusht 2016. Po ashtu, ndikim mund të ketë edhe orientimi i aseteve të bankave në instrumente më fitimprurëse siç janë kreditë dhe letrat me vlerë.

Sektori bankar në dhjetor 2016 u karakterizua me rritje të 'rrezikut strukturor të likuiditetit', që pasqyrohet përmes rritjes së mospërputhjes së afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve të intervalit të njëjtë të maturimit (figura 79). Hendeku i likuiditetit është zgjeruar për pothuajse të gjitha kategoritë, përveç kategorisë '6 - 12 muaj' që u karakterizua me ngushtim të lehtë. Hendeku negativ¹⁶ rezultoi vetëm në kategorinë e afatit të maturimit '1-7 ditë', vlera e të cilit arriti në -1,478.0 milionë euro nga -1,168.3 milionë euro në dhjetor 2015. Thellimi i hendekut negativ për këtë kategori të maturimit krahasuar me vitin paraprak erdhi si rezultat i rënies së aseteve në këtë kategori prej 12.4 përqind, përderisa detyrimet e kategorisë në fjalë u rritën për 10.4 përqind. Ndërsa, për të gjitha kategoritë e tjera të afateve të maturimit hendeku ishte pozitiv, dhe zgjerimi i hendekut ishte kryesisht rezultat i rritjes së aseteve që u shënuan në secilën prej kategorive.

Rënia e aseteve për kategoritë me interval maturimi '1-7 ditë' rezultoi kryesisht nga rënia e letrave me vlerë, rënia e depozitave në banka tjera si dhe rënia e kredive. Ndërsa, rritja e aseteve në kategoritë e tjera të afatit të maturimit reflekton rritjen e kreditimit afatgjatë dhe zhvendosjen e investimeve në letra me vlerë drejt afateve më të gjata të maturimit.


Në anën e detyrimeve, rritja e depozitave me maturim afatshkurtër ishte faktori kryesor që ndikoi në rritjen e detyrimeve për kategorinë e maturimit '1-7 ditë'. Rritje e depozitave u shënuan edhe në afatet e maturimit '1-5 vite' dhe atë 'mbi 5 vite', ndërsa të gjitha kategoritë tjera të maturimit shënuan rënie.

Figura 78. Rezervat e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Figura 79. Hendeku i likuiditetit*, në milionë euro



*Prej vitit 2015 ka ndërrim metodik në llogaritje, ku ekuiteti nuk përfshihet në llogaritje
Burimi: BQK (2017)


¹⁶ Hendeku negativ nënkupton që detyrimet për intervalin e caktuar të maturimit tejkalojnë asetet dhe anasjelltas.

Kjo zhvendosje e përgjithshme e aseteve drejt afateve më të gjata të maturimit dhe e detyrimeve drejt afateve më të shkurtëra reflekton zhvillimet në norma të interesit. Zhvillime të tilla me tendencë të zhvendosjes së depozitave drejt afateve më të shkurtëra të maturimit mund të zgjerojnë edhe mëtej hendekun e likuiditetit për periudhë afatshkurtër andaj dhe mund të paraqesin probleme në menaxhimin e likuiditetit në një afat më të gjatë.

6.4.2. Rreziku kreditor

Norma edhe ashtu e ulët e kredive joperformuese në sektorin bankar shënoi rënie të mëtutjeshme gjatë vitit 2016. Raporti i kredive joperformuese (KJP) ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2016 zbriti në 4.9 përqind krahasuar me 6.2 përqind një vit më parë (figura 80). Rënia e normës së KJP-ve reflekton si rritjen vjetore të kreditimit prej 10.4 përqind ashtu edhe përmirësimin e theksuar të cilësisë së portofolit kreditor, ku vlera e kredive jo-përformuese shënoi rënie vjetore prej 12.1 përqind (figura 81).


Figura 80. Raporti KJP/gjithsej kredite, në përqindje



Burimi: BQK (2017)


Trendi rënës i normës së KJP-ve ka filluar nga muaji nëntor i vitit 2014. Vlen të theksohet që norma e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2016 ishte në nivelin më të ulët që nga fundi i vitit 2010. Gjithashtu, norma e KJP-ve të sektorit bankar në Kosovë mbetet në nivelin më të ulët krahasuar me vendet e rajonit, që mesatarisht kishin një normë prej 14.2 përqind të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2016 (figura 82).

Figura 81. Gjithsej kredite dhe KJP-të, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2017)

Figura 82. Raporti KJP/gjithsej kredite në Kosovë dhe në disa vende të Ballkanit Perëndimor (dhjetor 2016)



Burimi: BQK (2017)

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor është më i theksuar tek kredite ndaj ndërmarrjeve që mbajnë normë të KJP-ve prej 5.5 përqind krahasuar me normën e KJP-ve prej 2.5 përqind në kredite ndaj ekonomive familjare. Pjesa më e madhe e sektorëve ekonomik në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve u karakterizuan me përmirësim të cilësisë së portfolit kreditor. Rënia më e theksuar e normës së kredive joperformuese u shënuar te kredite ndaj sektorit të energjisë, që në dhjetor 2016 mbanin normë të KJP-ve prej 6.0 përqind krahasuar me 19.6 përqind në dhjetor 2015. Ky përmirësim i atribuohet më tepër rritjes më të lartë të kredive për këtë sektor se sa rënies së vlerës së kredive joperformuese. Ndërkaq, sektori i prodhimit është i dyti për nga përmirësimi i cilësisë kreditore, si rezultat i rënies më të madhe të vlerës së kredive jo performuese se sa e rritjes së kredive për këtë sektor. Norma e KJP-ve për sektorin e

prodhimit zbriti në 5.4 përqind krahasuar me 11.4 përqind në dhjetor 2015. Norma më e lartë e kredive joperformuese u shënua në sektorin e bujqësisë në nivelin prej 8.2 përqind (figura 83).


Zvogëlimi i ekspozimit ndaj rrezikut kreditor krahasuar me periudhën paraprake paraqitet edhe përmes migrimit të kredive nga kategoritë me cilësi më të dobët drejt kategorisë së kredive pa vonesa (figura 84). Kreditë ‘standarde’ që klasifikohen si kategori e kredive pa vonesa rritën pjesëmarrjen në gjithsej kreditë për 2.3 pikë përqindje, përderisa kreditë ‘vrojtuese’ dhe ‘nënstandarde’ që klasifikohen si kredi me vonesa zvogëluan pjesëmarrjen për 0.7 pikë përqindje, përkatësisht 0.4 pikë përqindje. Kreditë e ‘dyshimta’ dhe ato të ‘humbura’ zvogëluan pjesëmarrjen për 0.2 pikë përqindje, përkatësisht 1.0 pikë përqindje.

Krahas përmirësimit të përgjithshëm të cilësisë së portofolit kreditor, përmirësim ka shënuar edhe niveli i mbulimit të kredive joperformuese me provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë, i cili u ngrit në 127.6 përqind në dhjetor 2016 (figura 85). Rritja e raportit ishte efekt i rënies më të theksuar të kredive joperformuese, duke pasur parasysh që vlera e stokut të provizioneve shënoi rënie. Rënia e vlerës së provizioneve, përkundër rritjes së shpenzimeve për provizione gjatë vitit 2016, erdhi si rrjedhojë e procesit të shlyerjes së kredive të humbura. Sektori bankar gjithashtu forcoi kapacitetin për mbulimin me kapital të humbjeve të mundshme nga kreditë. Kjo si rezultat i rënies së vlerës së kredive joperformuese neto nga provizionet si dhe rritjes së kapitalit të bankave, të cilat ndikuan që raporti në mes kredive joperformuese neto dhe kapitalit të zbres në 2.2 përqind nga 3.0 përqind sa ishte në dhjetor 2015.

Koncentrimi i rrezikut kreditor


Shkalla e koncentrimit kreditor në sektorin bankar të Kosovës, që matet si raport i vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë, ka ndërruar trendin rënës të dy viteve të fundit duke u rritur në 71.0 përqind në dhjetor 2016 (figura 86). Rritja e shkallës së

Figura 83. Norma e KJP-ve sipas veprimtarive




Burimi: BQK (2017)

Figura 84. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2017)

Figura 85. KJP-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2017)


koncentrimin i atribuohet rritjes më të lartë të vlerës së ekspozimeve të mëdha kreditore prej 12.6 përqind (në 281.6 milionë euro), përdërisa kapitali i klasit të parë u rritë për 6.7 përqind.

Përkundër rritjes së vlerës së përgjithshme të ekspozimeve të mëdha, numri i ekspozimeve të mëdha kreditore¹⁷ shënoi rënie, në 31 nga 36 sa ishin në dhjetor 2015. Ky zhvillim sugjeron për rritje të koncentrimin kreditor, me ç'rast vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha u rrit në 9.1 milionë euro (6.9 milionë në dhjetor 2015), duke ndjekur kështu trend rritës për të katërtin vit me radhë.

6.4.3. Rreziku i solvencës

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK), që paraqet raportin ndërmjet gjithsej kapitalit rregullator dhe asetëve të peshuara ndaj rrezikut, në dhjetor 2016 ishte 17.9 krahasuar me 19.0 përqind të shënuar një vit më parë, por që mbetet mjaft mbi nivelin rregullator prej 12 përqind (figura 87).¹⁸

Figura 87. Kapitalizimi i sektorit bankar




Burimi: BQK (2017)

Rënia e raportit ishte rezultat i rritjes vjetore më të lartë të asetëve të peshuara me rrezik (APR) prej 12.3 përqind, në krahasim me rritjen vjetore prej 5.5 përqind të kapitalit rregullator (figura 88).

Kapitali rregullator këtë vit shënoi rritje më të ngadalësuar si pasojë e rënies së kapitalit të klasit të dytë si dhe rritjes vjetore më të ngadalësuar të kapitalit të klasit të parë. Norma më e ulët e rritjes së kapitalit të klasit të parë ndikoi që edhe raporti i kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara me rrezik të zvogëlohet në 15.9 përqind nga 16.7 përqind sa ishte në dhjetor 2015. Niveli i kapitalizimit të sektorit bankar në Kosovë mbetet mbi nivelin mesatar prej 17.2 përqind të vendeve të rajonit (figura 89).


Indikator tjetër për vlerësimin e nivelit të kapitalizimit është raporti i levës, që vlerëson nivelin e mbulimit të aktivitetit të sektorit bankar me ekuitet. Ky raport në dhjetor 2016 zbriti lehtësisht në 12.1 përqind nga 12.2 përqind, duke vazhduar të qëndroj mbi kërkesën rregullatore për

Figura 86. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2017)

Figura 88. Kapitali rregullator dhe APR-të



Burimi: BQK (2017)

¹⁷ Ekspozim i madh kreditor konsiderohet çdo ekspozim që tejkalon 10 përqind të kapitalit të klasit të parë.


¹⁸ Sipas rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të gjithsej kapitalit rregullator në raport me APR dhe normë prej së paku 8 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me APR .

shkallë minimale të levës prej 7 përqind.¹⁹ Rënia e lehtë e raporti të levës ishte rezultat i rritjes më të ngadalësuar të gjithsej ekuitetit, i cili u rrit me normë prej 6.8 përqind në krahasim me rritjen prej 21.9 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, asetet e sektorit patën rritje të ngjashme me vitin paraprak prej 7.8 përqind. Niveli aktual i levës është nën nivelin mesatar të vendeve të rajonit, që në dhjetor 2016 ishte 14.2 përqind (figura 89).

Kapitali rregullator


Vlera e kapitalit rregullator të sektorit bankar arriti në 447.0 milionë euro në dhjetor 2016, që tejkalon kërkesën minimale për kapital rregullator për 146.8 milionë euro. Cilësia e kapitalit, e shprehur nga pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin rregullator, ka shënuar rritje për të tretin vit me radhë kryesisht si rezultat i rritjes së profitit të mbajtur nga vitet paraprake. Në dhjetor 2016, vlera e kapitalit të klasit të parë arriti në 396.7 milionë euro, rritje vjetore prej 6.7 përqind, ndërsa pjesëmarrja e tij në gjithsej kapitalin rregullator arriti në 88.7 përqind (figura 90).

Figura 89. TMK në sektorin bankar në Kosovë dhe në vende të rajonit (dhjetor 2016)




Burimi: BQK (2017)

Figura 90. Struktura e kapitalit rregullator, në përqindje



Burimi: BQK (2017)


Figura 91. Struktura e kapitalit të klasit të parë, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Struktura e kapitalit të klasit të parë mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Kapitali aksionar vazhdon të jetë kategoria dominuese e kapitalit të klasit të parë, me gjithë rënien e pjesëmarrjes që shënoi gjatë kësaj periudhe në 69.6 përqind krahasuar me 73.7 përqind sa ishte në dhjetor 2015. Rënia e pjesëmarrjes së kapitalit ishte rezultat i rritjes së pjesëmarrjes së profitit të pashpërndarë nga vitet paraprake (figura 91).

Figura 92. Struktura e kapitalit të klasit të dytë, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Vlera e kapitalit të klasit të dytë në dhjetor 2016 ishte 50.4 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 3.5 përqind.

¹⁹ Rregullorja BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit të bankave, Neni 9.

Kjo ishte kryesisht rezultat i rënies së provizioneve të përgjithshme të mbajtura për kreditë²⁰ për 7.5 përqind dhe rënies prej 1.2 përqind të borxhit të ndërvarur. Performanca e mirë financiare e sektorit në vitet e fundit iu ka mundësuar bankave rritjen e kapitalit përmes burimeve të brendshme, përkatësisht profitit të mbajtur, gjë që iu ka krijuar bankave hapësirë për zvogëlimin e kapitalit të klasit të dytë. Borxhi i ndërvarur në dhjetor 2016 zbriti në 32.8 milionë euro duke përbërë 65.1 përqind të kapitalit të klasit të dytë (figura 92). Pjesa e mbetur prej 34.9 përqind e kapitalit të klasit të dytë përbëhet nga provizionet e përgjithshme për kreditë.

Asetet e peshuara ndaj rrezikut


Asetet e peshuara ndaj rrezikut (APR) përshpejtuan rritjen vjetore në 12.3 përqind në dhjetor 2016 nga 8.2 përqind në vitin paraprak. Pjesëmarrja e aseteve me rrezik në gjithsej asetet e sektorit bankar²¹ gjithashtu shënoi rritje në 68.9 përqind në dhjetor 2016 (figura 93). Nga gjithsej asetet me rrezik, 91.2 përqind janë asete me rrezik kreditor, ndërsa pjesa tjetër përfaqësohet nga asetet e ndara për menaxhim të rrezikut operacional.

Rritja e APR-ve ishte rezultat i rritjes së aseteve me peshë rreziku 100%, që paraqesin kategorinë dominuese të gjithsej APR-ve me pjesëmarrje 84.8 përqind në dhjetor 2016 (figura 94). Vlera e këtyre aseteve, të cilat përfshijnë kreditë hipotekare rezidenciale, pajisjet dhe mjetet tjera themelore si dhe pasuritë tjera të patundshme, arriti në 2.1 miliardë euro nga 1.8 miliardë euro në dhjetor 2015. Përveç aseteve me peshë rreziku 20% dhe 75% të cilat shënuan rënie, të gjitha kategoritë e tjera të aseteve me rrezik kanë shënuar rritje gjatë periudhës në shqyrtim. Rënia e aseteve me peshë rreziku 75% (kreditë e mbuluara me kolateral në formë të hipotekave të prioritetit të parë si dhe kreditë e destinuar për ndërtime të pasurive të patundshme), që paraqet kategorinë e dytë dominuese në strukturën e gjithsej APR-ve pas rrezikut operacional, ndikoi që pjesëmarrja e kësaj kategorie të bie në 4.1 përqind nga 7.8 përqind në vitin paraprak. Pavarësisht ecurisë së kategorive tjera të rrezikut, ato nuk patën ndonjë ndryshim të theksuar në pjesëmarrje.

6.4.4 Rreziku i tregut


Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut, që nënkupton ekspozimin ndaj rrezikut nga lëvizjet e kursit të këmbimit valutor si dhe nga lëvizjet në normat e interesit, vazhdon të mbetet

Figura 93. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit



Burimi: BQK (2017)

Figura 94. Struktura e APR-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2017)

²⁰ Vlera e provizioneve të ndara nga bankat për kreditë me klasifikim standard dhe vrojtuese llogaritet si pjesë e kapitalit të klasit të dytë, limituar deri në 1.25 përqind të aseteve të peshuara ndaj rrezikut.

²¹ Përfshirë këtu edhe mjetet jashtëbilancore meqenëse gjithsej vlera e APR-ve përfshinë mjetet jashtëbilancore.

në nivel të ulët. Raporti i pozicionit të agreguar neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë ka shënuar rritje në 4.6 përqind nga 1.9 përqind në dhjetor 2015, por që vazhdon të klasifikohet si nivel i ulët. Kreditë në valutë të huaj kanë zvogëluar edhe më tej pjesëmarrjen mjaft të ulët, 0.2 përqind në dhjetor 2016, në gjithsej portofolin kreditor, gjë që zvogëlon më tutje ekspozimin ndaj rrezikut valutor.

Kreditë dhe depozitat vazhdojnë të mbajnë pothuajse në tërësi normë fikse të interesit, duke u ndikuar nga lëvizjet e normave të interesit vetëm në maturim. Hendeku negativ ndërmjet aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit për intervalin e shkurtër të maturimit 'deri në 30 ditë' është ngushtuar, duke zvogëluar ekspozimin ndaj rritjes së mundshme të normës së interesit që do të reflektohej më shumë në shpenzimet e refinancimit se në të hyrat nga riinvestimi. Në anën tjetër, hendeku kumulativ pozitiv për periudhën deri në 1 vit është dyfishuar, gjë që paraqet ekspozim më të lartë ndaj rrezikut të rënies së mundshme të normës së interesit.


Rreziku i këmbimit valutor

Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj është rritur gjatë vitit 2016 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo si rezultat i rritjes së aseteve në valutë të huaj në 145.5 nga 132.9 milionë euro vlerë ekuivalente. Po ashtu, detyrimet në valutë të huaj u rritën në 139.4 nga 138.2 milionë euro vlerë ekuivalente sa ishin në dhjetor 2015. Asetet në valutë të huaj në dhjetor 2016 ishin më të larta se detyrimet për dy nga valutat kryesore (dollarin amerikan dhe funtën britanike), për dallim nga periudha e kaluar kur detyrimet ishin më të larta se asetet. Rrjedhimisht, rritja më e theksuar e aseteve se sa rritja e detyrimeve në valutë të huaj ka bërë që pozicioni i hapur neto të arrijë vlerën pozitive prej 6.1 milionë euro vlerë ekuivalente nga -5.3 milionë euro vlerë ekuivalente në dhjetor 2015. Pozicioni i hapur neto pozitiv në valutë të huaj do të thotë që ndryshimet e mundshme në këmbimet valutore do të reflektohen më shumë në anën e aseteve, ku efekti i devalvimit të valutave në të cilat janë të denominuara asetet do të ishte negativ, pasi që vlera e këtyre aseteve ekuivalente në euro do të rezultonte më e ulët.

Në anën tjetër, pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat²² shënoi rritje në 18.4 milionë euro vlerë ekuivalente në dhjetor 2016, nga 7.2 milionë euro vlerë në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja më e theksuar e pozicionit të agreguar në valutë të huaj se sa rritja e nivelit të kapitalit të klasit të parë të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe bëri që raporti ndërmjet tyre të rritet në 4.6 përqind nga 1.9 përqind sa ishte në dhjetor 2015, që megjithatë tregon nivel të ulët të ndjeshmërisë së sektorit ndaj ndryshimeve në kurset e këmbimit (figura 95).

Shikuar sipas valutave të veçanta, pozicioni neto i disagreguar ndaj kapitalit të klasit të parë ishte i ngjashëm për funtën britanike në 1.1 përqind (nga -0.9 përqind në dhjetor 2015) dhe për dollarin amerikan ku raporti u rrit në 1.1 përqind (nga -0.2 përqind deri në dhjetor 2015).

Figura 95. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë



Burimi: BQK (2017)


²² Pozicioni i agreguar neto i hapur nënkupton shumën e pozicioneve të gjata dhe të shkurta në të gjitha valutat. Për shembull, një pozicion neto i shkurtër (-) në dollar prej 1 milionë vlerë ekuivalente të euros dhe një pozicion neto i gjatë (+) në franga zvicerane prej një milionë vlerë ekuivalente të euros rezulton në neto pozicion të agreguar prej 2 milionë euro, përderisa pozicioni neto i hapur do të ishte 0.

Ndërsa, për frangun zvicran ky raport ndërroi kahje nga 0 përqind në -0.7 përqind në dhjetor 2016. Raporti i pozicioneve neto të hapura për çdo valutë individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën nivelin maksimal prej 15 përqind të lejuar sipas rregullores përkatëse.

Kreditimi në valutë të huaj vazhdon të jetë në nivel mjaft të ulët dhe madje ka shënuar rënie të mëtejme. Në dhjetor 2016, vlera e gjithsej kredive në valutë jo-euro ishte 4.2 milionë euro vlerë ekuivalente, në krahasim me 5.9 milionë euro vlerë ekuivalente një vit më parë. Rritja e kreditimit në valutë euro si dhe rënia e kreditimit në valutë jo-euro bëri që raporti i kredive në valutë jo-euro ndaj gjithsej portofolit kreditor të zvogëlohet lehtësisht në 0.2 përqind.

Në anën tjetër, vlera e depozitave në valutë të huaj arriti në 128.9 nga 124.3 milionë euro vlerë ekuivalente në dhjetor të vitit 2015. Megjithatë, pjesëmarrja e depozitave jo-euro në gjithsej depozitat zbriti në 4.4 përqind nga 4.6 në dhjetor 2015, si rezultat i normës më të lartë të rritjes së gjithsej depozitave. Në anën tjetër, rënia e kredive në valutë jo-euro kundrejt rritjes së depozitave në valutë jo-euro ndikoi që raporti i kredive në valutë të huaj ndaj depozitave në valutë të huaj të zvogëlohet në 3.3 përqind në dhjetor 2016 (figura 96).

Figura 96. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj




Burimi: BQK (2017)

Rreziku i normave të interesit

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të jetë i ekspozuar ndaj rrezikut të normave të interesit vetëm në kuptimin e rrezikut të rifinancimit dhe riinvestimit të aseteve, duke konsideruar që kreditë dhe depozitat sipas trendit historik kanë kryesisht normë fikse të interesit dhe nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit deri në maturim. Megjithatë, lëvizjet në normat e interesit mund të kenë ndikim në qëndrueshmërinë e sektorit bankar kur merret parasysh rreziku i rifinancimit dhe i riinvestimit të aseteve, varësisht nga kompozicioni i afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve që bartin interes (figura 97), si dhe kahut të lëvizjes së normës së interesit.

Figura 97. Hendeku i aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Hendeku në mes të aseteve dhe detyrimeve që bartin interes është negativ vetëm për kategorinë e maturimit 'deri në 30 ditë', gjë që ekspozon sektorin ndaj rritjes së mundshme të normës së interesit në afat të shkurtër pasi që kostoja e rifinancimit nga depozitat do të rritej më shumë se që mund të rriten të hyrat nga interesi i riinvestimit të aseteve. Në dhjetor 2016, hendeku negativ për këtë interval të maturimit është ngushtuar në 204.6 nga 378.2 milionë euro në vitin paraprak, duke zbritur ekspozimin e sektorit ndaj këtij rreziku. Ndërsa, hendeku kumulativ për periudhën e maturimit 'deri në 1 vit' është pozitiv dhe është dyfishuar duke arritur në 716.6 milionë euro nga 337.5 milionë euro. Kjo rritë ekspozimin e sektorit ndaj rënies së mundshme të

normës së interesit ngase të hyrat nga interesi të sektorit ndikohen më shumë se shpenzimet e interesit.

Për të gjitha afatet e tjera të maturimit përveç atij '1 deri në 5 vite', hendeku i aseteve dhe detyrimeve që bartin interes është më i zgjeruar krahasuar me vitin paraprak. Hendeku për intervalin e maturimit '1 deri në 5 vite' është ngushtuar, vlera e të cilit zbriti në 746.0 milionë euro. Ndërsa hendeku kumulativ ndërmjet aseteve dhe detyrimeve për të gjitha afatet e maturimit arriti në 1.5 miliardë euro nga 1.2 miliardë euro sa ishte në dhjetor 2015. Zhvendosja e depozitave nga të afatizuara drejt atyre të transferueshme në njërën anë si dhe përsheptimi i rritjes së kreditimit në anën tjetër, ndikuan në zgjerimin e hendekut kumulativ pozitiv ndërmjet aseteve dhe detyrimeve.

Rezultatet e stres-testit sugjerojnë që sektori është i aftë të përballojë skenarë të mundshëm të zvogëlimit të normës së interesit për asete si dhe rritjes së normës së interesit për detyrimet, pavarësisht efektit negativ që do të kishin këto zhvillime në të ardhurat e sektorit.

Kutia 2. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë

Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike paraqet një vegël të rëndësishme për vlerësimin e vazhdueshëm të shkallës së rëndësisë sistemike të bankave komerciale në vend. Në përgjithësi, një bankë konsiderohet të ketë rëndësi sistemike nëse dështimi i mundshëm i saj pritet të manifestohet me pasoja të rëndësishme negative në funksionimin dhe stabilitetin e tërë sektorit dhe në ekonomi në tërësi. Andaj, monitorimi i vazhdueshëm i shkallës së rëndësisë sistemike konsiderohet të jetë i rëndësishëm së veçantë për stabilitetin financiar. Modeli gjithashtu mundëson hartimin e rekomandimeve për politikën dhe masat e nevojshme për sigurimin adekuat të kapaciteteve absorbuese të humbjeve të mundshme të bankave konform shkallës së rëndësisë së tyre sistemike, duke shërbyer në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

Tabela 7. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë

Kriteri	Indikatorët
Madhësia (pesha 25%)	Asetet (pa provizione)
Zëvendësueshmëria (pesha 25%)	Vlera e transaksioneve në raport me gjithsej vlerës së transaksioneve të sektorit përmes sistemit të pagesave Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj ekonomive familjare Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jo-financiare Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e ekonomive familjare
Ndërlidhshmëria (pesha 25%)	Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave tjera financiare dhe plasmaneve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë) Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e korporatave tjera financiare dhe huazimeve tjera (duke përfshirë edhe depozitat e bankave tjera) Pjesëmarrja në letrat me vlerë
Aktiviteti ndërshtetëror dhe Kompleksiteti (pesha 25%)	Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm Pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor

Burimi: BQK (2017)

Kjo kuti paraqet vlerësimin e shkallës së rëndësisë sistemike për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja që operojnë në Kosovë duke u bazuar në të dhënat e muajit dhjetor 2016 të bilanceve të gjendjes së bankave përkatëse. Modeli mbështetet në udhëzimet e dhëna nga EBA (2014) sipas së cilës përcaktohen katër kritere bazë për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave: kriteri i madhësisë, zëvendësueshmërisë, ndërlidhjes, dhe aktivitetit ndërshtetëror/kompleksiteti. Të katër kritereve u është dhënë peshë e barabartë dhe për secilin nga kriteret janë përcaktuar indikatorët përmes të cilëve matet shkalla e rëndësisë sistemike të bankave individuale (tabela 7). Përzgjedhja e indikatorëve është bërë konform teorive përkatëse dhe sugjerimeve të kornizës mbi të cilin është zhvilluar ky model.

Një bankë konsiderohet me rëndësi të përgjithshme sistemike nëse mesatarja e të gjitha kritereve për bankën përkatëse tejkalon kufirin e rëndësisë sistemike. Kufiri i rëndësisë sistemike llogaritet si mesatare e sektorit për të gjitha kriteret. Po ashtu edhe në kritere të caktuara, një bankë identifikohet me rëndësi sistemike nëse mesatarja e peshuar e një kriteri për bankën përkatëse tejkalon mesataren e sektorit në këtë

kriter. Kufiri i rëndësisë sistemike për rastin e Kosovës rezulton të jetë 1,000 pikë bazë, dhe bankat të cilat kanë mesataren më të lartë se ky kufi konsiderohen banka më rëndësi sistemike.

Në vijim janë përshkrimi i kriterëve dhe mënyra e matjes së tyre:


Kriteri i madhësisë, konsiderohet kriter shumë i rëndësishëm në matjen e rëndësisë sistemike të një institucioni, pasi që sa më e madhe të jetë pjesëmarrja e një banke në gjithsej sektorin, aq më e madhe do të jetë rëndësia e saj sistemike. Kjo pasiqë palët e ndikuara në rast të tronditjeve në këtë bankë janë më të shumta dhe kostot për tërë sektorin dhe ekonominë janë më të mëdha. Madhësia e institucioneve matet si raport i aseteve të secilit institucion ndaj gjithsej aseteve të sektorit.

Kriteri i zëvendësueshmërisë matë shkallën e zëvendësueshmërisë së ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të bankës përkatëse nga bankat tjera në treg, në rast të dështimit të saj. Kriteri i zëvendësueshmërisë përfaqëson kriterin tjetër të rëndësishëm në matjen e rëndësisë sistemike të bankave. Sa më e madhe pjesëmarrja e një banke në një segment të caktuar të tregut apo në ofrimin e një lloji të caktuar të shërbimit, aq më të larta janë kapacitetet teknike dhe njohuritë për funksionim në sektorin përkatës (p.sh. të sistemit të pagesave), gjë që e bëjnë më të vështirë zëvendësimin e rolit të saj në ofrimin e këtyre shërbimeve bankare. Andaj, edhe rëndësia sistemike e një institucioni rritet kur vështirësitë për zëvendësimin e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të saj janë më të mëdha.

Kriteri i ndërlidhshmërisë ka për qëllim që të masë shkallën e ndërlidhshmërisë ndërmjet institucioneve bankare si dhe ndërlidhshmërisë me institucionet tjera financiare në vend në mënyrë që të identifikojë rrezikun e efektit shpërndarës së krizës së një institucioni tek institucionet tjera financiare dhe tek sektori real. Ky kriter është i një rëndësie të veçantë për matjen e rrezikut sistematik në vendet me sektorë të zhvilluar financiar ku ndërlidhjet mes institucioneve janë të shumta dhe komplekse. Në Kosovë, tregu ndërbankar është në nivel shumë të ulët të aktivitetit dhe ndërlidhjet mes institucioneve financiare kryesisht kufizohen në depozitat dhe kreditë që institucionet tjera financiare si kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit tjerë financiar mbajnë në bankat komerciale në vend. Rrjedhimisht, ndërlidhja mes institucioneve financiare matet përmes pjesëmarrjes së plasmanëve në bankat tjera dhe ekspozimit kreditor ndaj korporatave tjera financiare, si dhe pjesëmarrjes së depozitave dhe huamarrjeve nga korporatat tjera financiare. Në këtë kriter janë përfshirë edhe investimet në letra me vlerë të bankave, të cilat kryesisht përbëhen nga investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe të qeverive tjera jashtë vendit.


Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit matë shkallën e ndërveprimit të një banke me sektorin e jashtëm si në kuadër të aseteve ashtu dhe në kuadër të detyrimeve si dhe shkallën e kompleksitetit të modelit të biznesit dhe operacioneve të një banke. Ky kriter ka për qëllim të paraqesë nivelin e rrezikut të një banke ndaj ekspozimeve të saj në sektorin e jashtëm dhe nivelin e rrezikun nën supozimin se sa më kompleks aktiviteti i një banke, aq më të shumta janë ndërlidhjet dhe marrëveshjet me palë të treta, të cilat i rrisin kostot dhe kohën e adresimit të problemeve në rast të falimentimit.

Figura 98. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike



Burimi: BQK (2017)

Figura 99. Kriteri i madhësisë



Burimi: BQK (2017)


Kosova vazhdon të ketë nivel mjaft të ulët të ndërveprimit bankar me vendet tjera, andaj është më rezistente ndaj rreziqeve të mundshme të cilat vijnë nga sektori i jashtëm. Si indikator për matjen e aktivitetit ndërshtetëror janë marrë kërkesat dhe detyrimet ndaj jo-rezidentëve ndërsa si indikator i përafërt për matjen e kompleksitetit të një banke është marrë pjesëmarrja e zërave jashtëbilancorë në gjithsej portfolion e aseteve të asaj banke.

Rezultatet

Rezultatet e përgjithshme të modelit, me të dhëna të muajit dhjetor 2016, sugjerojnë që pesë banka janë me rëndësi të përgjithshme sistemike (figura 98). Dy nga këto banka kanë rezultuar me rëndësi sistemike në të gjitha kriteret. Rezultatet po ashtu tregojnë që dy banka të cilat nuk janë me rëndësi të përgjithshme sistemike kanë rezultuar me rëndësi sistemike në kriterin e ndërlidhshmërisë. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike shtrihet nga 1,000 pikë bazë deri në 2,432 pikë bazë. Megjithatë, në vitin 2016, është shënuar një rënie e lehtë e peshës së bankave me rëndësi të përgjithshme sistemike, si rezultat i përfshirjes në analizë edhe të një banke tjetër e cila deri më tani nuk ka qenë e përfshirë. Njëkohësisht, bankat që nuk janë me rëndësi sistemike janë duke treguar potencial për të rritur pjesëmarrjen e tyre në aktivitetin e përgjithshëm bankar. Rezultatet e modelit në përgjithësi sugjerojnë se rënia e shkallës së rëndësisë sistemike rezultoi në kriterin e madhësisë dhe të zëvendësueshmërisë. Kjo si rezultat i rritjes së numrit të bankave në analizë si dhe nga rënia e kredive të bankave me rëndësi sistemike ndaj institucioneve jo-financiare.


Kriteri i madhësisë –Katër banka, të cilat kanë rëndësi të përgjithshme sistemike, rezultuan me rëndësi sistemike në kriterin e madhësisë (figura 99). Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,239 pikë bazë në 2,485 pikë bazë, që paraqet rëniekrahasuar me vitin paraprak. Rënia ishte kryesisht rezultat i përfshirjes në analizë të një banke shtesë e cila nuk është përfshirë vitin paraprak për shkak se konsiderohej ende në fillim të veprimtarisë. Po ashtu bankat që nuk kanë rëndësi sistemike kanë përshpejtuar rritjen e aktivitetit të tyre, theksuar aktivitetin kredidhënës, duke rritur pjesëmarrjen e aseteve krahasuar me vitin paraprak. *Kriteri i zëvendësueshmërisë* – Në kriterin e zëvendësueshmërisë me rëndësi sistemike rezultuan katër bankat që kanë rëndësi të përgjithshme sistemike. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter në vitin 2016 shtrihet nga 1,495 pikë bazë në 2,333 pikë bazë (figura 100). Edhe në këtë kriter, shkalla e rëndësisë sistemike ka shënuar rënie krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i rënies së kreditimit ndaj ndërmarrjeve nga bankat

Figura 100. Kriteri i zëvendësueshmërisë




Burimi: BQK (2017)

Figura 101. Kriteri i ndërlidhjes



Burimi: BQK (2017)

Figura 102. Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit



Burimi: BQK (2017)

me pjesëmarrje më të lartë të kreditimit për këtë sektorë krahas rritjes së kreditimit nga bankat me pjesëmarrje më të ulët, që nuk janë me rëndësi të përgjithshme sistemike.

Kriteri i ndërlidhjes – Me rëndësi sistemike në kriterin e ndërlidhjes rezultuan katër banka me rëndësi të përgjithshme sistemike si dhe dy banka të cilat nuk janë me rëndësi të përgjithshme sistemike. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,002 pikë bazë në 2,058 pikë bazë (figura 101). Krahasuar me vitin paraprak, shkalla e rëndësisë sistemike është rritur si rezultat i rritjes së investimeve në letra me vlerë si dhe rritjes së kredive të një banke me rëndësi sistemike ndaj institucioneve tjera financiare.

Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe i kompleksitetit – Katër nga pesë bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike kanë rezultuar të jenë me rëndësi sistemike në kriterin e aktivitetit ndërshtetëror. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,009 pikë bazë në 2,852 pikë bazë (figura 102). Krahasuar me vitin paraprak, shkalla e rëndësisë sistemike është rritur si rezultat i rritjes së detyrimeve të bankave me rëndësi sistemike ndaj sektorit të jashtëm. Po ashtu, bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike shënuan rritje të theksuar të mjeteve jashtëbilancore duke ndikuar kështu në rritjen e shkallës së kompleksitetit.

6.5. Analiza Stres-Test

Analiza stres-test paraqet një vegël të rëndësishme të vlerësimit të qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj tronditjeve të mundshme në portofolin kreditor si dhe në pozitën e likuiditetit, të cilat mund të pasojnë nga zhvillimet e pafavorshme makroekonomike dhe ndryshimet në kushtet e tregut. Përmes kësaj analize vlerësohet ndikimi i këtyre tronditjeve në kualitetin e portofolit kreditor, në nivelin e kapitalizimit si dhe në pozitën e likuiditetit.

Analiza e prezantuar më poshtë ka për bazë të dhënat e sektorit bankar të Kosovës për vitin 2016, të cilat janë shfrytëzuar për vlerësimin e qëndrueshmërisë së sektorit ndaj rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit valutor (rreziku i tregut). Në analizë është testuar gjithashtu aftësia e sektorit që të ruaj gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike për tërheqje të konsiderueshme të depozitave (rreziku i likuiditetit).

Rezultatet e analizës stres-test në vazhdimësi sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit për të përballuar 'situatat ekstreme' të ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve.

6.5.1 Vlerësimi i qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj goditjeve në portofolin kreditor

Metodologjia

Skenari bazë: Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se gjendja ekonomike në eurozonë dhe në rajon do të përkeqësohet, dhe kjo do të reflektohet në ekonominë e Kosovës kryesisht përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat, supozohet të ketë rënie ekonomike, gjë e cila e zgjeron hendekun negativ të prodhimit dhe ndikon në rritjen e kredive joperformuese. Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 3.2 përqind në gjashtë vitet e fundit si dhe është supozuar rënie ekonomike prej 2.6 përqind për vitin 2017. Në këtë situatë, hendeku negativ i prodhimit do të ishte 5.8 përqind, ndërsa ndikimi në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (KJP), është vlerësuar duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të KJP-ve ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8,²³ që nënkupton rritje prej 4.6pp të pjesëmarrjes së KJP-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Si pasojë e tronditjeve në sektorin real, është supozuar që kreditimi nuk do të shënojë rritje në vitin vijues.

²³ Material kërkimor i FMN-së, i papublikuar, 'CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise', Korrik 2009.

Në një skenar shtesë ndaj skenarit bazë, krahas rrezikut kreditor, janë konsideruar edhe efektet e rrezikut të tregut në të hyrat e sektorit. Pra, rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit. Normat e interesit për pjesën e aseteve janë supozuar të bien për 2.0pp, ndërsa për pjesën e detyrimeve të ngritën për 1.5pp kryesisht si rezultat i konkurrencës ndërbankare. Zhvlerësimi i valutës euro ndaj valutave të tjera është supozuar të jetë 20 përqind.

Efektet e supozimeve të mësipërme në sektorin bankar reflektohen si në vijim: rritja e pjesëmarrjes së KJP-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve; zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe ndryshimi i normave të interesit ndikon në humbjet/fitimet e të hyrave neto nga interesi duke marrë parasysh afatin e maturimit të aseteve dhe detyrimeve dhe riinvestimin/rifinancimin e tyre.

Krahas këtyre supozimeve, është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se profiti gjithashtu do të ndikohet nga tronditjet e lartpërmendura, kryesisht përmes rënies së aftësisë së gjenerimit të të hyrave nga interesi si rezultat i mos rritjes së kreditimit si dhe dështimit të kredive (rritjes së KJP-ve). Andaj, profiti i pritshëm i bankave për vitin e ardhshëm është llogaritur duke marrë për bazë profitin neto pas tatimit të realizuar gjatë vitit 2016, ndaj të cilit fillimisht është aplikuar tronditje prej 40 përqind për të reflektuar efektin e mos rritjes së kreditimit, dhe pastaj janë zbritur edhe të hyrat që do të realizoheshin po që se nuk do të rriteshin KJP-të.²⁴

Rritja e supozuar e KJP-ve është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive jo-performuese (të dyshimta dhe të humbura). Kjo rritje është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë së kredive të dyshimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej KJP-të. Rritja e KJP-ve reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e KJP-ve aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin shtesë është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj valutave të huaja për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sektorit bankar vazhdon të jetë minor për shkak të vlerës së ulët të pozicioneve të hapura neto në valutë të huaj.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp për asetet²⁵ dhe rritjen për 1.5pp për detyrimet në bilancin e gjendjes. Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në margjinën neto të interesit (angl. Net Interest Margin: NIM), kryesisht duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave ngase pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit dhe ndryshimet në norma të interesit nuk reflektohen deri në maturim. Efekti negativ në të hyra nga rënia e normës së interesit në anën e aseteve theksohet edhe më tutje nga efekti negativ që ka rritja e normës së interesit për detyrimet.

Skenarë tjerë shtesë: Krahas skenarëve bazë të lartpërmendur, skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i kredimarrësve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përballues i KJP-ve për secilën bankë para se të shfaqen problemet me kapitalizim.

²⁴ Vlerësimi i të hyrave të 'humbura' si pasojë e rritjes së KJP-ve është bërë fillimisht duke llogaritur ex-post normën e përgjithshme të interesit në kredi për secilën bankë, e cila më pastaj është shumëzuar me vlerën e shtuar të KJP-ve.

²⁵ Norma e interesit në kredi në mesatare ka rënë për 1.3pp në 5 vitet e fundit.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të skenarëve hipotetik në nivelin e kapitalit rregullator të sektorit bankar, mjeteve të peshuara me rrezik dhe rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (TMK).

Rezultatet

Gjendja e sektorit bankar të Kosovës për sa i përket kapitalizimit në vitin 2016 ishte mjaft e favorshme, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit prej 17.9 përqind²⁶ (tabela 8). Sektori bankar vazhdoi të qëndrojë mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive, të cilat qëndruan në 4.9 përqind, si dhe mbulimit të kredive joperformuese me provizionet e ndara për humbjet e mundshme nga kreditë të cila arritën në 126.5 përqind.

Tabela 8. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku kreditor

Përshkrimi	Numri i bankave 1/			TMK			KJP			Rikapitalizimi 2/	
	TMK <0	TMK 0-8%	TMK 8-12%	Niveli më i ulët	Niveli më i lartë	Niveli i sektorit	Niveli më i ulët	Niveli më i lartë	Niveli i sektorit	Në mjera euro	Si % e BPV-së
Nivelet aktuale (para goditjeve)	0	0	1	10.5%	20.5%	17.9%	3.0%	6.6%	4.9%		
Rezultatet e makroskenarëve:											
Skenari bazë	0	1	0	6.7%	19.1%	16.9%	4.6%	11.3%	9.6%	12,988.06	0.22%
Kombinimi me rrezik të tregut	0	1	1	5.7%	18.1%	15.6%	4.6%	11.3%	9.6%	15,820.27	0.26%
Dëshimi i tre kredimarrësve	1	0	0	-9.2%	23.1%	15.2%	1.0%	33.5%	12.1%	52,072.32	0.87%
Dëshimi i pesë kredimarrësve	1	0	1	-15.5%	23.1%	13.1%	1.0%	41.5%	14.5%	85,191.68	1.42%

Shënim:1/ Nga dhjetë bankat e konsideruara në analizën stres-test, numri i bankave të cilat bien nën nivelin e nevojshëm rregullator, i ndarë sipas kategorive.
Shënim: 2/ Në raportim të vlerave minimale dhe maksimale të indikatorëve në nivel të bankave, në disa raste janë përjashtuar vlerat e larta të TMK si dhe norma e KJP prej 0 përqind, të cilat karakterizojnë bankat në fillim të veprimtarisë.

Burimi: BQK (2017)

Skenari bazë: Nën supozimet e skenarit bazë për vlerësimin e rrezikut kreditor (përfshirë edhe zërat jashtë bilancor), në të cilin pjesëmarrja e KJP-ve në portfolion kreditor do të rritej për 4.6pp, ndërsa profiti i mbetur pas shokut do të shfrytëzohej për absorbimin e humbjeve, TMK i sektorit bankar do të zbriste në 16.9 përqind (krahasuar me minimumin prej 12 përqind të kërkuar me rregullore të BQK-së). Gjithsej humbja e sektorit bankar do të arrinte vlerën prej 62.4 milionë euro (1.0 përqind të vlerës reale të BPV-së për vitin 2016). Megjithatë, kjo vlerë nuk mund të konsiderohet në tërësi si humbje eventuale e sektorit duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i realizuar. Gjithashtu, një pjesë e humbjeve supozohet se mund të kompensohet nga realizimi i kolateralit apo nga riprogramimi i kredive, por që ky aspekt nuk është konsideruar për qëllim të kësaj analize.

Në nivel të bankave individuale, vetëm një bankë do të përballej me probleme kapitalizimi, me ç'rast TMK do të zbriste në 6.7 përqind, që është nën minimumin rregullator dhe mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të ishin 12.99 milionë euro.

Në përgjithësi, nën supozimin e skenarit bazë për vlerësimin e rrezikut kreditor, sektori bankar do të mund të përballonte ngritjen e nivelit të KJP-ve për 4.6pp pa rrezikuar aftësinë e përmbushjes së kërkesave të mjaftueshmërisë së kapitalit të përcaktuara nga BQK. Në këto rrethana, pjesëmarrja e KJP-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar pas goditjes do të arrinte në 9.6 përqind, ndërsa në nivel të bankave individuale, niveli më i lartë i normës së KJP-ve do të ishte 11.3 përqind.

Skenarët shtesë: Rezultatet e skenarit shtesë, në të cilin rreziku kreditor kombinohet me rrezikun e tregut, ku krahas rritjes së normës së KJP-ve për 4.6pp, përfshihet edhe zhvlerësimi i euros dhe lëvizja e normave të interesit në nivelet e supozuara më lartë, TMK e sektorit bankar do të zbriste në 15.6 përqind. Në këtë rast, dy banka do të zbrisnin nën minimumin rregullator të TMK-së prej 12 përqind, dhe nevojat për rikapitalizim do ishin 15.8 milionë euro (0.26 përqind të

²⁶ Në analizë janë përfshirë dhjetë banka që operojnë në Kosovë.

vlerës reale të BPV-së për vitin 2016). Në këtë skenar, efekti i zhvlerësimit të euros në të hyrat e sektorit paraqitet në nivel të ulët por pozitiv për shkak të pozicionit të hapur neto pozitiv që kishte sektori në dhjetor 2016. Kjo do të thotë se bankat kanë më shumë asete të dominuara në valutë se që kanë detyrime, dhe devaluimi i mundshëm i euros ndaj valutave tjera do të sillte të hyra më të mëdha ngase vlera neto ekuivalente në euro do të rezultonte më e lartë. Ndërsa efekti nga rënia e normës së interesit në të hyrat e sektorit dhe i rritjes së normës së interesit në shpenzime do të jetë negativ dhe shumë më i lartë. Mirëpo, përkundër humbjeve shtesë nga ndryshimet në kushte të tregut – pra ndryshimi i normave të interesit, sektori bankar rezulton stabil me nivel të kapitalizimit mbi 12 përqind.

Një skenar tjetër shtesë supozon dështimin e ekspozimeve të mëdha kreditore. Rezultatet e skenarit në të cilin supozohet dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenj në secilën nga bankat, sugjeron që TMK i sektorit do të zbriste në 15.2 përqind. Në këto rrethana, në një bankë TMK do të zbriste nën nivelin minimal të kërkuar prej 12 përqind, madje do të zbriste në territor negativ. Kjo do të ndikonte që mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar të arrinin në 52.07 milionë euro (vlerë ekuivalente me 0.87 përqind të vlerës reale të BPV-së). Nën supozimin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj në secilën bankë, TMK i sektorit do të zbriste në 13.1 përqind, dhe dy banka do të paraqiteshin të nënkapitalizuara. Vlera e nevojshme për rikapitalizim do të arrinte në 85.19 milionë euro (vlerë ekuivalente me 1.42 përqind të vlerës reale të BPV-së për vitin 2016).

Sektori bankar është në gjendje të përballoj një raport të KJP-ve ndaj gjithsej kredive deri në 15.4 përqind pa u paraqitur nevoja për injektim të kapitalit shtesë për mbajtjen e TMK-së së sektorit në nivelin e kërkuar rregullator prej 12 përqind. Po ashtu, nivelet përballuese të KJP-ve të secilës bankë para se të shfaqen probleme me kapitalizim paraqiten të larta për shumicën e bankave. Përjashtim bën njëra bankë që do të mund të përballonte nivel të normës së KJP prej vetëm 4.5 përqind që të mos rezultoj e nënkapitalizuar. Në një prej bankave, KJP do të mund të rritej deri në nivelin 19.3 përqind të gjithsej portofolit të kredive të asaj banke para se të paraqitet nevoja për kapital shtesë.

6.5.2. Vlerësimi i qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj goditjeve në pozitën e likuiditetit

Metodologjia

Skenari bazë: Analiza e qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj goditjeve në pozitën e likuiditetit mbështetet në skenarin bazë të tërheqjes së një vlere të theksuar të depozitave nga sektori bankar, duke vlerësuar kështu aftësinë e sektorit që të përballojë një tronditje të tillë. Më specifikisht, është konsideruar tërheqja e 8 përqind të depozitave në baza ditore, për pesë ditë radhazi, duke ndarë 5 përqind të depozitave të mbetura pas çdo dite për qëllime të operimit të bankës në ditët vijuese. Ndarja e 5 përqind të depozitave për qëllime operationale nënkupton që, nën paraqitjen e skenarëve të supozuar, rezerva e detyrueshme prej 10 përqind do të përgjysmohej. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e shndërrimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, përderisa mundësia e kthimit të mjeteve jo-likuide në para të gatshme do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre mjeteve brenda ditës. Skenari në të cilin bazohet kjo analizë është mjaft konservativ edhe për faktin se nuk është marrë parasysh mundësia që bankat të plotësojnë një pjesë të nevojave të likuiditetit përmes burimeve të jashtme të financimit.

Skenarët shtesë: Krahas skenarit të lartpërmendur, si skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i depozitorëve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përballues i tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të paraqitet nevoja për likuiditet shtesë.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është testuar në kuptim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së aseteve likuide të bankave për të përballuar tërheqje mjaft të mëdha të depozitave si dhe mjaftueshmërinë e aseteve likuide për të përballuar rrezikun e mundshëm nga koncentrimi i depozitave.

Rezultatet

Spektori bankar i Kosovës u karakterizua me likuiditet të lartë gjatë vitit 2016, ku indikator i kyç i likuiditetit (raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra) qëndroi në 41.5 përqind. Andaj, si rezultat i pozitës së mirë të likuiditetit, sektori bankar në tërësi tregoi aftësi të kënaqshme të përballimit të skenarëve të supozuar të tërheqjes së depozitave.

Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku i likuiditetit

Përshkrimi	Numri i bankave 1/	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)	Kredi/Depozitë	Mjetet likuide shtesë të nevojshme si % e BPV-së
Pas ditës së parë	0	-	83.4%	0.00%
Pas ditës së dytë	0	-	90.7%	0.00%
Pas ditës së tretë	0	-	98.5%	0.00%
Pas ditës së katërt	2	11,653.53	107.1%	0.19%
Pas ditës së pestë	3	40,522.82	116.4%	0.67%

Shënim:1/ Nga dhjetë bankat e konsideruara në analizën stres-test, numri i bankave të cilat bien nën nivelin e nevojshëm rregullator, i ndarë sipas kategorive

Burimi: BQK (2017)

Rezultatet e skenarit bazë të tërheqjes së 8 përqind të depozitave në ditë, për pesë ditë radhazi, sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës do të fillonte të ketë nevojë për likuiditet shtesë vetëm në ditën e katërt, ku dy banka do të kishin mungesë të mjeteve likuide prej gjithsej 11.65 milionë euro (tabela 9). Në fund të ditës së pestë, problemet do të shfaqeshin edhe në një bankë tjetër, duke rritur në tri numrin e bankave që do të kishin mungesë të mjeteve likuide për përballim të tërheqjeve të supozuara të depozitave. Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të depozitave në ditën e pestë do të arrinte në 34.1 përqind, dhe shuma e mjeteve likuide shtesë të nevojshme për tejkalimin e problemeve të likuiditetit do të arrinte në 40.52 milionë euro (0.67 përqind e vlerës reale të BPV-së për vitin 2016).

Supozimi i dështimit të depozitorëve më të mëdhenj në secilën nga bankat paraqitet të mos jetë shqetësues për gjendjen e përgjithshme të likuiditetit në sektorin bankar. Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimeve të financimit (depozitat si përbërësit kryesorë të detyrimeve). Vetëm një bankë do të paraqitej me probleme likuiditeti ku shuma e mjeteve likuide shtesë të nevojshme për tejkalimin e problemeve të likuiditetit do të arrinte në 22.3 milionë euro. Prandaj, tërheqja e menjëhershme e të gjithë depozitorëve më të mëdhenj në secilën bankë nuk paraqet rrezik serioz për pozicionin e përgjithshëm të likuiditetit të sektorit bankar që është mjaftë likuid

Niveli përballues i tërheqjes së depozitave për tërë sektorin bankar para se të shfaqen probleme me likuiditet rezulton të jetë 27.4 përqind, që nënkupton se sektori bankar mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e afër një të tretës (1/3) së gjithsej depozitave pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë. Në këtë rast, nën supozimin që vlera e kredive nuk do të rritet, raporti kredi/depozita për sektorin bankar do të arrinte në 105.7 përqind. Po ashtu, nivelet përballuese të tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të shfaqen probleme me likuiditet rezultojnë të jenë të larta në përgjithësi. Banka me pragun më të ulët qëndron në 16.9 përqind, ndërsa ajo me pragun më të lartë qëndron në 50.5 përqind.

6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë

6.6.1. Sistemi i Pagesave

Sistemet e pagesave luajnë rol të rëndësishëm në sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi, duke marrë parasysh që funksionimi efikas dhe i sigurt i tyre paraqet një faktor shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar të vendit. Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, Sistemi i Pagesave Ndërbankare (SPN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Një ndër hapat me rëndësi që BQK ka ndërmarrë gjatë këtij viti në fushën e sistemit të pagesave është implementimi i një sistemi tërësisht të ri ndërbankar të pagesave, i quajtur ATS (Automat Transfer System/Sistem i Transferit Automatik). Ky sistem i cili nga data 1 korrik 2016 ka zëvendësuar sistemin SEKN (Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar), përbëhet nga dy komponente të cilat do të mundësojnë transferimin e fondeve në kohë reale (komponenti RTGS-Real Time Gross Settlement) dhe procesimin e pagesave në grup dhe shuma të vogla (komponenti ACH - Automated Clearing House).

Numri i transaksioneve të përpunuara nga ATS gjatë vitit 2016 arriti në 11.6 milionë (9.8 milionë në vitin 2015), duke shënuar rritje vjetore prej 17.9 përqind. Kurse, në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej transaksioneve arriti në 10.7 miliardë euro (7.5 miliardë në 2015), që paraqet një rritje vjetore prej 42.5 përqind. Pagesat prioritare masive përfaqësojnë kategorinë me pjesëmarrjen më të lartë në numrin e transaksioneve të realizuara ndërbankare (tabela 10). Këto pagesa përfaqësojnë 4.7 milion transaksione të realizuara (apo 40.4 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) dhe janë kryesisht pagesa nga institucionet qeveritare (siç janë pagat dhe pensionet). Më pas vijnë pagesat masive të rregullta, që përfaqësojnë 4.1 milion transaksione të realizuara (apo 35.2 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) dhe janë kryesisht pagesa në të cilat përfitues janë institucionet e qeverisë dhe përfshijnë pagesën e tatimeve, taksave, doganës etj., ndërsa 1.4 milionë janë pagesat xhiro dedikuar kryesisht pagesave të shërbimeve publike (faturat e kompanive të shërbimeve publike, institucioneve qeveritare si shërbimi doganor dhe Agjensioni Kosovar i Pronave) (tabela 10).

Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së, në përqindje

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	2015	2016	2015	2016
Të rregullta	12.3%	11.2%	49.2%	22.7%
Prioritare	0.3%	0.6%	9.5%	21.0%
Të rregullta - masive	38.3%	35.2%	8.0%	6.2%
Prioritare - masive	35.2%	40.4%	9.5%	7.9%
Pagesat giro	13.7%	12.2%	14.0%	10.8%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	9.7%	8.5%
Debitim direkt	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%
Bankë-bankë		0.0%		22.8%

Burimi: BQK (2017)

Ndërsa sa i përket vlerës së transaksioneve pagesat e rregullta (transfere krediti nën vlerën 10 mijë euro të cilat inicohen në degët bankare me urdhërpagesë të paguesit)²⁷ janë kategori me pjesëmarrjen më të lartë në transaksionet e realizuara (pas transaksioneve bankë-bankë), që arritën vlerën prej 2.42 miliardë euro.

²⁷ Pagesat e rregullta nuk kanë prioritet të lartë dhe procesohen përmes sesioneve të përcaktuara nga BQK-ja. Inicohen në një degë të bankës nga paguesi përmes një urdhërpagesë në formë letër dhe kjo urdhërpagesë futet në sistemin qendror të bankës komerciale dhe dërgohet për kliring në SPN. Paguesi ose paguan me para të gatshme ose me mjetet nga llogaria e tij bankare.

Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare²⁸ në dhjetor 2016 ishte 1.88 milionë, duke qenë për 0.6 përqind më i ulët se në vitin paraprak.

Llogaritë bankare E-banking, përmes të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', kanë vazhduar të rriten. Në dhjetor 2016 numri i gjithsej llogarive E-banking ishte 230.9 mijë, duke shënuar rritje vjetore prej 23.3 përqind (tabela 11). Poashtu, numri dhe vëllimi i transaksioneve përmes shërbimit E-banking është rritur.

Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016
Numri i degëve bankare	44	45	45	45
Numri i nëndegëve bankare	245	223	210	207
Numri i ATM-ve	496	498	540	522
Numri i POS-ve	9,071	9,349	9,705	10,589
Numri i llogarive 'e-banking'	131,365	157,761	187,297	230,905

Burimi: BQK (2017)

Numri i gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking gjatë vitit 2016 arriti në 2.92 milionë, që përkon me rritje vjetore prej 26.4 përqindpërderisa vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 6.70 miliardë euro që përkon me rritje vjetore prej 16.5 përqind.

Struktura e llogarive E-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë rezidente me një pjesëmarrje prej 97.9 përqind. Në kuadër të llogarive të rezidentëve, llogaritë individuale bankare përbëjnë 79.7 përqind të gjithsej llogarive përderisa pjesa e mbetur prej 20.3 përqind nga llogaritë afariste. Ngjashëm, struktura e llogarive të jo-rezidentëve dominohet nga llogaritë individuale me pjesëmarrje prej 91.5 përqind, përderisa llogaritë afariste kanë një pjesëmarrje prej 8.5 përqind.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme u rrit për 17.5 përqind në dhjetor 2016. Në kuadër të kartelave, numri i kartelave me funksion debiti arriti në 856,718 kurse me funksion krediti në 156,437. Numri i kartelave të debitit u karakterizua me rritje vjetore prej 19.2 përqind, përderisa kartelat e kreditit me rritje vjetore prej 8.7 përqind. Pjesëmarrjen më të lartë në kartelat e debitit dhe kreditit në dhjetor 2016 e kishin kartelat Visa (77.3 përqind përkatësisht 87.2 përqind), pasuar nga kartelat Master Card (20.4 përqind përkatësisht 12.0 përqind).

Tabela 12. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje

Përshkrimi	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016
ATM tërheqje në para të gatshme	81.0%	78.9%	70.8%	63.4%
ATM depozitime	0.2%	1.1%	10.5%	26.5%
Kredit transfere nëpërmjet ATM	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%
Tërheqje cash në terminale POS	2.1%	1.1%	1.2%	0.3%
Pagesa me kartela në terminale POS	16.6%	18.9%	17.5%	9.9%

Burimi: BQK (2017)

²⁸ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

Infrastruktura bankare në vend është zgjeruar në kontekst të rrjetit së pajisjeve POS (angl. Point-of-Sale) përderisa numri i bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) është zvogëluar krahasuar me dhjetor 2015 (tabela 11). Përkundër zvogëlimit të numrit të bankomatëve, numri i tërheqjeve përmes ATM-ve është rritur në 12.3 milionë (10.4 milionë deri në dhjetor 2015), me një qarkullim prej 1.62 miliardë euro (1.22 miliardë deri në dhjetor 2015) (tabela 12). Rrjedhimisht, vlera e tërheqjes së parave përmes ATM-ve ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arriti në 63.4 përqind në vitin 2016, që tregon për nivel të lartë të përdorimit të parasë së gatshme. Rritja e numrit të ATM-ve, të cilët mundësojnë depozitimin e parave në llogaritë e klientëve, ka ndikuar që vlera e depozitimeve të rris pjesëmarrjen në 26.5 përqind të gjithsej vlerës së transaksioneve me kartela përmes terminaleve, nga 10.5 përqind sa ishte në vitin 2015.

Në të njëjtën periudhë, numri i pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në терминаlet POS arriti në 6.8 milionë në vlerë prej 252.2 milionë euro. Vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arrit në 9.9 përqind (tabela 12).

7. Sektori Pensional

Vlera e asetëve të sektorit pensional në vitin 2016 arriti në 1.43 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 15.2 përqind (figura 103). Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) përfaqëson pjesën më të madhe të asetëve të sektorit (99.5 përqind), ndërsa pjesa e mbetur menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP) (tabela 13).

Tabela 13. Struktura e sektorit pensional


Përshkrimi	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016
Kosovë	99.3%	99.4%	99.4%	99.5%	99.5%
Slloveni-Kosovë	0.7%	0.6%	0.6%	0.5%	0.5%

Burimi: BQK (2017)

Asetet e FKPK-së arritën në 1.42 miliardë euro, që përkon me një normë të përshpejtuar të rritjes vjetore prej 15.2 përqind (13.1 përqind në vitin 2015). Në vitin 2016, arkëtimet e reja shënuan rritje vjetore prej 10.2 përqind, përderisa vlera e tyre arriti në 151.5 milionë euro (figura 104).


Struktura e asetëve të FKPK-së vazhdon të dominohet nga investimet në tregun e jashtëm, të cilat kryesisht mbahen në formë të aksioneve dhe bonove të thesarit të qeverive të huaja. Gjatë vitit 2016, është vënë re një rritje e investimeve të FKPK-së jashtë vendit, përderisa investimet brenda vendit janë zvogëluar, që mund t'i atribuohet kthimit më të lartë që realizohet nga investimet jashtë. Investimet jashtë vendit rritën pjesëmarrjen në 91.9 përqind (88.1 përqind në vitin 2015), ndërsa investimet brenda vendit ulën pjesëmarrjen në 8.1 përqind (11.9 përqind në vitin 2015) (figura 105).

Figura 103. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

Figura 104. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale



Burimi: BQK (2017)

Figura 105. Struktura e investimeve të sektorit pensional, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

Në vitin 2016, vlera e gjithsej asetëve të FSKP-së arriti në 6.4 milionë euro, që paraqet një rritje të përshpejtuar vjetore prej 6.4 përqind (3.7 përqind në vitin 2015). Arkëtimet e reja arritën vlerën prej 496.5 mijë euro në periudhën raportuese, një rritje vjetore prej 7.6 përqind (1.8 përqind në vitin 2015) (figura 104).

Struktura e asetëve të FSKP-së po ashtu dominohet nga investimet jashtë vendit, kryesisht në formë të letrave me vlerë, aksioneve dhe letrave komerciale, të cilat përbëjnë 82.7 përqind të gjithëj asetëve. Ndërsa, investimet në Kosovë kanë një pjesëmarrje prej 17.3 përqind në gjithëj asetet e FSKP-së, një rritje e pjesëmarrjes kundrejt vitit paraprak (13.6 përqind)(figura 105).


Performanca financiare e sektorit pensional

Sektori pensional shënoi performancë pozitive financiare në gjysmën e dytë të vitit, si rezultat i kthimit pozitiv në investime dhe ngritjes së çmimit të aksionit të dy fondeve pensionale.

Kthimi në investime i FKPK-së në vitin 2016 arriti vlerën 64.6 milionë euro, që është për 35.0 milionë euro më i lartë se vitin paraprak. Për më tepër, FKPK mbylli ditën e fundit të dhjetorit 2016 me çmim më të lartë të aksionit. Më saktësisht, çmimi i aksionit arriti në 1.38 euro, krahasuar me 1.32 euro në vitin 2015 (figura 106).


Ngjashëm, edhe FSKP shënoi kthim pozitiv nga investimet. Në vitin 2016, kthimi neto nga investimet arriti në 526.9 mijë euro, që është dukshëm më i lartë se kthimi i regjistruar një vit më parë (7.81 mijë euro në vitin 2015). Gjithashtu, çmimi i aksionit të FSKP-së në ditën e fundit të dhjetorit 2016 ishte më i lartë se vitin paraprak, duke arritur në 158.4 euro kundrejt 145.3 euro në vitin 2015 (figura 107).²⁹

Figura 106. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës



Burimi: BQK (2017)

Figura 107. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve



Burimi: BQK (2017)

²⁹ Vlera bazë e aksionit të FSKP-së është 100 për dallim nga ajo e FKPK-së që është 1.

8. Sektori i Sigurimeve

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e sigurimit ‘jo-jetë’, i cili përfaqëson 89.9 përqind të aseteve të tregut të sigurimeve, ndërsa pjesa e mbetur përbëhet nga asetet e kompanive të sigurimit ‘jetë’. Në tregun vendor operojnë 12 kompani që ofrojnë produkte të sigurimit ‘jo-jetë’, ndërsa tri kompani ofrojnë produkte të sigurimit ‘jetë’.

Kompanitë me pronësi të huaj përbëjnë 50.2 përqind të gjithsej aseteve, ndërsa kompanitë vendore kanë një pjesëmarrje prej 49.8 përqind në gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve. Në vitin 2016, është aprovuar shitja e një kompanie me pronësi të huaj tek pronarët vendor dhe hapja e një kompanie të re me aksionar vendor, gjë që u reflektua edhe në strukturën e aseteve sipas pronësisë. Si rrjedhojë, në sektorin e sigurimeve tashmë operojnë shtatë kompani me pronësi vendore dhe tetë kompani sigurimi me pronësi të huaj (figura 108).

Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin e sigurimeve mund të konsiderohet e ulët, sidomos në krahasim me shkallën e koncentrimit të tregut bankar. Shprehur përmes pjesëmarrjes së tri kompanive më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve, shkalla e koncentrimit qëndroi në 35.5 përqind në vitin 2016, që paraqet një nivel të ngjashëm me vitin paraprak.

8.1. Aktiviteti i sektorit të sigurimeve

Asetet e sektorit të sigurimeve arritën vlerën 161.8 milionë, që përkon me një rritje vjetore prej 5.9 përqind (figura 109). Asetet e kompanive të sigurimeve ‘jo-jetë’ u rritën për 5.6 përqind, përderisa asetet në kuadër të sigurimit ‘jetë’ shënuan rritje vjetore prej 8.3 përqind.

Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve vazhdoi të dominohet nga paraja e gatshme dhe depozitat, kategori që u karakterizuan me rritje të pjesëmarrjes në këtë periudhë. Nga 52.0 përqind në vitin 2015, pjesëmarrja e parave të gatshme dhe depozitave u rrit në 52.4 përqind të gjithsej aseteve në vitin

Figura 108. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë




Figura 109. Asetet e sektorit të sigurimeve





Figura 110. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara, në milionë euro



2016. Në anën tjetër, kategoria e asetëve financiare rriti pjesëmarrjen në 13.4 përqind, nga 9.4 përqind sa ishin në vitin 2015.

Në kuadër të detyrimeve dhe burimeve vetanake, rezervat teknike kryesojnë strukturën e përgjithshme me pjesëmarrje prej 74.6 përqind, ndërsa në pjesën e mbetur bëjnë pjesë kapitali vetanak, detyrimet tjera dhe kreditë. Rezervat teknike shënuan rritjen më të theksuar vjetore prej 30.4 përqind. Në anën tjetër, kapitali vetanak shënoi rënie prej 39.2 përqind, ndikuar kryesisht nga humbja e kompanive të sigurimit.

Vlera e gjithsej primeve të shkruara të sektorit në vitin 2016 arriti në 83.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.4 përqind. Struktura e primeve të shkruara dominohet nga primet e sigurimit 'jo-jetë' të cilat përfaqësojnë 96.9 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Në vitin 2016, këto prime arritën vlerën 80.9 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 4.7 përqind. Pjesa e mbetur prej 3.1 përqind e gjithsej primeve të shkruara përbëhet nga primet e sigurimit 'jetë', të cilat shënuan rënie vjetore prej 3.7 përqind (figura 112).


Gjithsej dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) në vitin 2016 arritën vlerën 39.0 milionë euro. Dëmet e paguara për sigurimet 'jo-jetë' shënuan rritje vjetore prej 4.6 përqind, ndërsa dëmet e paguara për sigurimet e jetës shënuan rritje vjetore prej 23.1 përqind. Rënia e dëmeve të paguara dhe rritja e vlerës së primeve të shkruara rezultoi në zvogëlim të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara. Në vitin 2016, ky raport zbriti në 41.0 përqind krahasuar me 46.0 përqind sa ishte në vitin 2015.

8.2. Performanca financiare e sektorit të sigurimeve

Indikatorët e performancës së sektorit të sigurimeve u përkeqësuan gjatë vitit 2016. Sektori vazhdoi të regjistroj humbje, që në vitin 2016 është thelluar dukshëm kundrejt vitit paraprak. Të hyrat neto nga primet e sektorit të sigurimeve (të cilat përfaqësojnë rreth 95 përqind të të hyrave) shënuan rritje vjetore prej 1.2 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë dëmet e ndodhura shënuan rritje prej 32.5 përqind (dëmet e ndodhura përfaqësuan rreth 50 përqind të gjithsej shpenzimeve në dy vitet e fundit). Shpenzimet tjera u rritën për 11.4 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së neto shpenzimeve operative. Si pasojë e rritjes më të lartë të shpenzimeve tjera dhe dëmeve të ndodhura kundrejt të hyrave, sektori i sigurimeve regjistroi humbje prej 25.6 milionë euro (humbje prej 8.9 milionë në dhjetor 2015).


Me humbje u karakterizua sigurimi 'jo-jetë', 25.9 milionë, përderisa performanca financiare e sigurimit jetë ishte pozitive me neto fitim prej 351.4 mijë euro. Humbja financiare e sigurimit 'jo-

Figura 111. Primet bruto të arkëtuara, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Figura 112. Dëmet e paguara, në milionë euro
Dhjetor 2016



Burimi: BQK (2017)

jetë' u ndikua kryesisht nga rivlerësimi aktuarial i provizioneve teknike të disa kompanive të sigurimeve jo-jetë të cilat me vite të tëra kishin nënvlerësuar provizionet teknike, përkatësisht provizionet për dëmet pezull.³⁰ Faktor tjetër me peshë në thellimin e humbjes ishte edhe niveli i lartë i shpenzimeve si rrjedhojë e mos menaxhimit të duhur të tyre.

Sektori u karakterizua edhe me rënie të treguesve kryesorë të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 90.7 përqind në vitin 2016 (114.8 në vitin 2015). Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëlua gjithashtu në 83.4 përqind (103.4 në vitin 2015). Rënia e nivelit të likuiditetit, ndër tjera, reflekton edhe ndryshimin në strukturën e aseteve të kompanive të sigurimit, ku u regjistrua zhvendosje e një pjesë të investimeve që mbahej në formë të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj në drejtim të investimeve në letra me vlerë.

Raporti i kapitalizimit, i shprehur përmes raportit të borxhit në gjithsej detyrimet dhe kapitalin e sektorit, është përkeqësuar duke arritur në 81.2 përqind në vitin 2016 nga 67.2 përqind një vit më parë. Ngritja e raportit të borxhit në gjithsej detyrimet tregon për mbështetje më të lartë të sektorit në instrumente borxhi për financimin e aseteve, dhe njëherit nivel më të ulët të kapitalit si formë më e qëndrueshme e financimit.


³⁰ Humbja e bartur nga nënvlerësimi i provizioneve teknike si pasojë e mos prezantimit të drejtë të këtyre rezervave për dëme të viteve të kaluara (2002-2015), ishte 15.96 milionë euro. Për më tepër, kur kësaj i shtohet edhe shuma e paguar e tatimit në qarkullim (përkundër humbjeve të realizuara) prej 4 milionë euro, si dhe pagesat e Fondit të Kompensimit (të shkaktuara nga makinat e pasiguruara) në shumë mbi 4 milion euro, sektori i sigurimeve arrin humbjen e prezantuar në vitin 2016 në shumë prej 25.6 milionë euro.

9. Sektori mikrofinanciar dhe Ndhmësit Financiar

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aktivitetit. Asetet e sektorit arritën vlerën 142.2 milionë euro në vitin 2016, që korrespondojnë me rritje vjetore prej 23.7 përqind (figura 113). Në tregun vendor operojnë 16 institucione mikrofinanciare,³¹ nga të cilat 12 kanë pronësi të huaj dhe përfaqësojnë 93.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit.

Ndërsa, pjesëmarrja e aseteve të tri institucioneve më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit zbriti në 53.2 përqind nga 51.6 përqind sa ishte në vitin 2015.

Figura 113. Asetet e sektorit mikrofinanciar, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

9.1. Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar

Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar dominohet nga kreditë që përbëjnë 73.7 përqind të gjithsej aseteve të sektorit (68.8 përqind në vitin 2015). Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha janë lizingjet, që kanë një pjesëmarrje prej 15.2 përqind (18.2 përqind në vitin 2015) (figura 114).

Figura 114. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar (qershor 2016)



Burimi: BQK (2017)

Në vitin e fundit, vërehet tendencë e ndryshimit të strukturës së aseteve të sektorit mikrofinanciar, me ç'rast lizingjet u karakterizuan me rënie të pjesëmarrjes

ndërsa kreditë me rritje të pjesëmarrjes në gjithsej asetet. Sa i përket detyrimeve, aktiviteti i sektorit mikrofinanciar financohet kryesisht nga huamarrjet nga sektori i jashtëm. Kategoria 'llogaritë e pagueshme' përbën 74.5 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit mikrofinanciar.

Kreditë

Vlera e gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar në vitin 2016 arriti në 108.9 milionë euro, që paraqet rritje të përshpejtuar vjetore prej 32.2 përqind (10.7 përqind në vitin 2015). Përshpejtimi i rritjes së kreditimit mund t'i atribuohet rritjes së burimit të financimit të institucioneve mikrofinanciare, kryesisht rritjes së financimit nga jashtë dhe kapitalit vetanak të ndikuar nga rritja e fitimit të mbajtur. Numri i gjithsej kredive në vitin 2016 shënoi rritje në 39,414 nga 33,744 sa ishte në vitin 2015).

³¹ Këtu përfshihen edhe pesë institucione financiare jo-bankare që kryejnë aktivitete të kredidhënies, lizingut dhe faktoringut.


Ngjashëm me sjelljen e kreditimit të sektorit bankar, edhe te IMF-të kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan normë më të lartë të rritjes prej 37.5 përqind, krahasuar me kreditë ndaj ndërmarrjeve të cilat u rritën për 2.7 përqind.

Kreditë ndaj ekonomive familjare në vitin 2016 përfaqësuan 67.0 përqind të gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar. Sipas afatit të maturimit, kreditë e ekonomive familjare me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ kanë rritur pjesëmarrjen duke dominuar strukturën e gjithsej kredive të kësaj kategorie, për dallim nga vitet e kaluara ku dominonin kreditë me maturitet ‘mbi 1 deri në 2 vite’ (figura 115).

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike mbetet relativisht e ngjashme me periudhat paraprake. Për dallim nga sektori bankar, ku kreditë për bujqësinë paraqesin kategorinë me pjesëmarrjen të ulët, tek institucionet mikrofinanciare bujqësia ka një pjesëmarrje prej 28.5 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet. Sektorët tjerë të ekonomisë, me qasje më të lartë në financim mikrofinanciar janë edhe shërbimet tjera dhe sektori i ndërtimitarisë (figura 116).


Sa i përket ecurisë së kreditimit sipas sektorëve të ekonomisë, deri në dhjetor 2016 kreditë për sektorin e bujqësisë regjistruan rritjen më të lartë vjetore (figura 117). Rritje të theksuar të kreditimit kishte edhe sektori i industrisë dhe e ndërtimitarisë. Ndërsa, kreditimi i sektorit të tregtisë shënoi rënie të theksuar vjetore. Sa i përket strukturës së kreditimit, vërejmë një zhvendosje të kreditimit në kreditë afatmesme ‘mbi 2 deri në 5 vite’ (figura 118).

Figura 115. Kreditë ndaj ekonomive familjare sipas maturitetit




Burimi: BQK (2017)

Figura 116. Struktura e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2017)

Figura 117. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2017)

Figura 118. Kreditë e ndërmarrjeve sipas maturitetit




Burimi: BQK (2017)

Lizingjet


Akviteti i lizingut në institucionet mikrofinanciare shënoi rritje. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar arriti në 22.6 milionë euro, që përkon me rritje vjetore prej 3.4 përqind (figura 119). Kontributin më të madh në rritjen e gjithsej lizingjeve e kishin lizingjet për ekonomitë familjare, vlera e të cilave ishte për 8.6 përqind më e lartë krahasuar me vitin 2015.

Figura 119. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2017)

Figura 120. Struktura e lizingut, në përqindje



Burimi: BQK (2017)


Lizingjet për ekonomitë familjare përbëjnë kategorinë kryesore, me pjesëmarrje prej 55.5 përqind në strukturën e përgjithshme të lizingjeve (figura 120). Ndërsa, lizingjet për ndërmarrjet përbëjnë 44.5 përqind të strukturës së përgjithshme.

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar shënoi rënie gjatë vitit 2016, duke zbritur në nivelin më të ulët në tre vitet e fundit, përkatësisht në 21.3 përqind (figura 121). Me rënie të normës mesatare të interesit në kredi u karakterizua si sektori i ekonomive familjare, ashtu edhe ai i ndërmarrjeve.


Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare zbriti në 22.6 përqind në vitin 2016, nga 24.4 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kurse, mesatarja e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në vitin 2016 zbriti në 19.5 përqind nga 19.9 përqind sa ishte në vitin 2015 (figura 122). Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve u karakterizua me normën më të ulët mesatare të interesit, si rezultat i rënies vjetore të shënuar prej 2.3 pikë përqindje, pasuar nga norma mesatare e interesit ndaj sektorit të bujqësisë që shënoi një rënie vjetore prej 2.0 pikë përqindje. Në këtë periudhë, sektori i industrisë u karakterizua me rritje prej 1.4 pikë përqind të normës mesatare të interesit në kredi (figura 122).

Figura 121. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2017)

Figura 122. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2017)

9.2. Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me përmirësim të performancës financiare në krahasim me tre vitet e fundit. Në vitin 2016, profiti i realizuar arriti vlerën prej 4.1 milionë euro, krahasuar me profitin prej 2.5 milionë euro të realizuar në vitin paraprak. Rritja e profitit ishte kryesisht rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave kundrejt rritjes që shënuan shpenzimet.


Në vitin 2016, të hyrat e sektorit mikrofinanciar shënuan rritje prej 16.6 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së të gjitha kategorive të të hyrave, por veçanërisht të hyrave nga interesi duke pas parasysh peshën e kësaj kategorie në gjithsej të hyrat. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet u karakterizuan me rritje vjetore prej 10.0 përqind, që mund t'i atribuohet veçanërisht rritjes së shpenzimeve nga jo-interesi për 7.8 përqind (figura 123).

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar ka shënuar përmirësim krahasuar me vitin e kaluar, kryesisht si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave të sektorit mikrofinanciar në krahasim me rritjen e shpenzimeve. Në vitin 2016, ky indikator u zvogëlu në 83.4 përqind (88.4 përqind në vitin 2015).

Profiti i realizuar në vitin 2016 ndikoi në përmirësimin e treguesve të profitabilitetit, ku Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) arriti në 3.0 përqind (2.1 përqind në vitin 2015), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) në 10.9 përqind (7.6 përqind në vitin 2015) (figura 124).

Sektori mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me nivel relativisht të ulët të kredive joperformuese dhe nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kredive joperformuese. Në vitin 2016, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë u zvogëlu në 2.9 përqind (4.2 përqind në vitin 2015), ndikuar kryesisht nga ritmi më i lartë i rritjes së stokut të kredive krahas rritjes së vlerës së kredive joperformuese. Gjithashtu, mbulueshmëria me provizione u përmirësua


Figura 123. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2017)


Në të njëjtën periudhë, shpenzimet u karakterizuan me rritje vjetore prej 10.0 përqind, që mund t'i atribuohet veçanërisht rritjes së shpenzimeve nga jo-interesi për 7.8 përqind (figura 123).

Figura 124. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2017)

Figura 125. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK (2017)

konsiderueshëm në 200.2 përqind, krahasuar me nivelin prej 124.7 përqind në vitin 2015 (figura 125).

9.3 Ndhmësit Financiar

Sektori i ndihmësve financiar përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Ky sektor përbënë numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, mirëpo menaxhon pjesën më të vogël të aseteve të sistemit financiar (0.2 përqind në vitin 2016). Vlera e aseteve të ndihmësve financiarë në vitin 2016 arriti në 12.6 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 16.7 përqind. Përkundër rritjes së aseteve, të hyrat e ndihmësve financiar shënuan rënie vjetore prej 3.9 përqind duke zbritur në 6.8 milionë euro. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiar dominohet nga të hyrat nga transferet (pjesëmarrje 72.6 përqind në vitin 2016), të cilat u karakterizuan me rënie vjetore prej 3.8 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rritje vjetore prej prej 6.3 përqind duke arritur në 3.9 milionë euro. Rënia e të hyrave dhe rritja e shpenzimeve të sektorit ndikuan që neto fitimi i sektorit të ndihmësve financiar të zbrësë në 2.9 milionë euro në vitin 2016, një rënie vjetore prej 14.7 përqind.

10. Politika Makroprudenciale

Gjatë vitit 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore i cili mandaton BQK-në për përpilimin dhe implementimin e politikave për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, ka përpiluar Politikën për Mbikëqyrje Makroprudenciale. Politika për Mbikëqyrje Makroprudenciale përcakton fushëveprimin, objektivat dhe instrumentet e nevojshme të Mbikëqyrjes Makroprudenciale në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar. BQK gjithashtu ka të funksionalizuar Komitetin Këshillëdhënës për Makroprudencë, si një trup i mandatuar me Politikën Makroprudenciale për të ndihmuar në implementimin e saj duke monitoruar rregullisht rreziqet sistemike ndaj stabilitetit të sistemit financiar dhe duke rekomanduar për politikën dhe veprimet përkatëse.

Politika Makroprudenciale e BQK-së është draftuar në përputhje me kornizën makroprudenciale të Bordit European për Rrezik Sistemik (angl: *European Systemic Risk Bord*). Objektiva kryesore e kësaj Politike është të ndihmoj ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar duke zvogëluar akumulimin e rrezikut sistemik dhe duke fuqizuar rezistencën e sistemit financiar. Objektivat e ndërmjetme të politikës makroprudenciale janë:

- zvogëlimi dhe parandalimi i rritjes së tepruar të kredive dhe të levës;
- zvogëlimi dhe parandalimi i mospërputhjes së tepruar të maturitetit;
- zvogëlimi dhe parandalimi i jo-likuiditetit;
- kufizimi i koncentrimin të ekspozimeve kreditore;
- kufizimi i ndikimit sistemik të nxitjeve që synojnë zvogëlimin e rrezikut moral, dhe
- forcimi i qëndrueshmërisë së infrastrukturës financiare.

Me qëllim të realizimit të objektivave të lartpërmendura, BQK, bazuar në analizën e rreziqeve ndaj sistemit financiar, do të aplikojë një gamë të gjerë instrumentesh të cilat adresojnë rrezikun sistemik të ndërlidhur me ciklin e biznesit apo me strukturën e sektorit financiar. Instrumentet që do të përdoren kanë karakter parandalues drejt zvogëlimit të mundësisë së ndodhjes dhe shtrirjes së një gjendje financiare të paqëndrueshme, dhe përfshijnë shumë instrumente të cilat janë aktualisht në fuqi përmes rregulloreve ekzistuese, siç janë kërkesat rregullative për përshtatshmëri të kapitalit të peshuar me rrezik, kërkesat për ruajtjen dhe sigurimin e fondeve të nevojshme likuide, kufizimet e përqendrimit të kredive, etj. Këto instrumente të cilat fillimisht i përkasin politikës mikroprudenciale, do të jenë gjithashtu në funksion të politikës makroprudenciale, me ç'rast BQK mund të aplikojë kërkesa shtesë për sektorin në përgjithësi apo për segmente specifike të tij varësisht prej analizës së rreziqeve. Instrumentet tjera të mundshme të karakterit makroprudencial, të cilat janë në përputhshmëri me ligjet në fuqi, përfshijnë kërkesa rregullative shtesë për përshtatshmërinë e kapitalit të peshuar me rrezik konform shkallës së rrezikut sistemik dhe mundësisë së akumulimit të rrezikut në faza të ndryshme të ciklit të biznesit, si dhe kufizimet tjera në funksion të parandalimit dhe evitimit të rritjes së rreziqeve sistemike.

Në përpjekje për të rritur transparencën në lidhje me Politikën Makroprudenciale dhe vendimet përkatëse, BQK do të publikojë analizë të rregullt të rreziqeve sistemike dhe ecurisë së treguesëve të politikës makroprudenciale.

10.1 Identifikimi dhe Vlerësimi i Rrezikut Sistemik

Rreziku sistemik nënkupton rrezikun e ndërprerjeve të konsiderueshme të ofrimit të shërbimeve financiare të cilat manifestohen me pasoja të rëndësishme negative për stabilitetin financiar dhe ekonominë në tërësi. Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut sistemik duhet të bëhet konform natyrës dy dimensionale të rrezikut sistemik: atë të kohës si dhe të strukturës. Dimensio

kohës nënkupton identifikimin dhe vlerësimin e mundësisë së akumulimit të rrezikut sistemik në kohë, ndërsa aspekti strukturorë nënkupton vlerësimin e rrezikut ndaj sistemit që rrjedh nga ndërlikohet ndërmjet akterëve financiarë dhe koncentrimin në tregje e sektorë të caktuar.

Banka Qendrore e Kosovës në vazhdimësi monitoron dhe vlerëson rreziqet e përgjithshme ndaj stabilitetit financiar përmes metodave dhe modeleve të ndryshme, të cilat komplementohen me gjykim profesional. Analizat e rrezikut sistemik përfshijnë zhvillimet në sektorët kryesorë të ekonomisë ndaj të cilëve ekspozohet sektori financiar, si dhe zhvillimet brenda vet sektorit financiar dhe implikimet për stabilitetin e tij. Përveç analizës së treguesve kryesorë të zhvillimeve në sektorët përkatës, BQK ka zhvilluar dhe adaptuar disa modele për vlerësimin e rreziqeve. Modeli i ndërthurur rishtazi i Hartës së Stabilitetit Financiar analizon zhvillimet në tetë dimensione të rrezikut ndaj stabilitetit financiar siç janë: zhvillimet e jashtme dhe të brendshme makroekonomike, gjendja dhe zhvillimet e agjentëve kryesorë ekonomikë si ndërmarrjet, ekonomitë familjare, dhe qeveria, si dhe gjendja dhe zhvillimet në treguesit e brendshëm të rrezikut të sektorit financiar si kapitalizimi, likuiditeti dhe struktura e sektorit bankar. Modeli i Stress-testit është një nga veglat kyçe për identifikimin e brishtësive aktuale në sektorin financiar dhe rreziqeve potenciale sistematike në vitin vijues. BQK ka të zhvilluar modelin e Identifikimit të Bankave me Rëndësi Sistemike, i cili është avancuar në vazhdimësi dhe së fundi është adaptuar konform udhëzimeve të fundit të Autoritetit Bankar Europian (angl: *European Banking Authority*). Modeli i bankave me Rëndësi Sistemike është instrument tipik i politikës makroprudenciale i cili vlerëson rrezikun e shpërndarjes së efekteve negative të një institucioni sistemik në tërë sistemin. Model tjetër tipik i politikës makroprudenciale, të cilin BQK ka filluar ta përdorë është identifikimi i ciklit të biznesit të sektorit financiar, me qëllim të vlerësimit të rrezikut sistemik ciklik dhe adekuatshmërisë së kapitalit konform shkallës së rrezikut.

BQK do të punojë me përkushtim në avancimin e modeleve ekzistuese si dhe zhvillimin e instrumenteve tjera në funksion të arritjes së objektivave të Politikës Makroprudenciale. Modelet dhe Instrumentet do të kalibrohen konform standardeve ndërkombëtare dhe rrethanave vendore, dhe do të shërbejnë si bazë për vendimet e Politikës Monetare.

10.2 Përmbledhje e zhvillimeve në tregues të zgjedhur të makroprudencës

Në gjysmën e dytë të vitit 2016, zhvillimet e përgjithshme të indikatorëve makroprudencë në Kosovë ishin të qëndrueshme, pa ndonjë kërcënim për stabilitetin financiar të vendit. Të gjithë treguesit financiarë ishin brenda parametrave të përcaktuar me kornizën legislative. Kreditë jo-performuese ndaj totalit të kredive kanë vazhduar të ndjekin trendin rënës, dhe janë përcjellë me mbulueshmëri adekuate. Treguesit e kapitalizimit për sektorin në përgjithësi, dhe bankat me rëndësi sistematike në veçanti ishin mjaft mbi kërkesat rregullative. Ngjashëm me treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, raporti levës në nivel prej 12.1 përqind rezulton mbi kërkesat minimale ligjore për sektorin bankar dhe bankat me rëndësi sistematike. Raporti kredi-depozita konsiderohet adekuat duke qëndruar në nivelin prej rreth 75 përqind. Kreditë në raport me vlerën (anglisht: *loan-to-value ratio*) qëndruan lartë mbi nivelin prej 100 përqind. Indikatorët e likuiditetit janë të kënaqshëm, në veçanti raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurta që është mbi kërkesat rregullative. Koncentrimi i ekspozimeve të mëdha në sistem bankar qëndron në nivelin adekuat me tendencë uljeje. Treguesit e profitabilitetit, në veçanti ROE, qëndroi në nivel të lartë prej 18.4%.

Hendeku Kredi/BPV (anglisht: *credit to GDP gap*) jep sinjale se sektori bankar në Kosovë ka hapësirë për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit kreditues në kuadër të kornizës së ambientit makro-financiar në të cilin vepron, përkundër rritjes vjetore prej 10.7 përqind në vitin 2016. Sektori bankar vazhdoi të ketë katër banka me rëndësi sistematike. Rezultatet e analizës stres-test

për këto banka në vazhdimësi sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit bankar për të përballuar situata ekstreme të ekspozimit ndaj rrezikut të tregut apo rrezikut të likuiditetit.

10.3 Vendimet dhe masat makroprudenciale të BQK-së

Në gjysmën e dytë të vitit 2016, BQK ka bërë vlerësimin e zhvillimeve në treguesit makroprudencial në baza tremujore. Bazuar në ecurinë e indikatorëve të rrezikut sistemik të cilët sugjeruan për zhvillime të qëndrueshme të sektorit në këtë periudhë, BQK nuk ka vlerësuar të nevojshëm aplikimin e ndonjë instrumenti të Politikës Makroprudenciale në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar.

10. Shtojca statistikore

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016
Mjaftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	16.7	17.8	19.0	17.9
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	12.8	14.6	16.7	15.9
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	7.8	4.7	3.0	2.2
Cilësia e asetëve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	8.7	8.3	6.2	4.9
<i>Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive</i>	Korporatat tjera financiare	1.1	0.4	0.4	0.4
	Korporatat publike jofinanciare	0.01	0.03	0.03	0.00
	Korporatat tjera jofinanciare	66.4	65.7	65.6	63.9
	Ekonomitë familjare	31.3	33.9	33.9	35.7
	OJSHEF	0.05	0.01	0.01	0.02
	Jo-rezidente	1.1	0.0	0.0	0.0
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
Profitabiliteti	Kthimi në asete (KNA)*	1.0	2.2	2.5	2.4
	Kthimi në kapital (KNK)*	10.6	22.5	21.6	19.9
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	73.1	75.9	75.8	68.1
	Shpenzimet e jo-nteresit ndaj të hyrave bruto	84.8	66.6	51.6	49.6
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	27.7	25.9	24.2	26.3
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	36.6	32.8	29.2	31.7
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	35.7	32.4	30.9	34.5
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	47.1	41.0	37.3	41.5
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	2.3	1.8	1.8	4.4
Grupi i zgjeruar i indikatorëve					
	Kapitali ndaj asetëve	9.7	10.8	12.2	12.1
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	107.4	97.1	63.5	66.9
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointeresi	38.5	41.7	36.8	36.4
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	8.7	8.1	6.5	6.0
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	131.6	129.3	130.3	125.8
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	4.6	0.0	3.7	4.1

*Janë konsideruar të hyrat neto para taksës.

Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)

Tabela 2. Bilancet e gjendjes së bankave komerciale, dhjetor 2016, në milionë euro

Raiffeisen Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	110.0	Bilanci nga bankat tjera	0.5
Bilanci me bankat komerciale	51.0	Depozitat	724.7
Letrat me vlerë	207.7	Huamarrjet tjera	-
Kreditë	513.7	Detyrimet tjera	44.4
Asetet fikse	10.4	Borxhi i ndërvarur	19.3
Asetet tjera	4.5	Burimet vetanake	108.3
GJITHSEJ ASETET	897.3	GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE	897.3

Burimi: BQK (2017)

Procredit Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	100.9	Bilanci nga bankat tjera	0.5
Bilanci me bankat komerciale	84.3	Depozitat	675.9
Letrat me vlerë	132.7	Huamarrjet tjera	10.0
Kreditë	473.0	Detyrimet tjera	41.1
Asetet fikse	16.5	Borxhi i ndërvarur	7.5
Asetet tjera	16.1	Burimet vetanake	88.4
